ISSN 1857-6443

Rekomandime

Lejoni nxënësit të llogaritin me gishta

Fq.4

RASTI I SOPOTIT

14 vite në kërkim të drejtësisë

Fq.5

E prisja tripletën, por gabim të mendojmë për Çampionsin

Higuain

Fq.22

www.koha.mk

Koha

Reformat që nuk duken

Fq.7

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3286 · e mërkurë 7 shkurt, 2018 · 3°c | 11°c · 15 DEN

EDITORIAL

Strategji e re me vrima të vjetra

Në Ballkanin Perëndimor tash e tutje mund të ketë plotë vrima të zeza, për arsye se Strategjia e Komisionit Evropian, e prezantuar dje në Strasburg, ka parashikuar që vetëm Serbia dhe Mali i Zi mund të jenë gati potencialisht pas vitit 2025 për t'iu bashkuar BE-së. Nëse strategjia më e re e Brukselit mund të kuptohet edhe si përgjigje ndaj përpjekjeve të Rusisë për ndikim në rajon dhe angazhimi ekonomik në rritje të Kinës, atëherë kush mund të garantojë që këto përpjekje ruse dhe këto ndikime kineze nuk do të intensifikohen pikërisht në këtë kohë kur BE paska hequr dorë vullnetarisht...

Fq.2

RAJON

Mali i Zi dhe Serbia lidere në rajon

Fq.15

GLOBI

Lufta e Spanjës kundër jashtëqitjeve të qenve

Fq.15

PUBLIKOHET STRATEGJIA E BE-SË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

EDHE 7 VJET JASHTE BE-së

Negociatat mund të nisin në mot, ndërsa anëtarësimi - pasi të zgjidhen kontestet mes fqinjëve. Serbia dhe Mali i Zi shënohen si lidere në rajon, ndërsa Maqedonia dhe Shqipëria potencohen si vende "larg" kushteve që i kërkon Bashkimi Evropian". Me një fjalë, asnjëri nga vendet e Ballkanit Perëndimor deri në 2025-ën nuk duhet të shpresojë në anëtarësimin e plotë në BE

Fq.3

Mes liberalizimit dhe monopolit

Shkup, 6 shkurt - Posta e Maqedonisë deri në fund të këtij viti do të ketë të drejtë ekskluzive që të shpërndajë dërgesa me peshë deri 50 gram ku bëjnë pjesë letra, kartolina dhe fletëllogari të ndryshme. Pas anulimit dy herë të liberalizimit të tregut postar në vend, pritet që deri në fund të vitet ose sërish të vendoset nga ana e qeverisë së re për hapje të tregut për lojtarë të ri në këtë segment të punës, ose të ketë sërish shtyrje të liberalizimit të tërësishëm të të gjithë shërbimeve postare. Sipas ligjit, aktualisht afro 20 kompani të ndryshme private nuk munden të kryejnë dorëzimin e letrave , por vetëm të dërgesave më të rënda se 50 gram. Anulimi i parë i liberalizimit të tregut postar ishte në vitin 2012, ndërsa i dyti ishte në vitin 2015 me propozim të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, me arsyetimin...

Fq.8

EDITORIAL

STRATEGJI E RE ME VRIMA TË VJETRA

Emin AZEMI

Në Ballkanin Perëndimor tash e tutje mund të ketë plotë vrima të zeza, për arsye se Strategjia e Komisionit Evropian, e prezantuar dje në Strasburg, ka parashikuar që vetëm Serbia dhe Mali i Zi mund të jenë gati potencialisht pas vitit 2025 për t'iu bashkuar BE-së. Nëse strategjia më e re e Brukselit mund të kuptohet edhe si përgjigje ndaj përpjekjeve të Rusisë për ndikim në rajon dhe angazhimi ekonomik në rritje të Kinës, atëherë kush mund të garantojë që këto përpjekje ruse dhe këto ndikime kineze nuk do të intensifikohen pikërisht në këtë kohë kur BE paska hequr dorë vullnetarisht nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Bosnjë e Hercegovina, vende këto me ndikime jo të pakta nga jashtë dhe me rrjedhoja negative për stabilitetin e brendshëm të tyre.

Vrimat e zeza që po lihen nga Brukseli, askush nuk do të donte t'i mbushte me politika destruktive e destabilizuese, por vetë strategjia e BE-së me këtë qasje paraqet në vetvete njëfarë destabiliteti, sepse shpërblehen vendet si Serbia që ende nuk pagoi bilancet morale, financiare e politike për krimet e gjenocidet e kryera në BeH, Kosovë e gjetiu, kurse lihen nën mëshirën e oligarkive politike-mafioze vendet si Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bonjë e Hercegovina. Çfarë kurajo është kjo për të rinjtë e këtyre vendeve, kur në strategjinë e re të BE-së nuk shohin kurrfarë kandili evropian që do të paralajmëronte dritën në fund të tunelit ballkanik. Dihet që lojaliteti i skajshëm i qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës ndaj vlerave e institucioneve Perëndimore, nuk ishte gjithmonë në përpjesëtim të drejtë me politikat vendore që udhëhoqën elitat politike të këtyre vendeve, sidomos në fushat ku shteti i së drejtës, reformat, korrupsioni, narkotrafiku etj. janë ende terrene të minuara nëpër të cilat e kanë vështirë të kalojnë rekomandimet e Brukselit, por, në anën tjetër, përvoja ballkanike (Bullgaria, Rumania), në të kaluarën, ka krijuar plot precedente që e ka bërë politikën e zgjerimit të BE jo gjithmonë konsekuente.

Ka të ngjarë që kjo jokosekuencë të vazhdojë edhe në të ardhmen, sidomos në rastin e Serbisë, e cila është shkaktari kryesor që Ballkani Perëndimor u vonua me politikat e përafrimit dhe aderimit në BE. Nëse në të kaluarën Serbia ka qenë frika më e madhe e Brukselit për ndonjë shkarje gjeostrategjike të sajën drejt Rusisë, ky nuk është kurrfarë justifikimi që BE të aplikojë standarde të dyfishta në strategjitë e saja të zgjerimit. Aq më tepër kur lënia jashtë përfshirjes së kësaj strategjie, të tre, katër shteteve të Ballkanit Perëndimor, përpos që krijon parakushte për frustrime të përgjithshme sociale e politike, mund të prodhojë edhe disponime shtesë antievropiane, sidomos te gjenerata e re e cila deri para pak kohësh shpresat e së ardhmes i kishte mbështetur te BE.

Pafuqia e njeriut të thjeshtë të Ballkanit Perëndimor që përmes votës (gjysmë)të lirë të ndikojë në ndryshimin e kulturës politike dhe stilit qeverisës në vendet e tyre, ka qenë dashur të kuptohet nga burokratët e Brukselit si thirrje për ndihmë drejtuar atyre, sepse vrimat e zeza pikërisht në këto mjedise mund të formohen, kurse kandilat përpëlitës evropianë të zëvendësohen me llamba të fikura vajguri. Çfarë meritash paskan më tepër të rinjtë e Serbisë, se sa të rinjtë e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, BeH në mediatizimin e temave proevropiane të cilat iu paskan bërë aq shumë përshtypje burokratëve të Brukselit para se ta hartojnë strategjinë e re për Ballkanin Perëndimor. Votuesit ne Serbi ka vite që përcaktohen për politikat shtetërore të ish radikalëve serbë që aktualisht janë në pushtet dhe çfarë evropianizimi sheh Brukseli në frymën e përgjithshme shoqërore dhe të fqinjësisë së mirë që po krijokan këta votues. Apo, ndoshta, involvimet e Beogradit në Kosovën e veriut, atje ku mafia bën ligjin dhe ku institucionet e Kosovës nuk mund të shtrijnë kapacitet e veta shtetndërtuese, mund të jenë kritere të reja të "fqinjësisë së mirë", për të cilat tash e tutje duhet të angazhohen edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor , duke i marrë si model pikërisht këto sjellje "evropiane" të Serbisë ndaj Kosovës.

Autorët e Strategjisë së re të BE-së a kanë qenë ndonjëherë në Nishi, sepse afër këtij qyteti Rusia ka një "ishull" me status diplomatik, që në semantikën ballkanike të keqinterpretimeve mund të ketë konotacione të ndryshme. Prandaj, i mbetet BE-së të ndezë edhe më shumë kandila, për t'ia ndriçuar edhe më tepër rrugët Serbisë që shpijnë nga Moska. Të tjerët në Ballkanin Perëndimor mund të mjaftohen me sheqerkat e Mogherinit e Hahnit të mbështjellë me lajme premtuese të gazetave që forcojnë edhe më tej status-quon e oligarkive antievropiane.

TRI POROSITË PËR KOSOVËN

"Tri porosi të rëndësishme të BE-së për Kosovën dhe udhëheqjen e saj: E para, falë udhëheqjes së vendit gjatë këtyre dhjetë vjetëve Kosova i ka ndihmuar Serbisë që të bëhet , nëse vazhdon me këtë ritëm, vend anëtar i BE-së më 2025. E dyta, falë udhëheqjes së saj, Kosova bën pjesë në vende 'që tregojnë elemente të qarta të shteteve të kapura, përfshirë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe përzierje të fuqishme të interesave publikë dhe privatë'.

Në këtë vend ekziston 'ndërhyrje e gjerë politike në media dhe kontroll mbi to'. Dhe e treta, rrjedhimisht, falë udhëheqjes së saj , Kosova ka mundësi të bëjë përparim të qëndrueshëm , aq sa ka mundur të bëjë më 2003 në Samitin e Selanikut , pra kapaku i përcaktimin të ardhmërisë lidhet 'me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të avancojë në rrugën e saj evropiane kur të lejojnë rrethanat objektive'", shkruan në profilin e tij në FB, publicisti nga Kosova, Veton Surroi.

GJYKATË FUNKSIONALE DHE NËSE KOSOVA DO TË HIQTE DORË

"Është kriju atmosfera se nuk bën me u prish me partnerët strategjikë dhe ky është përfundim i logjikshëm i kësaj nisme. Ka qenë e qartë edhe më herët se nuk do të vazhdohet me këtë procedim. Tash u bë edhe formalisht u pranu. Zmbrapsja erdhi pasi është krijuar atmosfera se nuk bën të prishen marrëdhëniet me ndërkombëtarët, të cilët u alarmuan se shfuqizimi i Speciales do të thoshte izolim total i Kosovës. Nisma për zmbrapsjen e Gjykatës nuk do të kishte asnjë efekt, marrë parasysh se ajo është funksionalizuar dhe nuk do të merrej parasysh çfarëdo tentative nga Kosova. Kjo nismë s'do të kishte asnjë efekt sepse gjykata tashmë është funksionale dhe nëse Kosova do të hiqte dorë nga përkrahja, ajo do të vazhdonte në formën tjetër me stafin e njëjtë, e ndoshta edhe me përfaqësimin e disa shteteve si Rusia, kështu që ky është epilogu më i mirë. Por, pse u kthyen mbrapa Veseli, Haradinaj e Thaçi? U treguan pasojat dhe u pa që nuk arrihet asgjë. E, krejt ajo zhurmë për shfuqizimin e Speciales, mund të ketë qenë manovrim për të zbardhur fatin e tyre me të filluar punën kjo gjykatë. E kanë pa se pasojat janë të e rënda dhe nuk arrihet asgjë me këtë politikë. Por, ndoshta ka qenë edhe një manovër politik për me e kuptu prapavijën a do të jenë të akuzuarit edhe dikush prej tyre edhe të bëjnë presion që kjo gjykatë të mos të shtrihet deri shtrihet deri te nivelet më të larta. Nuk jemi të sigurt nëse është arritur ndonjë marrëveshje të fshehtë", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Shkëlzen Maliqi.

MEDIACitate

Gazeta greke Ta Nea e hap numrin e saj të sotëm me një intervistë të kryeministrit shqiptar, Edi Rama, ku ai përgjigjet për çështjen çame dhe marrëveshjen e detit me fqinjin tonë jugor. Rama shprehet se në rolin e Kryeministrit është "angazhuar që të ndërtojë një marrëdhënie strategjike midis Greqisë dhe Shqipërisë e bazuar në respekt të ndërsjellë dhe në besim për të ecur drejt një të ardhme të mirë për të dy popujt". Lidhur me çështjen çame kreu i qeverisë argumenton se ajo është trajtuar si shfaqje e një agjende të fshehtë për krijimin e Shqipërisë së Madhe. "Një pretendim i tillë territorial thjesht nuk ekziston. Nuk mund të jem dakord më shumë se kaq me ju përveç se çështje territoriale midis Greqisë dhe Shqipërisë nuk mund të ekzistojë. Burimet që e nxisin një fantazi të tillë, që nganjëherë gjejnë vend në cepat e skajshëm/ekstremë të

ΤΑ ΝΕΑ
ΣΥΝΕΝΤΕΥΞΗ
Εντι Ράμα
Οι Τσάμηδες είναι Αλβανοί με δικαιώματα

skenës politike, kërcënojnë për të shtrembëruar të vërtetën dhe për të minuar të ardhmen", thotë Rama. Kryeministri më tej shton se është absurditet që në shekullin e XXI, "njerëz të plakur burra dhe gra të Çamërisë, e kanë të ndaluar të kalojnë kufirin" e Greqisë fqinje, sepse rrënjët e tyre janë nga një rajon i këtij vendi. "E njëjta gjë ekziston dhe për absurditetin e ruajtjes së Ligjit të Luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë, një fantazëm e gjallë e së shkuarës që qëndron pezull midis nesh, pasojat ligjore të të cilit krijojnë pengesa të padurueshme për qytetarët që përmenda më lart por edhe për shumë të tjerë", nënvizon kreu i ekzekutivit. Sipas Ramës "jemi pranë një marrëveshje për kufirin detar, e cila do të jetë e drejtë dhe për Shqipërinë dhe për Greqinë". Në fund, Rama thekson se gjendemi aktualisht në një pozicion për t'i përmirësuar në mënyrë të rëndësishme marrëdhëniet bilaterale, duke përballuar çështjet e të shkuarës me dinjitet.

(Ta Nea, 6 shkurt)

NËSE NUK E KENI DITUR...

E DINI Ç'KA NDODHUR ME MURIN E BERLINIT?

Muri i Berlinit, simboli i një Gjermanie të ndarë dhe një bote të pasluftës, e ndarë mes bllokut perëndimor dhe atij lindor, sot shënon saktësisht 28 vjet, dy muaj dhe 26 ditë që pas shembjes së tij, ekuivalente me kohën gjatë së cilës ai qëndroi i ngritur. Sot, Muri i Berlinit shënon po të njëjtën gjatësi kohe që nga momenti i shembjes së tij, me atë gjatë të cilës ai ka qëndruar i ngritur. Gjermania Lindore komuniste fillojë ta ndërtojë Murin e Berlinit, më 13 gusht 1961. Në mënyrë efektive, ky mur, vulosi ndarjen e Berlinit Perëndimor nga Berlini Lindor dhe zonat përreth Gjermanisë Lindore. Muri i Berlinit u shemb mbrëmjen e 9 nëntorit 1989, duke i hapur rrugën ribashkimit të Gjermanisë më 3 tetor 1990.

PUBLIKOHET STRATEGJIA E BE-SË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

EDHE SHTATË VJET JASHTË BE-së

Negociatat mund të nisin në mot, ndërsa anëtarësimi - pasi të zgjidhen kontestet mes fqinjëve. Serbia dhe Mali i Zi shënohen si lidere në rajon, ndërsa Maqedonia dhe Shqipëria potencohen si vende "larg" kushteve që i kërkon Bashkimi Evropian". Me një fjalë, asnjëri nga vendet e Ballkanit Perëndimor deri në 2025-ën nuk duhet të shpresojë në anëtarësimin e plotë në BE

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 6 shkurt - Vendet nga rajoni do të bëhen anëtare të BE-së, por jo në gjendjen në të cilën ndodhen sot. Mali i Zi dhe Serbia edhe më tej identifikohen si lidere në rajon, kështu që pranimi i tyre në BE parashihet deri në fund të vitit 2025, me atë që negociatat inkuadruese do të përfundonin në vitin 2023. Vitin e njëjtë, kur liderët në rajon do t'i përfundojnë negociatat, parashihet fillimi i procesit me Bosnjë e Hercegovinën, ndërkohë që Maqedonia dhe Shqipëria pritet t'i fillojnë negociatat në vitin 2019. Fundi i vitit 2019 është afati deri në të cilin Serbia dhe Kosova do të duhej të arrijnë marrëveshje për normalizimin gjithpërfshirës të marrëdhënieve. Kështu thuhet në Strategjinë për Ballkanin Perëndimor, të prezantuar dje nga komisarja e lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Federika Mogerini dhe eurokomisari për zgjerim, Johanes Han, ndërsa theks i veçantë i është vënë dy pikave kryesore: zgjidhja e kontesteve bilaterale dhe dialogut mes Serbisë dhe Kosovës. Zyrtarisht, Strategjia që u prezantua në Strasburg, autoriteteve të Maqedonisë ju është dorëzuar nga euroambasadori Zhbogar, ndërsa delegacioni i BE-së në Shkup kishte organizuar transmetim të drejtpërdrejtë të konferencës për shtyp nga Hani dhe Mogerini. Sundimi i së drejtës, siguria e emigrantëve, zhvillimi social-ekonomik, mirëqenia tregtare në rajon dhe kujdesi për marrëdhënie të mira ndërfqinjësore është ajo që pret nga vendet aspirante BE-ja, me theks të veçantë për 6 vendet për të cilat është përpiluar Strategjia, ka informuar eurokomisari Han. Në Strategji, siç theksuan Han dhe Mogerini, shpresohet që në vitin 2025, të jetë vit i mundshëm për pranimin e anëtarëve të ri në Bashkimin Evropian, por kriteret patjetër të jenë të plotësuara.

"Nuk do të ndodhë të thuhet se ajo do të zgjidhet pasi që të hyhet në BE. Problemet duhet të zgjidhen para inkuadrimit ose nuk do të ketë zgjerim të mëtutjeshëm", deklaroi Junker. Ai u shpreh se viti 2025 nuk është vit kur Mali i Zi dhe Serbia "duhet" të jenë në BE, por ajo është datë indikative dhe inkurajim për ato vende, të cilat përparuan më shumë në rrugën drejt Unionit

"Ky nuk është një afat kohor kur duhet të bëhet diçka, por një perspektivë realiste në periudhën kohore kur disa vende pritet të përfundojnë ciklin e negociatave dhe ata që nuk kanë filluar të fillojnë. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e Evropës gjeografikisht, ato ndajnë të njëjtën histori me vendet anëtare të BE, trashëgimi kulturore, sfida dhe interesa. Sot ky është mesazhi jonë, që ne do të ndajmë një të ardhme të përbashkët brenda BE. Shqipëria dhe Mali i Zi janë në 100% me politikën e jashtme të BE, dhe mund të vazhdojë që janë shembuj, dhe jo problème që duhet të evitojmë, por dhe shanse që mund të eksplorojmë në maksimum vetëm nëse jemi bashkë. Kjo strategji sot jep një perspektivë të qartë për integrimin e të 6 partnerëve. Është e qartë se janë reforma të veçanta që qytetarët të gëzojnë të drejta të njëjta me qytetarët e BE. Kemi parë dhe shohim shumë reforma që vijojnë në rajon, të karakterizuar nga një vendosmëri e fortë që liderët e Ballkanit kanë bërë zgjedhje të qartë të çojnë vendin në BE, gjithkush në ritmin dhe kohën e vet, por drejtimi është i qartë. Sot i themi se dhe ne bëjmë të njëjtën zgjedhje", tha Mogherini.

Ajo shtoi se 2025 nuk është vetëm një target për anëtarësimin, por një perspektivë realiste për, siç tha ajo, të kompletuar procesin e zgjerimit për ato që po negociojnë dhe që do të nisin negociatat në të ardhmen. "Pres që dhe vendet e tjera në muajt e ardhshëm të nisin negociatat. Sot nuk kemi adoptuar vetëm një Strategji, por kemi hapur një rrugë që në muajt e ardhshëm të na sjellë vendime të tjera. Raportet vjetore do të publikohen në prill, do kemi Samitin BE-Ballkan Perëndimor në maj dhe një vendim të mundshëm të Këshillit në qershor. Strategjia mbështet këtë agjendë me iniciativa të qarta", u shpreh Mogherini.

Në ndërkohë, kryetari i Komisionit Evropian, Zhan-Klod Junker deklaroi dje para eurodeputetëve se asnjë vend nga Ballkani nuk do të pranohet në BE para se t'i zgjidhë kontestet kufitare me fqinjët. "Nuk do të ndodhë të thuhet se ajo do të zgjidhet pasi që të hyhet në BE. Problemet duhet të zgjidhen para inkuadrimit ose nuk do të ketë zgjerim të mëtutjeshëm", deklaroi Junker. Ai u shpreh se viti 2025 nuk është vit kur Mali i Zi dhe Serbia "duhet" të jenë në BE, por ajo është datë indikative dhe inkurajim për ato vende, të cilat përparuan më shumë në rrugën drejt Unionit. "Dëshirojmë të shohim zgjerim të Ballkanit Perëndimor, por nuk duam të shohim hyrje pa përmbushje të kushteve. Ato ende nuk i kanë përmbushur kushtet, ndërsa disa vende janë larg asaj", deklaroi Junker para Europarlamentit.

NË BE S'KA SHTETE QË KANË PROBLEM ME FQINJËT

"Siç e dini se marrëdhëniet e mira ndërfqinjësorë janë ndër principet themelore të Bashkimit Evropian dhe ka të bëjë me të gjitha shtetet. Të gjitha problemet që kanë të bëjnë me fqinjët, si kufijtë apo çështja e emrit duhet të zgjidhet para se të bëhemi pjesë e BE-s, pasi që BE-ja nuk pranon shtete që kanë çështje të hapura. Riaktivizimi i bisedimeve Maqedoni-Greqi, është një hap i mirë, ne nuk jemi pjesë negociuese, nuk kam hollësi dhe nuk mund të marrim pozitë në lidhje me këtë. Negociatat janë duke u zhvilluar dhe duhet të vazhdojnë në atë drejtim që të ketë zgjidhje", u shpreh ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedonisë, Samuel Zhbogar, pas publikimit të Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Zhbogar si shembull për marrëdhënie të mira ndërfqinjësore e përmendi marrëveshjen Maqedoni-Bullgari dhe të njëjtën e cilësoi tejkalim të çështjeve të ndjeshme. "Në muajt e kaluar kemi parë disa hapa motivuese, si marrëveshja Maqedoni-Bullgari, që paraqet një mënyrë se si dy shtete arritën të tejkalojnë çështjet e ndjeshme, e veçanërisht tashmë që Bullgaria është kryesuese e BE-së", tha Zhbogar.

REFORMAT E NGADALSHME TË QEVERISË

Qëllimi i Komisionit Evropian është që të japë rekomandim të pastër për fillim të negociatave për anëtarësim të Maqedonisë, por vendimin final për këtë e japin të gjitha vendet-anëtare, është shprehur ndërkaq në intervistën për TV Nova, eurokomisari për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johanes Han. Për kontestin me Greqinë, që e ka bllokuar rrugën e Maqedonisë drejt BE-së, Han thotë se BE bën gjithçka që t'i lehtësojë bisedimet dypalëshe mes Shkupit dhe Athinës. "Është me rëndësi që kolegët nga Shkupi dhe Athina të ulen në tryezë të përbashkët, të ndërtojnë besim dhe të gjejnë zgjidhje. Marrëdhëniet mes dy ministrave të punëve të jashtme janë të mira, si dhe mes dy kryeministrave dhe unë jam optimist se do të mund të gjejnë zgjidhje të përhershme dhe zgjidhje të qëndrueshme", thotë Han. Lidhur me Strategjinë për Ballkanin Perëndimor, Han thotë se me këtë i jepet perspektivë e qartë vendeve të rajonit për atë se vendin e kanë në BE. "Strategjia është udhërrëfyes për tre vitet e ardhshme, në gjashtë sfera të ndryshme, për të cilat janë propozuar 57 projekte konkrete në zhvillimin ekonomik, sundimin e drejtësisë, digjitalizimin, kontakte e drejtpërdrejta mes qytetarëve...", sqaron eurokomisari. Sipas tij, nëse Maqedonia arrin ta bëjë hapin e ardhshëm drejt eurointegrimeve dhe fillon bisedime me BE-në, kjo do t'i sjellë bum investues, duke e theksuar si shembull Serbinë fqinje. Lidhur me reformat në Maqedoni, eurokomisari Han vëren se ato janë mjaft të ngadalshme dhe se nevojitet intensifikim i tyre. Han shpreson se kur bëhet fjalë për prioritetin nacional, siç janë perspektiva evropiane - për realizmin e saj do të duhet të kyçet në mënyrë aktive edhe opozita.

Nëse lihet për n'mot, s'ka zgjidhje te emrit

Shkup, 6 shkurt - Zëvendëskryeministri i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani vlerëson se viti 2018 është viti kur duhet të zgjidhet kontesti me Greqinë për emrin, se vitin tjetër ndodhin rrethana të reja, rezultati i së cilave nuk mund të parashihet. "Katrorët janë vendosur, duhet gjetur zgjidhje dhe kjo të materializohet në hapa konkretë. Në vitin 2019 katrorët zhvendosen. Arsyet janë të qarta. Në vitin 2019 e mbarë Evropa është në zgjedhje për Parlamentin Evropian, Greqia ka zgjedhje edhe Maqedonia gjithashtu dhe vështirë do të jetë edhe brenda shteteve të gjejmë mundësi për zgjidhje. Prandaj them se viti 2018 është jorelativ", theksoi Osmani në intervistën për emisionin "Vetëm e vërteta" në Kanal 5. Shton se nëse këtë vit nuk gjendet zgjidhje, hyhet në një periudhë të paparashikueshme, e ngjashme me atë pas Samitit në Bukuresht. "Si politikanë të përgjegjshëm nuk guxojmë një shtet të vogël, fragjil ta lëmë vetëm në një periudhë të paparashikueshme", deklaroi Osmani. Zëvendëskryeministri Osmani pret që opozita të kthehet në Parlament dhe të sigurohet konsensusi i nevojshëm për ligjet reformuese. Lidhur me Ligjin për gjuhët dhe numrin e madh të amendamenteve të dorëzuara nga opozita Osmani pret se ajo do t'i tërheq. BDI mbetet me qëndrimin se ka nevojë për kandidat konsensual për zgjedhjet presidenciale vitin e ardhshëm, pasi që, siç tha Osmani presidenti është faktor koheziv i shoqërisë dhe duhet ta reflektojë vullnetin të paktën të të dyja bashkësive etnike.

REKOMANDIME QË LEHTËSOJNË MËSIMIN E MATEMATIKËS

LEJONI NXËNËSIT TË LLOGARITIN ME GISHTA

"Mësimdhënësit duhet t'u japin mundësi nxënësve në klasat fillestare t'i përdorin gishtërinjtë ose mjetet e ndryshme manipuluese (shkopinj, pllaka dhe të ngjashme) me qëllim që ta kuptojnë konceptin për numrat dhe të zhvillojnë shkathtësi për përdorim të tyre në aktivitete të ndryshme praktike", thuhet në njërin prej tre rekomandimeve për mësimin sa më cilësor të matematikës në shkollat fillore

Koha Laura PAPRANIKU

Shkup, 6 shkurt - Mësimi përmendësh është padyshim strumbullari i të gjitha problemeve që kanë të bëjnë me cilësinë e dobët të mësim-nxënies në nivelin e arsimin parauniversitar në Maqedoni. Këtu e vënë theksin jo vetëm pedagogët dhe metodistët e lëndëve të ndryshme, por edhe institucionet me renome ndërkombëtare, të cilët analizojnë shkaqet e renditjes në vendet e fundit të testimeve PISA. Kështu, kur në testimin e para dy viteve, 15 vjeçarët nga Maqedonia u radhitën në vendin e 67 në mesin e 70 vendeve të botës sa i përket nivelit të dijeve nga lënda e matematikës Organizata Qytetare "Finance Think", e cila bën analiza për nevojat e shteteve të OECD-së, kishte piketuar si problematike metodat e vjetra të mësimdhënëses në shkollat tona. Duke vlerësuar rezultatet për nxënësit nga Maqedonia, mes tjerave ishte konstatuar si problematike "dominimi i metodave tradicionale me të cilat mësimdhënësit janë përcjellës të dijeve kurse nxënësit pranues pasiv", dhe "metodat e mësimit faktografik apo të mësuar përmendësh". Në ndërkohë, një hulumtimi i brendshëm i realizuar nga Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi" e kishte konstatuar të njëjtin fakt si problemin gjithashtu të madh të mësimit në lëndën e matematikës. "Llogaritja përmendësh është strategjia e përdorur te nxënësit gjatë mbledhjes, zbritjes dhe zgjidhjes së detyrave tekstuale", është njëri prej tre konstatimeve të hulumtimit për mësimin e matematikës te nxënësit e klasave të II, III dhe IV. Në dy konstatimet tjera qëndron se "në fushën e matematikës, për nxënësit e klasave II dhe III detyrë më e vështirë është zbritja, e pas saj janë detyrat tekstuale" si dhe se "ulja e rezultateve në mbledhje dhe zbritje te nxënësit e klasës IV te mostra longitudinale është shenjë brengosësh se nxënësit nuk i kanë përsosur këto operacione themelore matematikore". Pra, në Maqedoni, sipas hulumtimit i cili përfshiu rreth tetë mijë nxënës të gjitha shkollave fillore, shkohet në klasë V ku nisin dhe avancohen detyrat matematikore pa fituar paraprakisht njohuritë bazike në këtë lëndë. Kjo, sipas profesorëve të lëndës e komplikon ende më shumë situatën. "Pa njohuritë bazike, të cilat mësohen në ciklin e ultë, mësimi i matematikës me logjikë do të jetë i pamundur në nivelet më të larta të shkollimit. Është njëlloj si të mos kesh mësuar Alfabetin dhe të pretendosh shkrimin dhe leximin", thotë matematikani Fitim Dika. Problemi, sipas tij, qëndron në faktin se lënda e matematikës në shkollat fillore (ciklin e ulët) punohet me kuadër jo edhe aq të kualifikuar për këtë lëndë. Prandaj, vëren më tej ai, ata që mbarojnë fakultetet pedagogjike, konkretisht grupin klasor, duhet të pajisen me më shumë kompetenca për mësimdhënien e matematikës ose të gjendet një model për angazhimin e kuadrit të përshtatshëm për dhënien e mësimeve në këtë lëndë. Sepse, pasojat janë vërtetë të rënda, pohon Dika, profesor i matematikës në Shkollën e Mesme "Cvetan Dimov" në Shkup. "Ne na ndodh që të na vijnë në shkollat e mesme nxënës të cilët nuk dinë shumëzimin dhe pjesëtimin, nuk njohin operacionet elementare të matematikës. Imagjinoni pastaj që ato nxënës, të cilët për fat të keq nuk janë pakicë, të duhet të mësojnë algoritmet apo njësi të ngjashme matematikore", thotë ai, ndërsa nënvizon opinionin e përgjithshëm të nxënësve se "matematika është lëndë e vështirë". Nuk është lënda e vështirë, por problemi i ngecjes së mësimit të saj në nivelet e ulëta të shkollimit e që më vonë pamundësojnë mësimin me logjikë të matematikës në nivelet e më pastajme, sqaron Dika duke plotësuar se mësuesit duhet të gjejnë metodat që më së tepërmi u përshtaten nxënësve për mësimin e kësaj lënde. Ndodh rëndomë nëpër shkollat fillore që mësuesit të kërkojnë prej nxënësve të mos përdorin gishtërinjtë për mbledhjen dhe zbritjen e numrave. Mirëpo, hulumtimi i Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi" vëren se është shumë e gabuar kjo qasje e mësuesve. Përkundrazi, përdorimi i gishtërinjve sipas rekomandimeve të hulumtimit duhet të shfrytëzohet si metodë me ët cilën do të lehtësohej mësimi i matematikës. "Mësimdhënësit duhet t'u japin mundësi nxënësve në klasat fillestare t'i përdorin gishtërinjtë ose mjetet e ndryshme manipuluese (shkopinj, pllaka dhe të ngjashme) me qëllim që ta kuptojnë konceptin për numrat dhe të zhvillojnë shkathtësi për përdorim të tyre në aktivitete të ndryshme praktike". Ky është njëri prej tre rekomandimeve të hulumtimit për mësimin e matematikës në shkollat fillore në Maqedoni. Në dy rekomandimet tjera propozohet që " nxënësve t'ju jepet më shumë kohë për ushtrimin e shkathtësive themelore matematikore që të mbyllet hendeku i krijuar me zbatimin e programit të ri mësimor në matematikë" dhe që "mësimdhënia në matematikë në klasat fillestare të përqendrohet te komponentët e të kuptuarit, të gjykuarit dhe zbatimit të njohurive matematikore". Kjo, sipas të njëjtit rekomandim, do t'u krijon mundësi nxënësve ta ushtrojnë llogaritjen si pjesë të aktiviteteve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe jo vetëm memorizimin e rregullave, formulave dhe procedurave.

QEVERIA E SHKUPIT DHE ATHINË

Të përkushtuar për kontestin

Shkup, 6 shkurt - Qeveritë e Maqedonisë dhe Greqisë vazhdojnë me përpjekjet për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar rreth emrit dhe mbeten të përkushtuara në procesin edhe krahas reagimeve në qarqe të caktuara në Greqi edhe pas protestave të së dielës në Athinë. Qeveria e Maqedonisë kërkon zgjidhje dinjitoze të çështjeve të hapura me Greqinë. "Qeveria e Republikës së Maqedonisë është e përkushtuar në ndërtimin e besimit me Qeverinë e Republikës së Greqisë, me qëllim të qartë me dinjitet të zgjidhen çështjet e hapura të dy vendeve fqinje evropiane", deklaruan për MIA-n nga Qeveria e Maqedonisë lidhur me protestën në Athinë. Kabineti i kryeministrit grek Aleksis Cipras theksoi se shumica e qytetarëve grek, të cilët protestën e ndoqën përmes ekraneve televizive, vlerësojnë se çështjet e rëndësishme të politikë së jashtme nuk duhet të ballafaqohen me fantazmë dhe jotolerancë. "Qeveria greke nuk ka për qëllim ta ndryshojë politikën e jashtme. Politika e jashtme nuk zhvillohet me tubime dhe plani qeveritar mbetet në fuqi", deklaroi një përfaqësues i Qeverisë së Ciprasit. Edhe shefi i diplomacisë, Nikos Koxijas kumtoi se protestuesit nuk do ta ndryshojnë drejtimin e politikës së jashtme posaçërisht drejtë çështjes për emrin. "Vazhdoj me ndërgjegje të qetë dhe përgjegjësi të negocioj për të mirën e atdheut", shkroi Koxijas në Tuiter. Partneri i koalicionit në Qeverinë greke dhe ministër i Mbrojtjes, Panos Kamenos, i cili nga momenti i parë e mbajti protestën, vlerëson se "tubimi ka qenë shpriti i Greqisë". Protesta për "mbrojtjen e emrit Maqedoni" përfundoi me leximin e rezolutës, në të cilën organizatorët kërkojnë të përjashtohet "çdo mundësi për përdorimin e emrit grek Maqedonia dhe fjalët e shqiptuara". Rezolutën, përfaqësuesit e shoqatave - organizatore ia dhuruan presidentit grek, Prokopis Pavlopulos. Ai, megjithatë, dje deklaroi se parakusht për hyrje në NATO dhe BE është emri të zgjidhet në mënyrën në të cilën do të përjashtohet çdo lloj i irredentizmit.

SOPOTI SËRISH NGA FILLIMI

14 VITE NË KËRKIM TË DREJTËSISË

Me shikim dhe dëgjim të dobësuar, i lodhur e i rraskapitur, megjithatë shpirtërisht i interesuar që e vërteta të zbulohet, baca Sulë iu drejtua Trupit të ri gjykues dhe kërkoi që sa më shpejtë të jetë e mundur drejtësia të dalë në shesh

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 6 shkurt - Përgjatë 15 viteve të kaluara, banorët e fshatit "Sopot" edhe më tej vazhdojnë të enden nëpër korridoret e gjykatave. Bindja e palëkundshme që të vërtetojnë pafajësinë e tyre, në asnjë moment plakun 73-vjeçar, Sulejman Sulejmanin, nuk e ka lëkundur të tërhiqet nga zbardhja e plotë e rastit, gjegjësisht faktit se ai dhe të tjerët nuk kanë fare lidhje me vrasjen e ushtarëve polak. Me shikim të dobësuar, duke u mbajtur në bastunin e tij, baca Sulë të martën përsëri u paraqit në Gjykatën Penale të Shkupit. Sistematizimi i ri i gjykatësve në këtë Gjykata, ndikoi që edhe për këtë rast të caktohet Këshill i ri Penal. Kësaj radhe, ashtu siç qindra herë deri më tani, të akuzuari e rastit "Sopoti" - Zenel dhe Hasan Klaiqi, Shaban Limani, Samet Luftiu dhe Shaqir Sulejmani, përsëri u prononcuan lidhur me aktakuzën që ju ngarkohet, të cilët tashmë e disa muaj e përfaqëson Prokuroria Speciale Publike. "Ne e dimë aktakuzën dhe qëndrojmë në të gjitha deklaratat e mëhershme që i kemi dhënë, se nuk kemi asnjë lidhje me rastin", thanë të akuzuarit njëzëri. Me shikim dhe dëgjim të dobësuar, i lodhur e i rraskapitur, megjithatë shpirtërisht i interesuar që e vërteta të zbulohet, baca Sulë iu drejtua Trupit të ri gjykues, në krye me gjykatësin Darko Todorovski, dhe i kërkoi që sa është e mundur më shpejt drejtësia të dalë në shesh për këtë ngjarje. "Tepër u bo. Kanë kaluar 14 vite që jemi duke qarkulluar nëpër gjykata. Goxha një kohë e gjatë është kjo. E lus Zotin që sa ma shpejt të dalë në shesh drejtësia", tha i akuzuari Sulejman Sulejmani.

Avokati i Vullnet Paçuku, duke e komentuar nisjen nga e para të procesit gjyqësor, tha se nuk mban mend sa herë deri më sot, nga viti 2003 e deri më sot, ky gjykim është anuluar apo rifilluar. "Për fat të keq, është shumë e vështirë të themi një numër të saktë të Këshillave Penal (trupave gjykues) që janë ndryshuar gjatë këtyre 14 vite, me çka pas çdo ndryshimi, gjykimi për 'Sopotin' ka filluar nga e para. Seancat e anuluar po ashtu janë të shumta, ndërsa gjykatësit lidhur me këtë rast ndoshta janë ndryshuar me dhjetëra herë. Kjo është e papranueshme për një proces penal. Ne vazhdimisht kemi reaguar, po ashtu edhe vetë të akuzuarit. Megjithatë, kjo është procedura penale në vendin tonë", theksoi avokati Paçuku. Ndonëse dëshmitarët e propozuar nga PSP-ja, kësaj radhe duhej të paraqiteshin në seancë, mirëpo për shkak të ndryshimeve të theksuara, inspektorët e lartë të policisë, kryesisht pjesëtar të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, pritet të prezantohen në gjykatë më 2 mars, për kur është caktuar seanca e radhës. Kryesuesi i këtij rasti, gjykatësi Todorovski mes tjerash theksoi se gjatë marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve, opinioni dhe mediat do të largohen nga seanca. Sipas palës mbrojtëse, mos prezenca e opinionit mund të arsyetohet me faktin se këta dëshmitarë mundet të zbulojnë ndonjë informacion sekret apo diçka të ngjashme. Ndryshe, sipas pohimeve të të akuzuarve të Sopotit, prezantimi i dëshmitarëve të PSP-së, respektivisht personave të cilat siç thonë ato, e kanë montuar rastin dhe i kanë keqtrajtuar të akuzuarit, nuk paraqet ndonjë risi, për shkak se e gjithë ngjarja është montuar nga bashkëfshatarët e tyre. Listën e propozuar nga PSP-së për dëshmitarë e kryesojnë agjentët e DSK-së: Robert Ivanovski. Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Mile Andonovski (i vetmi i cili u paraqit të martën në gjykatë) dhe Marjan Nikollovski. Ky i fundit, siç thonë të akuzuarit e Sopotit, është pikërisht fqinji i tyre, i cili atë kohë ka qenë shefi i policisë sekrete në Kumanovë, ndërkohë sot ai punon si profesor në Fakultetin për Siguri në Shkup. Sidoqoftë, vlen të theksohet se me policinë sekret aso kohe ka udhëhequr Zoran Verushevski, i cili për momentin e kryen funksionin e këshilltarit për siguri në kabinetin e kryeministrit, Zoran Zaev.

Listën e propozuar nga PSP-së për dëshmitarë e kryesojnë agjentët e DSK-së: Robert Ivanovski. Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Mile Andonovski (i vetmi i cili u paraqit të martën në gjykatë) dhe Marjan Nikollovski. Ky i fundit, siç thonë të akuzuarit e Sopotit, është pikërisht fqinji i tyre, i cili atë kohë ka qenë shefi i policisë sekrete në Kumanovë, ndërkohë sot ai punon si profesor në Fakultetin për Siguri në Shkup

Rasti i Almirit mund të fillojë nga e para!

Kumanovë, 6 shkurt - Edhe një seancë gjyqësor për rastin e 4-vjeçarit Almir Aliu nga Kumanova të martën u anulua. Arsyeja e prolongimit të seancës së radhës ishte kërkesa e palës mbrojtëse dhe familjarëve të Almirit të vrarë, të cilët kërkuan shkarkimin e prokurores Suzana Kusigerska nga procedimi i mëtutjeshëm i lëndës. Gjykatësja e rastit, Maja Denkovska, lidhur me këtë kërkesë të avokatëve të familjes, u shpreh se brenda një dite nuk mund të shqyrtohet kjo kërkesë dhe kështu të miratohet vendimi. Për këtë arsye, seancën e radhës kundër vrasësit Boban Iliq gjykatësja e caktoi për më 15 shkurt. Ndryshe, gjykatësja Denkovska, duke e pasur parasysh se seanca e fundit për këtë lëndë është zhvilluar 90 ditë më parë, propozoi që i gjithë procesi të fillojë nga e para. Sidoqoftë, vrasja me dashje e Almir Aliut në korrik të vitit 2016, nga pamjet e prezantuara në opinion, nuk jep asnjë arsyetim pse kaq shumë zvarritet procesi në Gjykatën e Kumanovës. Goditja fatale me veturë, të cilën e drejtonte vrasësi Iliq, vogëlushit katërvjeçar Almir Aliut i shkaktoi plagë fatale, ndërkohë prindërit e tij pësuan lëndime të rënda trupore. Tendenca për rikualifikim të kësaj lëndë në një vepër penale "aksident komunikacioni" me pasojë vdekje, javë më parë ndikoi që para Prokurorisë Publike në Shkup të zhvillohet një proteste paqësore. Pas kësaj, kryeprokurori i ri shtetit, Lubomir Jovevski, publikisht ju drejtua elitës politike me apel që t'i largojë duart nga presioni, gjegjësisht përmes letrës publike ai bëri të qartë se procesi gjyqësor për vrasjen e Almir Aliut po procedohet në bazë të të gjitha dispozitave ligjore.

KRONIKË

Arrestohet i kërkuari për tregti me drogë

Pjesëtarë të Policisë së Gostivarit të hënën mbrëma rreth orës 18 e 30 minuta kanë arrestuar 28 vjeçarin I.J nga Gostivari. Sipas policisë, ai është i dënuar me tre vite burg për vepër penale "prodhim të paligjshëm dhe lëshim në treg të lëndëve narkotike". Pas arrestimit të realizuar me urdhër të Gjykatës së Gostivarit, ai është dërguar për vuajtjen e dënimit në burgun e Idrizovës në Shkup.

Rrahje në Gostivar, katër të lënduar

Të hënën mbrëma rreth orës 18 e 40 minuta në Gostivar, në rrugën "Major Çede Filipovski", para shtëpisë së personit me iniciale A.A 40-vjeçar, pas një zënke verbale ka ndodhur një rrahje mes personave Gj.J 59 vjeçar dhe djalit të tij M.J 38 vjeçar si dhe denoncuesit A.A. Gjatë rrahjes ka ndërhyrë një person 27-vjeçar me iniciale M.I me qëllim që ti ndajë, por ai është goditur me një pistoletë me gaz në kokë. Në këtë rrahje të gjithë pjesëmarrësit janë lënduar dhe kanë marrë ndihmë mjekësore në Spitalin e Gostivarit. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

55-vjeçari abuzon seksualisht një 8-vjeçaren

Në stacionin policor në Vallandovë, një qytetare e Vallandovës (41) ka denoncuar se një burrë i moshës 55-vjeçar nga fshati Piravë ka abuzuar seksualisht vajzën e saj tetëvjeçare, kumtoi MPB. Njeriu i denoncuar më shumë herë gjatë muajit të fundit e ka abuzuar seksualisht vajzën tetëvjeçare, ka thënë nëna e saj. Nga stacioni policor në Vallandovë theksojnë se burri i njëjtë ka tentuar ta abuzojë seksualisht edhe vajzën tjetër të gruas e cila e ka denoncuar rastin, por vajza (15) ka arritur të arratiset. Policia ndërmori masa për zbardhjen e rastit.

Shkup, gjashtë aksidente me dy të lënduar

Një person është lënduar rëndë, ndërsa një ka marrë lëndime më të lehta në dy prej gjithsej gjashtë aksidenteve të regjistruara rrugore në 24 orët e fundit në rajonin e SPB Shkup. Për katër aksidente janë regjistruar dëme materiale. Policia e trafikut ka sanksionuar 28 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara dhe ka përjashtuar nga komunikacioni 11 shoferë, prej të cilëve nëntë para se të fitojnë të drejtën e ngasjes së automjetit motorik dhe dy fillestarë. Janë përjashtuar nga komunikacioni 13 automjete të paregjistruara, ndërsa janë sanksionuar 91 shoferë për parkim të padrejtë dhe me "karrotrecin" janë mënjanuar 86 automjete. Shtatë shoferë janë dënuar për tejkalim jo të drejtë edhe shtatë për mos posedim të pajisjeve dimërorë, si dhe nga tre për rreshtim jo të drejtë, se nuk u kanë dhënë përparësi kalimi automjeteve dhe këmbësoreve dhe për kalim të udhëkryqit në dritë të kuqe. *(U.H)*

VITI 2018 FILLON KEQ, RRITET NUMRI I AKSIDENTEVE

PËR 37 DITË, DY VIKTIMA NË RRUGËT E TETOVËS

Nga policia raportojnë se janë kontrolluar 3958 automjete, ndërsa tek 1220 vetura janë konstatuar mangësi të shumta. Gjatë muajit të kaluar, nga komunikacioni janë larguar 147 vozitës me ç'rast 54 prej tyre kanë drejtuar automjetin me regjistrim të skaduar, ndërsa njëri ka vozitur me automjet jo të rregullt teknik, ndërsa 65 kanë drejtuar automjetin pa e marrë lejen



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 shkurt - Muaji shkurt ka filluar si është më keq në rrugët e Tetovës dhe rrethinës. Gjatë ditës së djeshme ka humbur jetën një 14 vjeçar nga fshati Pallçisht i Tetovës në një aksident trafiku me motoçikletë, kurse mbrëmë është regjistruar edhe një aksident në rrugën regjionale Tetovë-Vollkovijë, kur janë aksidentuar një veturë e tipit Golf me targa të Kroacisë e drejtuar nga M.D 24-vjeç nga fshati Radiovcë dhe një karrocë ku kanë qenë personat A.M 71-vjeçar dhe vajza e tij S.M, 18-vjeçare nga fshati Çellopek. Pas aksidentit, personat që kanë qenë në karrocë janë dërguar fillimisht në Spitalin Klinik të Tetovës, kurse më pas në Klinikën e Shkupit. Babai, sipas informacioneve ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore, kurse vajza është në gjendje më të mirë shëndetësore. Në ndërkohë, në muajin janar të këtij viti në Tetovë gjithsej janë regjistruar 69 aksidente apo 23 më shumë në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar. Në aksidentet e muajit janar një vozitës e ka humbur jetën për dallim nga muaji janar i vitit të kaluar nuk ka patur të vdekur. Sipas policisë, dy aksidente kanë përfunduar me tre të lënduar rëndë, ndërsa 28 me lëndime të lehta, kurse në 38 aksidente ka patur vetëm dëme materiale. Bulevardi "Ilinden" vazhdon të jetë në vendin e parë ku ndodhin më shumë aksidente, ndërsa më pas janë autostrada Gostivar-Tetovë-Shkup dhe rrugët tjera regjionale. Si shkak për këto aksidente janë mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë, mos mbajtja e distancës, mosrespektimi i përparësisë së kalimit, vozitja pa leje adekuate e kështu me radhë. Ekspertët thonë janë marrë disa masa, por nevojitet akoma më shumë që të parandalohen aksidentet. "Në Tetovë, ku kalojnë këmbësorët - si pikë më e rrezikshme është rruga 'Vidoja Smilevski Bato' apo rruga industriale. Një tjetër pikë e rrezikshme është edhe shkolla në Drenovec, po ashtu aksidente kanë ndodhur edhe tek shkolla Liria, mirëpo aksidente kanë ndodhur edhe te shkollat tjera. Ne vjet i kemi shënuar me vija të bardha vendkalimet për këmbësorë dhe për këtë vit planifikojmë që të ndërmarrim masa të tjera, që ishte edhe si propozim i policisë dhe kërkesë e banorëve të lagjes së jashtë Vardarit", thotë Elmir Mustafai, këshilltar për komunikacion në Sektorin për tokë ndërtimore dhe komunikacion. Ai thekson se edhe në rrugët rajonale duhet të ketë më shumë kontrolle. "Në rrugët rajonale, përveç kontrollit të policisë, normalisht duhet edhe sinjalizimi dhe këmbësorët të mos kalojnë vend e pavend rrugën, por në vendet e posaçme për këmbësorë. Shembull, në bulevardin "Iliria" këmbësorët nuk kalojnë në vendkalime të posaçme. Sa i takon rrugëve rajonale, duhet më shumë kontrolle të bëhen dhe normalisht të kenë më shumë kujdes dhe vozitësit që të respektojnë shenjat", u shpreh Mustafai. Nga Policia e Tetovës njoftuan se poashtu gjatë muajit janar janë regjistruar 14 dalje nga rruga si pasojë e vozitjes me shpejtësi të madhe, kurse jo rrallëherë shkaktarë të aksidenteve janë edhe kafshët që kanë qasje të lehtë në rrugë. Dita e hënë ka qenë ditë kur më së shumti kanë ndodhur aksidentet e muajt janar. Nga policia raportuan se janë kontrolluar 3958 automjete, ndërsa tek 1220 vetura janë konstatuar mangësi të shumta. Gjatë muajit të kaluar, nga komunikacioni janë larguar 147 vozitës me ç`rast 54 prej tyre kanë drejtuar automjetin me regjistrim të skaduar, ndërsa njëri ka vozitur me automjet jo të rregullt teknik, ndërsa 65 kanë drejtuar automjetin pa e marrë lejen.

I BIRI RRAH NËNËN 83-VJEÇARE

I biri me grushte e ka lënduar nënën e tij pas ç'farë është rrëzuar dhe ka marrë lëndime në kokë. Siç kumtoi MPB dje në orën 21:50 R.T. (83) ka denoncuar se në oborrin e shtëpisë së tyre në fshatin Vizbeg është sulmuar fizikisht nga ana e të birit të saj N.T. (50), i cili e ka goditur me dy grushte në pjesën e kokës dhe trupit, pas ç'farë ajo është rrëzuar në vend dhe ka marrë lëndime të dukshme në lloj të ënjtjes dhe skuqjes në pjesën e kokës. Nga MPB punojnë në ndriçimin e rastit, ndërsa në vendin e ngjarjes kanë dalë nëpunësit policorë.

Në Gjykatën Penale arrijnë 2500 kërkesa për amnisti

Shkup, 6 shkurt - Gjykata Penale deri të martën ka pranuar mbi 2.500 kërkesa për amnisti të personave të dënuar, konform Ligjit për amnisti. Nga këto kërkesa, dy të tretat janë zgjidhur dhe janë kthyer deri te burgjet, tha në brifingin me gazetarët kryetari i Gjykatës, Ivan Xholev. Kjo, siç shtoi nuk është numri i përgjithshëm i personave të dënuar, por numri i kërkesave, duke sqaruar se nja një i dënuar mund të parashtrohen edhe më shumë kërkesa, si dhe kërkesat përfshijnë jo vetëm amnisti të plotë, por edhe të pjesshme. Sipas Xholevit, është bërë kontroll në mbi 10 mijë lëndë dhe të gjitha afatet janë respektuar. Shtoi se afati prej pesë ditëve për vendim rreth kërkesës për amnisti do të ruhet edhe për kërkesat të cilat do të arrijnë deri te Gjykata në mënyrë shtesë. Vendimet e para nga Gjykata Penale, siç tha, janë lëshuar më 2 shkurt.

Nga kanceri në vit vdesin mbi 3800 persona

Shkup, 6 shkurt - Burrat më së shpeshti janë viktima të sëmundjes më të rëndë, neoplazmë malinje. Nga kanceri në Maqedoni në vitin 2016 kanë vdekur 3.882 persona, ndërsa shkalla e mortalitetit lëviz nga 138.3 në 100.000 popullatë në vitin 2010 deri në 187.3 në vitin 2016. Më së shumti të sëmurë janë nga kanceri në bronk dhe mushkëritë, ndërsa rajoni i Shkupit është në epërsi me sëmundjet abnormale. Në të dhënat të cilat dje i ka prezantuar Instituti për shëndet publik me rastin e Ditës Botërore për luftë kundër kancerit 4 shkurti i cili këtë vit është nën moton "Ne mundemi. Unë mundem", është cituar se pas rajonit të Shkupit i cili është me morbiditet më të madh vijon rajoni i Pellagonisë me 126.2 banorë në 100.000 popullatë të cilët janë shëruar në institucionet shëndetësore spitalore nga neoplazmat malinje. Drejtori i Institutit për shëndet publik, Shaban Memeti, tha se nevojitet në mënyrë kolektive të analizohen

strategjitë për kontroll të kancerit dhe të parandalohet para se të përhapet. "Qëllimi i të gjithëve është sa më pak njerëz të zhvillojnë kancerin, më shumë njerëz me sukses të trajtohen dhe të sigurohet cilësi më i mirë i jetës së njerëzve gjatë trajtimit dhe më vonë në jetë", theksoi Memeti duke e transmetuar porosinë e Sektorit për promovim, analizë dhe ndjekje të sëmundjeve joinfektive (UICC). Aktivitetet për parandalim të sëmundjeve malinje në Maqedoni zhvillohen në të gjitha tre nivelet e mbrojtjes shëndetësore. Prof.dr. Elena Qosevska ka informuar se në suaza të parandalimit sekondar çdo vit punohet në parandalimin e kancerit në qafën e mitrës, në zorrën e trashë, prostatë dhe kancer në gji, për të cilat janë siguruar skrining teste parandaluese falas. Për tre vite nga 95.519 PAP teste të analizuara, te 9.997 janë zbuluar ndryshime abnormale. Qosevska rekomandon gratë nga mosha-24-35 të bëjnë PAP teste, ndërsa burrat nga 50-55 të bëjnë PSA test parandalues. Një pjesë e mesazheve kyçe për parandalim të kancerit sipas Institutit është të krijohen shkolla të shëndetshme, vende pune të shëndetshme, qasje më e mirë deri te përkujdesja e të sëmurëve nga kanceri, investimi në kontrolle të kancerit... Neoplazmat malinje me pjesëmarrje prej 20 deri në 25 për qind janë faktori i dytë për vdekshmëri në vendet e zhvilluara në botë menjëherë pas sëmundjeve kardiovaskulare. Kanceri është përgjegjës pothuajse për një nga gjashtë raste të vdekjes në nivel global. Çdo vit te më shumë se 14 milion njerëz është diagnostifikuar kanceri, ndërsa pritet të rritet në më shumë se 21 milionë deri në vitin 2030.

KËSHILLI I KULTURËS ME ANKESA PËR PUNËN 6-MUJORE

REFORMAT QË NUK DUKEN

Anëtarët e Këshillit të Kulturës kanë kërkuar nga ministri Allagjozovski përshpejtimin e proceseve reformuese në pjesën më të madhe të sferave të kulturës. Një pjesë e vërejtjeve lidhen me moszgjidhjen e problemeve për projektin "Shkupi 2014", kushtet e këqija në një pjesë të institucioneve dhe mbrojtja e trashëgimisë

Koha — Evis HALILI

Shkup, 6 shkurt - Procesi i reformave në kulturë po ecën me ritme të ngadalta. Kjo ka qenë një prej vërejtjeve kryesore në seancën e mbledhjen e fundit të Këshillit të Kulturës, ku anëtarët e këtij Këshilli kanë kërkuar nga ministri i Kulturës, Robert Allagjozovski, përshpejtimin e proceseve reformuese në pjesën më të madhe të sferave të kulturës. Një pjesë e vërejtjeve lidhen me moszgjidhjen e problemeve për projektin "Shkupi 2014", kushtet e këqija në një pjesë të institucioneve dhe sidomos në sferën e trashëgimisë. Vërejtjet e anëtarëve shqiptarë të Këshillit lidhen me mungesën e pikave të posaçme për masat që duhet të merren për avancimin e kulturës shqiptare. Anëtari Reshat Ameti, si një prej masave më urgjente e sheh definimin e statusit të institucioneve të kulturës shqiptare, të cilat nuk kanë një funksion të qartë dhe kompetenca të kufizuara, si edhe realizimin e projekteve të ndërtimit dhe restaurimit që po zgjat me vite.

"Vazhdon një situatë e njëjtë, të themi për Galerinë e Tetovës, Qendrën e Konservimit në Gostivar, e të tjera, të cilat nuk dihet se çfarë janë - lokale, apo nacionale. Duhet të bëhen shumë reforma dhe të ecet me ritme të përshpejtuara", thotë Ameti. Ndërsa anëtari Selam Sulejmani ka kërkuar përshpejtimin e procesit të decentralizimit të kulturës dhe mangësitë në funksionimin e shumë institucioneve. Si shembull, ai ka sjellë gjendjen e keqe në Muzeun e Tetovës, tek i cili mungojnë jo vetëm artefaktet, por edhe infrastruktura e cila është shumë e dëmtuar. Plani strategjik për dy vitet e ardhshme ka marrë miratimin nga Qeveria, por Ministria e Kulturës ka bërë me dije ka mundësi që vërejtjet e Këshillit të bëhen pjesë e këtij dokumenti. Anëtari Mirosllav Gërçev ka vënë në dukje se në Planit strategjik mungojnë aktivitetet konkrete për "Shkupin 2014", i cili duhej të gjendej në top-listën e prioriteteve të ministrisë dhe po ashtu nuk janë marrë parasysh elaboratet e përgatitura prej grupit të punës. Sipas Gërçev, një situatë e tillë mund të lidhet edhe me faktin se për këtë projekt - vendimet janë politike. Situata e tillë është krijuar për shkak se Ministria e Kulturës nuk ka kompetenca për të ndërmarrë asnjë lloj aktiviteti, ka sqaruar ministri Robert Allagjozovski. "Gjatë muajve të parë të punës, Ministria e Kulturës ka qenë e destimuluar për të ndërmarrë çfarëdolloj aktiviteti në praktikë, për shkak se nuk ka kompetenca. Kemi proceduar sipas katër elaborateve, por kompetencat janë të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe komunës Qendër, prandaj nuk është parashikuar asnjë aktivitet në dokumentin e planit strategjik", ka thënë ministri. Një tjetër pikë që po ashtu nuk është prioritare në planin strategjik është edhe mbrojtja e trashëgimisë. Anëtari Vladimir Milçin ka alarmuar për situatën ku gjendet trashëgimia dhe institucionet që merren me të. "Asgjë nuk është kaq shumë e rrezikuar sa trashëgimia kulturore, nëse nuk e mbrojmë do ta humbasim", ka thënë Milçin.

REZULTATET E KONKURSIT PAS 11 SHKURTIT

Rezultatet e konkursit vjetor për projektet me interes nacional do të publikohen deri më 11 shkurt. Kështu ka deklaruar ministri Allagjozovski duke sqaruar se vonesat lidhen me numrin e madh të aplikimeve që kanë arritur. "Edhe në këtë sferë u ndeshëm me një skemë të trashëguar për marrjen e vendimeve, e cila duhet të ndryshohet. Arritëm të bëjmë vetëm disa korrektime dhe të vendosim edhe aplikimin për veprimtarinë interdisiplinare. Jemi të vetëdijshëm se sistemi i financimit duhet të ndryshojë, duhet të bëhet një revizion për mënyrën sesi është shfrytëzuar buxheti i kulturës", ka thënë ministri. Por meqenëse sistemi i financimit nuk arrin të ndryshohet për shkak të kohës së kufizuar, Ministria e Kulturës edhe për këtë konkurs do të vijojë me praktikat e viteve të mëparshme, ku sipas ministrit Allagjozovki, të dyja palët janë humbësë, edhe financuesit, por edhe aplikuesit.

Mbi 70 milionë euro për lidhje rrugore me Bullgarinë

Kumanovë, 6 shkurt - Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, të martën paralajmëroi ndërtim dhe rikonstruksion të numrit më të madh të rrugëve në rajonin e Kumanovës, me ç'rast theksoi se për ndërlidhjen rrugore planifikohen rreth 70 milionë euro, pjesë për ndërtimin e rrugëve ekspresе dhe një pjesë për rikonstruksion të rrugëve. "Konkretisht, do të ndërtohet rruga ekspresе Rankovcë-Kriva Pallankë, si dhe vazhdimi nga Kriva Pallanka deri në Deve Bair", deklaroi Sugareski gjatë vizitës në Kumanovë. Ai paralajmëroi se do të rikonstruktohen rrugët deri te fshati Opajë dhe Nikushtak, ndërsa në komunën Kumanovë do të investohet edhe në rrjetin kanalizues dhe të ujësjellësit, për çka këtë vit komuna ka përgatitur projekte, për të cilat ka në dispozicion 1,5 milionë euro nga Banka Evropiane Investuese (BEI). Kumanova është e theksuar si shembull në shfrytëzimin e financave nga kjo bankë, ndërsa Sugareski shpreson se në bashkëpunim me komunat do të gjendet mënyrë se si të shfrytëzohen 16 milionë euro tjera që janë në dispozicion të BEI. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve, ministri i Transportit përsëriti se do të respektohet afati për ndërtimin e autostradës Milladinovc-Shtip, fundi i shtatorit të këtij viti, konform aneksit të nënshkruar të marrëveshjes. Kumanova, sipas Sugareskit, do të jetë pjesë e programit për ndërtim të banesave sociale, ku është me rëndësi respektimi i kritereve për shpërndarje dhe t'u ndahen kategorive më të ndjeshme të qytetarëve. Gjatë vizitës në Kumanovë, Sugareski dhe kryetari i Kumanovës ndanë 30 vendime për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje. Apelon deri te qytetarët, të cilëve në afatin e parë u është refuzuar kërkesa për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje, për shkak të dokumentimit jo të plotë ose lëshimeve teknike, ta shfrytëzojnë afatin e vazhduar, që hyri në fuqi nga fillimi i vitit. Prej rreth 200.000 ndërtime të ndërtuara pa leje në gjithë shtetin, në Kumanovë janë zgjidhur 5.500 kërkesa për legalizim, ndërsa gjithsej kanë arritur mbi 18.000. Mbi 7.000 kërkesa, informuan nga komuna, janë refuzuar për shkak të dokumentacionit jo të plotë.

Ndërroi jetë prof.Feti Veseli

Likovë, 6 shkurt - Pas një sëmundje të rëndë, në Zvicër, në orët e hershme të ditës së martë ka ndërruar jetë profesor Feti Veseli nga Likova. I lindur më 01.06.1958 në Likovë, Fetiu ka qenë profesor i njohur i gjuhës shqipe në gjimnazin e Kumanovës, ndërsa në vitin 1988 ishte diferencuar nga pushteti i atëhershëm pasi nuk kishte pranuar nënshtrimin e pushtetit dhe kishte mbështetur profesorët shqiptarë që në ditarët e shkollës, të shënonin orët e mësimit në gjuhën shqipe. Në kohën kur u largua dhunshëm nga puna, Fetiu ushtronte detyrën e inspektorit të arsimit në Inspektoratin arsimor në Kumanovë, ndërsa deri në largimin e tij drejt Zvicrës, i njëjti në shumë raste kishte ndjerë dhunën e pushtetit komunist në Kumanovë. Varrimi i të ndjerit do të bëhet sot pasdite në varrezat e fshatit Likovë.

Bashkëpunimin me forcat speciale amerikane

Shkup, 6 shkurt - Pas përmirësimit të gjendjes politike në Maqedoni, fokusi është vendosur në qëllimet strategjike, anëtarësimi në NATO dhe në BE, porositi të martën ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në takimin me komandantin e Komandës për operacione speciale të SHBA-së në Evropë, gjeneralmajori Mark Shvarc. Siç, kumtuan nga Ministria e Mbrojtjes, bashkëbiseduesit në takimin kanë konkluduar se Maqedonia dhe SHBA-ja kanë bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm në fushën e mbrojtjes, dhe se angazhimi i përbashkët është që ky bashkëpunim të mjetë më intensiv, veçanërisht në pjesën e forcave speciale të të dy vendeve.

Shekerinska e ka informuar mysafirin se Maqedonia mbetet e përkushtuar në pjesëmarrjen e misioneve paqeruajtëse ndërkombëtare dhe në aktivitetet për stërvitje të përbashkëta me partnerët e NATO-s, me ç'farë rriten edhe aftësitë dhe kapacitetet e Armatës së Republikës së Maqedonisë. Gjenerali Shvarc e ka theksuar bashkëpunimin e shkëlqyer me ARM-në në fushën e forcave speciale dhe ka theksuar se SHBA-ja edhe në të ardhmen do ta mbështesë ARM-në në zhvillimin e kapaciteteve të saj përmes stërvitjeve dhe trajnimeve relevant. Gjenerali e ka përshëndetur vendimin për rritjen e pjesëtarëve të ARM-së në misionin "Mbështetje vendimtare" në Afganistan në vitin 2018.

POSTA NË 2018-ën

MES LIBERALIZIMIT DHE MONOPOLIT

Posta e Maqedonisë deri në fund të këtij viti do të ketë të drejtë ekskluzive që të shpërndajë letra me peshë deri 50 gram. Pas anulimit dy herë të liberalizimit të tregut postar, pritet që deri në fund të vitit të ketë subjekte të reja në këtë segment të punës, ose sërish të shtyhet liberalizimi i plotë

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 6 shkurt - Posta e Maqedonisë deri në fund të këtij viti do të ketë të drejtë ekskluzive që të shpërndajë dërgesa me peshë deri 50 gram ku bëjnë pjesë letra, kartolina dhe fletë-llogari të ndryshme. Pas anulimit dy herë të liberalizimit të tregut postar në vend, pritet që deri në fund të vitet ose sërish të vendoset nga ana e qeverisë së re për hapje të tregut për lojtarë të ri në këtë segment të punës, ose të ketë sërish shtyrje të liberalizimit të tërësishëm të të gjithë shërbimeve postare. Sipas ligjit, aktualisht afro 20 kompani të ndryshme private nuk munden të kryejnë dorëzimin e letrave , por vetëm të dërgesave më të rënda se 50 gram. Anulimi i parë i liberalizimit të tregut postar ishte në vitin 2012, ndërsa i dyti ishte në vitin 2015 me propozim të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, me arsyetimin se me vetëm një lojtar në këtë segment të punës do të arrihet çmim më i madh në treg gjatë privatizimit të saj. Nga Posta e Maqedonisë kanë deklaruar për agjencinë MIA se tregu akoma nuk është i gatshëm për liberalizim të tërësishëm. Lidhur me shërbimet e reja dhe modernizimin e punës, thonë se ndërmerren aktivitete për të zvogëluar të gjitha harxhimet përfshi edhe ato joproduktive . Qeveria e re në muajin gusht të vitit të kaluar obligoi Postën që të përgatisë program të veçantë për ekonomizimin e punës.

"Posta e Maqedonisë punon në zgjerimin e portofolios të shërbimeve, sidomos në pjesën e prodhimeve dhe shërbimeve të avancuara teknologjike, ose në segmentin e tregtisë elektronike dhe online si zëvendësim për vëllimin në ulje të shërbimeve klasike të postës" thonë në Postën e Maqedonisë për agjencinë MIA.

Gjithashtu ankohen për mosrespektimin e legjislacionit dhe hyrjen e operatorëve të tjerë të postës në shërbimet e rezervuara që janë të konceptuara në atë mënyrë që ti mundësojnë Postës burime të sigurta të financimit. Dukuri të tilla pasqyrohen negativisht në punën e tyre si dhe në sigurimin e shërbimit universal, mirëmbajtjen , zhvillimin dhe punën e rrjetit të Postës dhe infrastrukturës përcjellëse si obligim ligjor . Nga Posta thonë se për këto probleme janë drejtuar disa herë edhe në Agjencinë e Postave. Sipas Ligjit për shërbime postare, Posta e Maqedonisë është e licencuar për punë në segmentin e rezervuar postar ku ka të drejtë ekskluzive të sigurojë shërbime të rezervuara postare si letra, kartela postare dhe dërgesa të postës direkte në komunikacionin postar vendor dhe të jashtëm deri në 50 gram deri më 31 dhjetor të vitit 2018.

Nga Agjencia e Postave thonë mbështesin liberalizimin e tregut postar , ndërsa vlerësojnë se nevojitet një modernizim më i madh i punës së Postës së Maqedonisë , inovacione më të mëdha dhe jo mbështetja aq e madhe në punën financiare nga dërgesat e Fondit të shëndetësisë dhe të ngjashme. "Prolongimi i sërishëm ose anulimi eventual i afatit për të cilin vlen fusha e rezervuar , në mënyrë shtesë do të shkaktojë humbje që nuk mund të kompensohen në punën e operatorit nacional, për shkak se vëllimi i Postës që hyn në fushën e rezervuar apo dërgesat deri në 50 gram, nga viti në vit në Maqedoni shënojnë ulje prej 5 deri 10 për qind", thotë drejtori i Agjencisë së Postave , Vllatko Atanasovski për agjencinë MIA.

Sipas tij, në tërë botën , pjesa e rezervuar apo dërgesat deri në 50 gram sjellin vetëm humbje dhe nuk krijojnë profit. Ai shton më tej , se nëse liberalizohet tregu dhe nëse me sukses privatizohet Posta e Maqedonisë , jo vetëm që nuk do largojë punëtorë nga puna, por përkundrazi do të angazhojë më shumë të punësuar duke shfrytëzuar potencialin e madh në sektorin postar. Në ndërkohë të dhënat zyrtare tregojnë se me të ardhura prej 23 milionë euro, me mbi 2000 të punësuar dhe me 300 njësi pune në tërë vendin, Posta renditet ndër kompanitë më të mëdha vendore. Të dhënat për periudhën 2012-2106, tregojnë se liberalizimi i pjesërishëm i shërbimeve postare nuk ka zvogëluar edhe të ardhurat e saja. Përgjatë kësaj periudhe, kjo kompani shtetërore me aksionet e saja në Bursën e Maqedonisë ka pasur qarkullim prej afër 116 milion euro apo afër 23 milionë euro në vit, me çka renditet ndër kompanitë më të mëdha në tregun vendor të letrave me vlerë. Problem për punën e Postës mbetet fitimi i ulët ose edhe puna me humbje. Kompanitë në pronësi shtetërore në Maqedoni vetëm në vitin 2016 kanë treguar humbje prej afër 36 milionë euro. Nga ana tjetër, Posta e Maqedonisë në vitin 2016 ka treguar profit prej vetëm një milion denarë, por megjithatë ka përmirësuar punën në raport me humbjet prej 120 milionë denarë në vitin 2013 dhe 1.8 milionë denarë në vitin 2012. Në vitin 2014 shënohet profit prej 900 mijë denarë, ndërsa në vitin 2015 shënohet profit prej 5 milionë denarë.

PAGAT DHE QARKULLIMI I PAPARAQITUR E RRISIN KORRUPSIONIN

MAQEDONIA STAGNON NË LUFTËN KUNDËR EKONOMISË GRI

Shkup, 6 shkurt - Paga e 44 për qind e të punësuarve në Maqedoni tërësisht apo pjesërisht nuk paraqitet, me ç'rast 9 për qind janë pa kontratë me shkrim për punë dhe nuk u paguhen kontributet sociale për punësim. Njëherësh, gjithnjë e më shumë në Drejtorinë për të Ardhura Publike (DAP) vijnë ankesa se nuk jepen llogari fiskale, theksuan pjesëmarrësit në Forumin e djeshëm rajonal për ekonomi të fshehur, që u mbajt në organizim të Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP). Në shembujt për punë të paparaqitur janë vërejtur raste kur një punëtor në fabrikë e ka punën e dytë si hidraulik për amvisëritë e vogla, elektricisti rregullon bolierin dhe paguhet me para në dorë, ndërsa më pas nuk i paraqet të ardhurat, IT profesionisti, krahas pagës së tij minimale në të cilën është i paraqitur merr edhe pagë plotësuese në "zarf", nëna kryefamiljare me dy fëmijë, ë dobi të punëdhënësit pajtohet të punojë me marrëveshje në kohë të pacaktuar për ta mbajtur punën dhe t'i mbulojë shpenzimet e amvisërisë... Siç u theksua në forum, në luftën kundër ekonomisë gri Maqedonia shënon stagnim, si rezultat i humbjes së besimit te obliguesit në institucionet e krizës politike dhe ekonomike. Tek faktorët kyç për aktivitete të fshehura ekonomike, sipas biznesmenëve të përfshirë me hulumtimin, janë mospagesa e tatimeve, korrupsioni dhe joefikasiteti në gjyqësi. Monitorimi i QHKP tregon se në shkallën prej 1 deri në 10 indeksi i ekonomisë së fshehur në Maqedoni vitin e kaluar ka qenë 3.4 ose përafërsisht në 2014. Në krahasim me shtetet e tjera të përfshira në hulumtim Maqedonia është radhitur më mirë, pasi që në Kosovë indeksi është shtatë, ndërsa në Shqipëri katër. Qarkullimi i fshehur në Maqedoni me të cilin janë përfshirë shkalla e mosdhënies së dokumenteve dhe llogarive fiskale gjatë blerjes, ka indeks prej 3.29, ndërsa punësimi i fshehur (mosparaqitja e punës, sigurimi i fshehur social dhe sigurimi i fshehur shëndetësor) është prej 3.51. Drejtoresha e Drejtorisë për të Ardhura Publike, Sonja Lukarevska paralajmëroi inspeksione të përforcuara duke e pasur parasysh numrin e madh të telefonatave në qendrën e DAP dhe parashtresave se nuk jepen llogari fiskale. Parregullsi në punë janë përcaktuar tek 10 për qind e subjekteve të kontrolluara javën e kaluar. Kontrollet e tilla vazhdojnë, ndërsa veçanërisht vëmendje do t'i kushtohet respektimit të legjislaturës me ç'rast do të përfshihen manifestimet argëtuese, siç është Karnavali i Strumicës dhe të tjerë të cilët mundësojnë qarkullim të rritur të punës, por edhe sektori hotelierik. Ana Mickovska Raleva nga QHKP vlerëson se masat ndëshkuese duhet të balancohen me aktivitete për zbulimin më të mirë të ekonomisë së fshehur dhe stimulimin e bizneseve për t'i paraqitur punëtorët.

QYTETI I SHKUPIT SHPALL FITUESIT E PROJEKTEVE

ME KËNGË DHE VALLE, FOLKLORI KRYESON EDHE KËTË VIT

Buxheti për financimin e këtyre projekteve këtë vit është 16 milionë denarë (pesë milionë më shumë se vitin e kaluar) dhe sipas Qytetit të Shkupit, është rritur përqindja (nga 22 për qind vitin e kaluar në 28 për qind) për financimin e projekteve nga bashkësitë etnike. Por po t'i referohesh listës me projektet fituese në të gjashtë sferat e aplikimit struktura e financimit, nuk ka ndonjë dallim nga vitet e mëparshme

Koha — Evis HALILI

Shkup, 6 shkurt - Festivale dhe mbrëmje folklorike janë ngjarjet që do të shënojnë kryesisht këtë vit kulturën shqiptare në mbështetjen e Qytetit të Shkupit, nuk kanë ndonjë ndryshim të madh si nga përmbajtja, ashtu edhe nga shuma që i vihet në dispozicion. Folklori do të jetë i prezantuar në të gjitha format, përmes koncerteve me këngë dhe valle, mbrëmjeve, ekspozitave, shënimit të përvjetorëve të ansambleve folklorike, botimeve e të tjera. Këto manifestime janë përzgjedhur mes gjithsej 200 projekte në kulturë që do të sponsorizohen nga Qyteti i Shkupit në konkursin vjetor për realizimin e interesit lokal në sferën e kulturës dhe do të realizohen nga shoqata, shoqëri, artistë, institucione e të tjera. Buxheti për financimin e këtyre projekteve është këtë vit 16 milionë denarë (pesë milionë më shumë se vitin e kaluar) dhe sipas Qytetit të Shkupit është rritur përqindja (nga 22 për qind vitin e kaluar në 28 për qind) për financimin e projekteve nga bashkësitë etnike. Por po t'i referohesh listës me projektet fituese në të gjashtë sferat e aplikimit struktura e financimit nuk ka ndonjë dallim nga vitet e mëparshme. Maksimumi i shumave arrin deri në 150 mijë denarë, siç është buxheti për festivalin e fëmijëve "Ylberi", apo Mbrëmjet folklorike të Çarshisë – 120 mijë denarë nën organizmin e "Ibe Palikuqit". Ndërsa shumat e akorduara për manifestime në sfera të tjera, si festivale, promovime, shënime përvjetorësh, e të tjera varion nga 30 mijë deri në 70 mijë denarë. Me shuma të vogla po ashtu janë mbështetur edhe botimet, produksionet, apo edhe festivalet e teatrit, siç është shuma e akorduar për festivalin ndërkombëtar të teatrove "Skupi Fest" (140 mijë denarë), e të tjera. Nga projektet fituese si ngjarje të tjera më të rëndësishme në kulturë do të jetë ekspozita me pikturat e Omer Kaleshit (Universiteti Nënë Tereza- 100 mijë denarë), premierat e dy shfaqjeve në Teatrin e Fëmijëve dhe të Rinjve të Çairit (170 mijë denarë për dy shfaqje), shënimi i 70 vjetorit të ansamblit "Emin Duraku", koncertet solistike, e të tjera. Ansamblet dhe shoqëritë kulturore, si Emin Duraku, Ibe Palikuqi, Karshiaka, Shkupi, Drita e Dërvenit, e të tjera përbëjnë pjesën më të madhe të aktiviteteve që do të realizohen në Shkup dhe jashtë vendit.

Konkursi për financimin e manifestimeve, projekteve dhe krijimtarisë artistike u shpall në muajin nëntor. Gjithsej janë paraqitur 430 aplikime, gjysma prej të cilave janë refuzuar. Numri më i madh i projekteve (22 për qind) është në Muzikë dhe Artet e aplikuara, Artet vizuale dhe artet e mediumeve të reja (20 për qind), ndërsa më pak në Promovimin e trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Sa i takon shumave më të mëdha që akordohen nga Qyteti i Shkupit janë ato për Drejtorinë e Kulturës dhe Artit, përkatësisht për manifestimin "Vera e Shkupit", për të cilin këtë vit janë akorduar mbi 1,3 milionë denarë. "Vera e Shkupit" është një prej manifestimeve kryesore në të cilin është kthyer në traditë pjesëmarrja e vogël e artistëve shqiptarë.

Publicitet

Në bazë të nenit 24 në lidhje me nenin 37 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim të mjeteve në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15, 153/15 dhe 190/16), ndërsa në pajtim me Raportin për vlerësim të realizuar të Byrosë për ekspertiza gjyqësore SV V 4/18, të datës 16.01.2018, Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, publikon

SHPALLJE nr. 02/2018
Të shpalljes për dhënie me qira të pronës së patundshme në Shkup - 4 (katër) sipërfaqe në kulm përmes ankandit publik elektronik

I. LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK
Lëndë e ankandit **është dhënie me qira të mjeteve të patundshme, pronësi e Republikës së Maqedonisë, me qëllim të vendosjes së bazave stacionare për telefoni mobile,** për periudhë prej dy viteve.
II. TË DHËNAT PËR OBJEKTET E PATUNDSHME TË CILAT JEPEN ME QIRA
1) **Mjeti i patundshëm numër 1,** në rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në kulm, me sipërfaqe prej 35 m2;
2) **Mjeti i patundshëm numër 2,** në rr. "Kej Dimitar Vllahov" nr. 4, Shkup, ndërtesa 2, hyrja 1, PK nr. 9521, KK Qendër 1, LP nr. 9099, në kulm, me sipërfaqe prej 10,25 m2;
3) **Mjeti i patundshëm numër 3,** në rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në kulm, me sipërfaqe prej 40 m2;
4) **Mjeti i patundshëm numër 4,** në rr. "Kej Dimitar Vllahov" nr. 4, Shkup, ndërtesa 2, hyrja 1, PK nr. 9521, KK Qendër 1, LP nr. 9099, në kulm, me sipërfaqe prej 12 m2;
III. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE
Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjitha subjektet juridike të vendit dhe të huaj të cilët përmbushin kushtet në vijim:
1) Të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë që ka të bëjë me lëndën ankandit publik elektronik,
2) Në pesë vitet e fundit të mos u jetë shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
3) Të mos u jetë shqiptuar dënim dytësor ndalesë për pjesëmarrje në procedura të thirrjes publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizime publike dhe marrëveshje për partneritet publik-privat,
4) Të mos u jetë shqiptuar dënim dytësor ndalim i përkohshëm ose përhershëm për kryerje të veprimtarisë së veçantë,
5) Të mos jetë në procedurë të falimentimit dhe në procedurë për likuidim,
6) Të mos ketë të papaguara tatime, kontribute ose pagesa të tjera publike,
7) Të mos u jetë shqiptuar sanksion kundërvajtjeje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ose ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë.
IV. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK:
Subjektet e interesuara juridike parashtrojnë **Fletëparaqitje elektronike për pjesëmarrje në ankandin publik,** në pajtim me kushtet e Shpalljes, në internet faqen në vijim: **http//e-aukcii.finance.gov.mk**
Ofertuesit e interesuar, krahas fletëparaqitjes elektronike, parashtrojnë dhe fletëparaqitje në formë të shkruar në zarf të mbyllur me shënim "mos hap" dhe me shenjë "për shpallje për dhënie me qira të pronave të patundshme numër 02/2018",të adresuar deri tek Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në bul. "Kuzman Josifovski Pitu" nr. 17, Shkup.
Fletëparaqitja duhet të jetë e plotësuar dhe nënshkruar me dorë nga personi përgjegjës ose i autorizuar nga ai (e bashkëngjitur të parashtrohet edhe autorizimi), me të dhënat e përgjithshme të ofertuesit, personi për kontakt me numër telefoni **edhe e-mail adresë në të cilin do të parashtrohet emri përdorues dhe shifra për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik.**
Së bashku me fletëparaqitjen parashtrohen shtojcat në vijim jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes:
1) Vërtetim për veprimtari të regjistruar nga Regjistri qendror,
2) Deklaratë me të cilën vërtetohet përmbushja e kushtit nga pika 2 – kreu III,
3) Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të subjekteve juridike për përmbushje të kushteve nga pika 3 dhe pika 4 – kreu III,
4) Vërtetim për falimentim dhe likuidim nga Regjistri qendror,
5) Vërtetim për tatime, kontribute dhe pagesa tjera publike të paguara, nga Drejtoria për të hyrat publike,
6) Vërtetim për përmbushje të kushteve nga pika 7 – kreu III, nga Regjistri qendror,
7) Gjendja aktuale e ofertuesit nga Regjistri qendror,
8) Oferta e cila do të përmbajë të dhëna të sakta për mjetin e patundshëm për të cilin ofertuesi do të merr pjesë në ankand,
9) Garanci bankare për seriozitet të ofertës në shumë prej 2% të shumës së përgjithshme të vlerësuar për pronën e patundshme për të cilën merr pjesë në ankand me kohëzgjatje të së njëjtës prej 30 ditë nga dita e publikuar si afat i fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve (21.02.2018);
Shpallja zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, duke filluar nga 07.02.2018 (e mërkurë), deri më 21.02.2018 (e mërkurë).
Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike, më 23.02.2018 (e premte),
në internet adresën në vijim: http//e-aukcii.finance.gov.mk

V. ÇMIMI FILLESTAR I QIRASË, SHUMA E GARANCISË BANKARE DHE TERMINI I ANKANDIT PUBLIK
Çmimi fillestar i qirasë mujore pa TVSH të përfshirë është:
1) **Mjeti i patundshëm numër 1**
- Shuma e **qirasë mujore është 38.745,00 denarë**;
- Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 7.749.000,00 denarë;
- Garancia bankare prej 2% është **154.980,00 denarë;**
- **Ankandi publik do të fillojë në ora 09:00**
2) **Mjeti i patundshëm numër 2**
- Shuma e **qirasë mujore është 11.347,00 denarë;**
- Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 2.269.350,00 denarë;
- Garancia bankare prej 2% është **45.387,00 denarë;**
- **Ankandi publik do të fillojë në ora 10:00;**
3) **Mjeti i patundshëm numër 3**
- Shuma e **qirasë mujore është 44.280,00 denarë;**
- Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 8.856.000,00 denarë;
- Garancia bankare prej 2% është **177.120,00 denarë;**
- **Ankandi publik do të fillojë në ora 11:00;**
4) **Mjeti i patundshëm numër 4**
- Shuma e **qirasë mujore është 13.284,00 denarë;**
- Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 2.656.800,00 denarë;
- Garancia bankare prej 2% është **53.136,00 denarë;**
- **Ankandi publik do të fillojë në ora 12:00;**
-
VI. AFATI PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE
Fletëparaqitjet elektronike për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrohen deri më 21.02.2018 deri në mesnatë.
Fletëparaqitjet e shtypura me tërë dokumentacionin e bashkëngjitur parashtrohen në Arkivin e Shërbimit, në adresën: **Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, bul. "Kuzman Josofovski Pitu" nr. 17, Shkup**, deri më 21.02.2018 më së voni deri në ora 16.30.

VII. PROCEDURA
Komision i kryen evaluimin e fletëparaqitjeve të arritura, më së voni deri më 22.02.2018;
Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me të gjitha dëshmitë të theksuara në fletëparaqitje, do të refuzohen dhe nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka do të informohen në mënyrë elektronike.
Ofertuesve me fletëparaqitje të kompletuara me dëshmitë e nevojshme për përmbushje të kushteve të kërkuara, u dërgohet emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, në e-mail adresë të cilën janë të obliguar ta shënojnë në fletëparaqitje.
Pjesëmarrësit kanë të drejtë për Ankesë vetëm përmes procedurës për ankand publik deri tek Komisioni pranë Shërbimit në afat prej tri ditëve nga mbajtja e ankandit publik.
Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin më të lartë të qirasë dhe me atë lidhet Marrëveshje për qira.
Shpenzimet për solemnizim të marrëveshjes bien mbi qiramarrësin.

Një jetë në rrugën e Zotit

Nga
Ferdinand SAMARXHI

Në rrugëtimin e jetës, të punës, të një gazetari për gati afro gjysëm shekulli përjetohen dhe përcillen shumë ngjarje, episode, ndodhi që fiksohen në celuloid. Shumë prej tyre, të prekshme, motivuese, treguese për historinë dhe kohët e tyre.

Ishin ditët e para të agut të demokracisë dhe në një ditë të bukur të historisë së tyre do të takoja bariun e urtë të grigjes Don Ernest Troshanin, bariun e dhemshur që edhe pse kishte vuajtur vite të tëra në burgjet e territ, vuante shumë, se e donte shumë grigjën e tij. Ende kur liria nuk kishte ardh, kur të gjithë ëndërronim dhe luteshim për zotin, fshehurazi, në rrugëtimin tim të punës dhe të jetës së një gazetari, do të njihja një njeri, një djalë të ri, që në mendimin dhe vizionin e tij pranonte më mirë t'i vendoseshin hekurat ndër duar sesa të mos gëzonte lirinë dhe të lutej për zotin. Ky ishte Edmond Brahimaj, djali që vinte nga një familje me rrënjë dhe tradita të forta bektashiane, i cili vazhdoi të shkruaj historinë, jo si një bari i thjeshtë por si një Kryegjysh Boteror, si një lider i madh Shpirtëro...

***

...Në fillimet e para të rrugëtimit tim edhe pse nuk isha njohur ende me të, prej kushteve politike të mbyslljes së Shqipërisë, kisha dëgjuar shumë për një njeri të madh që emni dhe zani i tij fliste dhe përcillte shumë për kombin, për Zotin, për Shqipërinë tonë. Njeriu i madh për të cilin unë kisha dëgjuar do të më emocononte që në takimin e parë. Ky ishte Reisul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi për të cilin unë dua të tregoj në pak rrjeshta jetën, punën, përkushtimin, dashurinë që ushqen ai, për kombin, për atdheun, për Shqipërinë, për besimin, rrugën e tij, dinjitetin dhe frymën kombëtare të islamit.

Që në fillim dua të them se arritjet dhe sukseset e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë janë të lidhura ngushtës me jetën, punën, përkushtim, devocionin e Reisul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit. Jo rastësisht, historia jonë kombëtare ka rezervuar vend të ndritshëm për shumë personalitete nga komuniteti i klerikëve myslimanë, të cilët kanë lënë gjurmë të përhershme në sferën e angazhimeve gjithëkombëtare. Janë teologët shqiptarë myslimanë ata, të cilët u angazhuan në mënyra të ndryshme për ruajtjen e gjuhës shqipe nëpër shekuj, edhe kur vihej në pikëpyetje ekzistenca e kombit tonë, për ruajtjen e traditës që kanë karakterizuar shqiptarinë autoktonë në Maqedoni.

Bashkësia Islame e Maqedonisë, që në pavarësimin e saj, do të udhëhiqet për herë të parë nga një hoxhë atdhetar shqiptar, i njohur edhe më herët si "shqiptar i papërshtatshëm" për politikat maqedonase. Ky Institucion do të jetë ndër promotorët kryesorë të formimit të partisë së parë shqiptare në Maqedoni (Partisë për Prosperitet Demokratik) si dhe do të jetë iniciues i shumë lëvizjeve të reja kombëtare në Maqedoni. Në fillimet e pluralizmit në Maqedoni, qarqe të ndryshme shovene po planifikonin ndryshim të historisë dhe përvetësim të ngjarjeve të rëndësishme, me çka, shumica absolute e myslimanëve të vendit, pra shqiptarët, tentohej të paraqiteshin si të ardhur, apo si uzurpatorë të Maqedonisë. Me iniciativën këmbëngulëse të Kryetarit të BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepit, përkundër shumë kërcënimeve të pushtetit të atëhershëm maqedonas, Bashkësia Islame e Maqedonisë do të jetë organizatore e Simpoziumit Gjithëkombëtar, në të cilin do të tubohen qindra shkencëtarë shqiptarë nga e gjithë bota dhe ku do të debatojnë mbi lashtësinë dhe autoktoninë e shqiptarëve të Maqedonisë. Natyrisht që ky simpozium do të bëhet mburojë e pathyeshme karshi përpjekjeve dhe strategjive të pseudo-akademikëve maqedonas për ta minimizuar rolin dhe peshën e shqiptarëve myslimanë në këto troje. Një nga politikat kryesore të BFI-së ka qenë avancimi i zhvillimit arsimor të shqiptarëve myslimanë nga niveli i mektebeve në shkollim të mesëm dhe të lartë. Kësisoj, në periudhën prej një dekadë e gjysëm, BFI-ja do të bëhet edhe me Medresenë e vet "Isa Beu" por edhe me Fakultetin e Shkencave Islame. Në këtë projekt strategjik, nuk ishte në plan të parë vetëm kultivimi i kuadrit arsimor e shkencor islam, por, mbi të gjitha, që kuadri shqiptar të dalë nga institucionet shkollore autoktone, ku teologët do të kaliteshin në mesin e një tradite, të një kulture, të një filozofie të të jetuarit dhe të logjikuarit ashtu siç ishin zhvilluar me shekuj në trevat tona autoktone.

Ishte angazhimi permanent i Kryetarit të Bashkësisë Islame, H. Sulejman ef. Rexhepit, për sigurimin e sa më shumë kuotave dhe bursave për të rinjtë tanë nëpër fakultete të ndryshme në qendrat universitare gjithandej Lindjes së Mesme dhe më gjerë. Në historinë e Universitetit të parë në gjuhën shqipe në Maqedoni, Universitetit të Tetovës, emri i Bashkësisë Islame si dhe i Kryetarit H. Sulejman ef. Rexhepi, do të mbeten të gdhendura në historinë e artë të kombit tonë, pasi kontributi i BFI-së dhe i efendi Rexhepit në hedhjen e hapave të para të Universitetit të Tetovës është i pamohueshëm. Emri i efendi Rexhepit është në mesin e nismëtarëve të parë të këtij projekti kombëtar. Ligjëratat e para dhe rektorati i parë i këtij Universiteti do të zhvillohen pikërisht në pronat e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, madje në çastet vendimtare kur kundër këtij Universiteti ishte ngritur tërë aparati i dhunës shtetërore maqedonase. "Po të mos ishte Sulejman Rexhepi nuk do të ishte Universiteti i Tetovës, deklaron dhe thekson Prof. Fadil Sulejmani, dekani i parë i UT, në tubimin e mbajtur në Bogovinjë të Tetovës".

Përkrahja e politikave gjithëkombëtare si dhe angazhimi i BFI-së në promovimin e këtyre politikave, këtë Institucion e bëri tejet të rëndësishëm si dhe faktor të patejkalueshëm si brenda ashtu edhe jashtë

> Presidenti shqiptar, z. Ilir Meta, më 25 janar, 2018, Dekoron kreun e BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi me titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut"

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërdithshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 6 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | **MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

vendit. Bashkësia Islame e Maqedonisë, Kryetari i këtij Institucioni, efendi Rexhepi, përveç që do të flasë për pozitën dhe politikat diskriminuese shtetërore kundër myslimanëve (pra, të shqiptarëve) të Maqedonisë, do t'i sensibilizonte opinionin dhe për pasojat e një lufte gjithëballkanike nëse nuk do të realizohej sa më parë pavarësia e Kosovës si dhe një luftë eventuale serbo-shqiptare në Kosovë ku mund të përfshinte edhe Maqedoninë. Atëkohë, zëri artikulues i politikave kombëtare shqiptare në hapësirat e ish-Jugosllavisë ishte LDK-ja e Ibrahim Rugovës. Dhe, efendi Sulejman Rexhepi, jo njëherë ka arritur që të organizojë takime të krerëve të kësaj Partie me burra shteti dhe diplomatë të huaj pikërisht në selinë e Kryetarit të BFI-së. Duke qenë në rrjedha dhe i informuar nga qarqet kombëtare e ndërkombëtare për çastet e vështira që mund të imponohen si pasojë e politikave shoveniste e raciste të Serbisë millosheviçjane, Bashkësia Islame e Maqedonisë me kohë kish marrë të gjitha masat që në rast nevoje të jetë në krye të detyrës konform organizimit të saj. Prandaj, në një afat rekord i sistemoi mbi 20 mijë boshnjakë të ikur nga agresioni serb në Bosnjë-Hercegovinë. Të gjithë këta myslimanë i sistemoi nëpër shtëpitë shqiptare në Maqedoni, duke i mbajtur pa kurrfarë problemi me muaj të tërë. Natyrisht, duke pasur teologët e vet të përfshirë edhe në strukturat e celulave të para të armatosura të shqiptarëve të Kosovës, e priste ditën kur Kosova do të gjendej nën një presion të tmerrshëm të pastrimit etnik. H. Sulejman Rexhepi bashkë me teologët e vendit, tashmë e kishin sensibilizuar tërë opinionin shqiptar të Maqedonisë që, të gjitha shtëpitë, dhe, nëse e do nevoja edhe të gjitha xhamitë e vendit, të hapnin dyert si dhe të përgatiteshin për një valë të madhe të refugjatëve nga Kosova. Kështu dhe ndodhi, BFI-ja arriti që të strehojë dhe të përkujdeset për qindra mijëra shqiptarë që u dëbuan nga Kosova, ndërsa, pa dyshim që, selia e saj u bë edhe stacion pritje e ushtarëve të plagosur të UÇK-së që i përcillte për në qendrat spitalore turke për rehabilitim të mëtejmë.

***

Synim gjithëkombëtar pa dyshim ishte avancimi i statusit politik të shqiptarëve të Maqedonisë. Jo njëherë faktori politik shqiptar por edhe BFI-ja kishte tërhequr vërejtjen se nëse nuk do të ketë reflektim nga ana e qeveritarëve maqedonas, një avancim i tillë mund të shoqërohej përmes ndonjë konflikti të armatosur. Ndodhi edhe konflikti i vitit 2001 në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve në Maqedoni dhe, krejt kjo përfundoi me arritjen e një marrëveshje që tashmë njihet si "Marrëveshja e Ohrit", e cila ndikoi drejtpëdrejt në ndryshime Kushtetuese të vendit. Me këtë rast, u sendërtua edhe kërkesa e kahershme e BFI-së që ky Institucion të ngrihet në kategori kushtetuese dhe Maqedonia mos të njohë vetëm Kishën Ortodokse Maqedonase si Institucion fetar por edhe Bashkësinë Islame, si qytetarë të barabartë të jenë edhe pjesëtarët e besimit islam në vend. Këto janë vetëm disa nga një mori faktesh të cilët do të nxisin tek qarqet e caktuara maqedonase që të kenë një qëndrim antishqiptar dhe anti-BFI, duke e konkretizuar me lloj-lloj projektesh e lojërash të fshehta, me të vetmin qëllim që ta shkatërrojnë çështjen kombëtare shqiptare duke përdorur "mina fetare" në terrenin e BFI-së! Fatmirësisht, kujdesi i skajshëm si dhe largpamësia e kryetarit të BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepit, bënë që në mënyrë shumë të urtë të tejkalohen të gjitha ato pengesa e peripeci kurse BFI-ja dhe shqiptarët e Maqedonisë, si shumicë e pjesëtarëve të besimit islam në vend, të gëzonin autoritet dhe respekt në shumë kongrese, simpoziume, organizata e qarqe të ndryshme në shtet.

H. Sulejman efendi Rexhepi, si Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni, u bë dhe u vlerësua si një lidership i gjallë, një model lideri që inspiron udhëheqje të përkryer drejt zgjidhjes së shumë problemeve, qofshin ato fetare apo kombëtare. Pa dyshim që, në Maqedoninë plurale për momentin është lideri më jetëgjatë që ka qëndruar stoik dhe në detyrë, lideri që ka arritur më shumë suksese, lideri që ka zënë vend në faqet e historisë kombëtare. Sulejman Rexhepi zyrtarizoji gjuhën shqipe në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në RM si dhe krahas flamurit mysliman ngre dhe flamurin shqiptar të valëvitet në të gjitha institucionet e BFI-së; Sulejman Rexhepi do të njihet për rolin dhe kontributin e tij të veçantë në menaxhimin e krizës humanitare të shkaktuar nga refugjatët e Bosnjës; Sulejman Rexhepi do të njihet si nismëtar i parë për themelimin e Universitetit të Tetovës, për themelimin e këshillit koordinativ mes Bashkësive Islame Shqipëri-Kosovë-Maqedoni;

Por BFI-ja nën drejtimin e tij, OH El Hilal do të bëhet një zëdhënse dhe organizata më e zëshme deri në Kombet e Bashkuara. Puna e Sulejman Rexhepit nuk spikat vetëm në drejtimin e BFI-së me dinjitet dhe integritet kombëtar por ai do të jetë një promotor i gjallë për propagandimin e drejtë të luftës së UÇK-së në botën arabe përmes BBC-së së Londrës. Duke qenë se terrorizmi nuk ka asgjë të përbashkët me Islamin si një besim i paqes dhe i dashurisë, Sulejman Efendi Rexhepi do të jetë një mbrojtës i paepur i BFI nga radikalizimi, ekstremizmi dhe terrorizmi. Ai do t Mbrojtës i paepur i BFI nga radikalizimi, ekstremizmi dhe terrorizmi themelojë dhe do të jetë ideator i Projektit "Stop RadTerr", projekt innovator në parandalimin e terrorizmit dhe radikalizimit në Maqedoni;

Duke u udhëhequr nga vizioni se "Pa Atdhe nuk ka Fe" ai jo vetëm që do të jetë nji nga organizatorët e simpoziumit me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar "Kontributi i ulemave në ngritjen e vetëdijes kombëtare", por do të jetë gjatë gjithë kohës një Ithtar i zhvillimit dhe kultivimit të nji Islami tradicional dhe autokton, të atij Islami të trashëguar nga të parët tanë dhe do të jetë nismëtar për themelimin e Medresesë së vajzave Tetovë, Medresesë së djemve Shkup, Medresesë së vajzave Shkup, Gostivar, Ideator për themelimin e Shoqatës Standard Hallall, Konferencës mbarëkombëtare "Medhhebi Hanefi, prioritetet dhe sfidat", Mexhlisit për fetva në Maqedoni. Revistës "Hana e Re" që botohet në tri gjuhë, Themelues i OH El Hilal (sot HILAL) - organizatë humanitare me synimin e mbështetjes të shtresave të varfra të shoqërisë, insistues i flaktë për shkollimin e femrës myslimane deri në shkollat e larta arsimore, Pjesëmarrës në hedhjen e gurit themeltar dhe inagurues i mbi 100 xhamive të reja anekënd territorit, etj.

***

H. Sulejman ef. Rexhepi, si personalitet i veçuar dhe i respektuar, zgjidhet anëtar i rregullt i një numri të madh organizatash botërore, evropiane dhe ballkanike me karakter islam. Do të zgjidhet anëtar i rregullt i Kuvendit të lartë për çështje islame me seli në Kajro, anëtar i rregullt i Kongresit botëror Islam me seli në Tripoli, anëtar i rregullt i Unionit Islamik për Evropë, zëvendës i sekretarit gjeneral të Kuvendit të Këshillit për Evropën Lindore me seli në Stamboll, anëtar i Forumit të Shkencëtarëve Islam me seli në Rabat, pjesëmarrës i Ligjëratave të Ramazanit që organizoheshin në Pallatin Mbretërorë të Hasanit të Dytë dhe themelues dhe zëvendës kryetarë i Shpurës Euro Aziatike me seli në Ankara etj. Me dinjitet do ta prezantojë BFI-në si dhe mbarë popullatën myslimane në shumë konferenca botërore ku do të paraqitet edhe me kumtesa, si në: Takimet e rregullta të Shpurës Euroaziatike, në Konferencën e Këshillit të Lartë për Çështje Islame, në Kajro; në Konferencën botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, në Ohër; në Kongresin ndërkombëtar i civilizimit islam në Ballkan, në Shkup; në Kongresin mbarë islamik për ripërtërtjen e mendimit islam, në Kajro; në Konferenca Botërore Islame për dialog, në Mekke; në Kongresin e organizuar nga Universiteti "Ali Bejt", në Jordan; në Konferencën e parë ndërkombëtare për Ballkanin, në Stamboll; në Konferencën VI të Kuvendit të përgjithshëm për çështje islame, në Aleksandri të Egjiptit; në Kongresin e intelektualëve të botës islame, me rastin e haxhit 1992, në Medinë, etj. H. Sulejman ef. Rexhepi, po ashtu është nderuar me mirënjohje e dekorata të ndryshme, si Çmimi "Imazhi shqiptar i harmonisë fetare" nga Forumi Imazh dhe Media, në Akademinë e Shkencave dhe Arteve në Tiranë, Çmimin "Best Spiritual Leader" nga Instituti Evropian për Menaxhim, drejtësi dhe diplomaci, "Çmimin për arritjet jetësore" dakorduar nga Presidenti Amerikan, z. Donald Tramp, dhe së fundmi nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, shkëlqesia e tij Z.Ilir Meta me dekoratën e lartë "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" .

(Shkëputur nga një shkrim më i gjatë, botuar në GAZETA SHQIPTARE, 2 shkurt, 2018, Tiranë)

Greqi-Maqedoni: Grindje me pasoja

Mosmarrëveshja për emrin midis Greqisë dhe Maqedonisë mund të ketë ndikim në stabilitetin e gjithë Evropës Juglindore

Nga Reinhard VESER

Mosmarrëveshja për emrin midis Greqisë dhe Maqedonisë është më shumë se një shfaqje teatrale mes dy shteteve. Ajo mund të ketë ndikim në stabilitetin e gjithë Evropës Juglindore.

Për shkak se Athina nuk dëshiron të lejojë që Maqedonia të ketë të njëjtin emër si një krahinë e Greqisë, ajo ka bllokuar prej vitesh çdo afrim të fqinjit të saj verior me BE-në dhe NATO-n. Kjo gjë ka çuar për vite të tëra në orientime autoritaro-nacionaliste në Maqedoni, të cilat pothuajse do ta kishin shpërbërë këtë vend. Pasojat për shtetet përreth do të ishin të paparashikueshme. Mundësia e re për të arritur një zgjidhje për mosmarrëveshjet për emrin u bë e mundur prej një kthese demokratike në Maqedoni. Kjo do të jetë në rrezik nëse Athina, do t'i rikthehej për shkak të demonstratave masive nacionaliste, sërish qëndrimit kokëfortë. Jashtë Greqisë një gjë e tillë do të gëzojë dikë: Kremlinin, i cili dëshiron ta pengojë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.

Moska po tregohet në këtë çështje po aq cinike dhe fleksibël sa gjithmonë. Deri tani ajo tregohej zemërmadhe kundrejt nacionalistëve maqedonas, tani ministri i Jashtëm Lavrov u rekomandon grekëve që të mos bëjnë asnjë kompromis. *(DW)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/156/2016 dhe 106/2016) dhe Vendimit nr. 0201-932/2 të datës 01.11.2017 për dhënie me qira të mjeteve të patundshme një pjesë të hapësirës në objektet e IN Teatri i dramës Shkup, Institucioni nacional Teatri i dramës Shkup publikon:

SHPALLJE numër 01/2018
Për dhënie me qira të pronës së patundshme – pjesë të hapësirës përmes ankandit publik elektronik

1. LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1.1. Lëndë e ankandit publik elektronik është prona e patundshme – pjesë e hapësirës në objektet e Institucionit nacional Teatri i dramës Shkup

1.2. Të dhënat për hapësirën i cili jepet me qira janë dhënë në Pasqyrën tabelore në vijim:

Nr. rendor	Qyteti	Adresa e pronës së patundshme – pjesë e hapësirës	Numri i ndërtesës Hyrja dhe kati	Shenja për ankand	Sipërfaqja m²	Parcela katastrale dhe Komuna katastrale dhe lista pronësore	Shuma e përgjithshme e vlerësuar e hapësirës afariste (në denarë)	Çmimi fillestar për qiranë mujore në denarë (pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga shuma e përgjithshme e vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve	Data dhe koha e fillimit të ankandit publik
1.	Shkup	Institucioni nacional Teatri i dramës Shkup rr. "Shekspirova" nr. 15, Shkup	Ndërtesa 1 Hyrja 001 Kati përdhese	1	384	LP 4997 PK 1925 KK Karposh	12.515.595	62.577.98	250.311.90	16.02. 2018 në ora 12.00	20.02.2018 në ora 10:00

Hapësira për qira e theksuar në pasqyrën tabelore me numër rendor 1 jepet me qira për periudhë prej 5 (pesë) vjet, nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për qira me ofertuesin më të volitshëm. Hapësirat mund të shihen çdo ditë pune në periudhë prej ora 10.00 deri në ora 12.00 me paralajmërim paraprak dhe prezencë të përfaqësuesit të Komisionit për realizim të procedurës për ankand publik. **Hapësirat për qira jepen në gjendje pasi të shihen.**

1. Shuma e qirasë në marrëveshje është shprehur pa TVSH. Tatimi i pronës së shtuar shprehet në faturë të veçantë.

2. Qiramarrësi obligohet që qiranë ta paguajë paraprakisht, më së voni deri në ditën e 5-të të muajit, pavarësisht nga pranimi i faturës. Për pagesë të vonuar të qirasë do të llogaritet kamatë ligjore ndëshkuese.

3. Mospagesa e 2 (dy) kësteve mujore një pas një, gjatë kohëzgjatjes së qirasë, paraqet bazë për aktivizimin e mjeteve për siguri dhe bazë për ndërprerje të marrëveshjes nga ana e IN Teatri i dramës Shkup.

4. Çmimi i cili do të arrihet përmes ankandit publik, do të përcaktohet si çmim i qirasë mujore dhe i njëjti duhet të paguhet paraprakisht. Për periudhën e mbetur të pagesës së qirasë do të përcaktohet në marrëveshje.

2. AFATI DHE MËNYRA E PARASHTRIMIT TË FLETËPARAQITJEVE

2.1. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në ankandin publik parashtrohet në formë të shtypur për secilën pjesë të hapësirës veç e veç në pajtim me kushtet e Shpalljes, në zarf të mbyllur me shenjë "Mos hap" dhe me shënim "Për shpallje për dhënie me qira të pronës së patundshme – hapësira afariste numër 01/2018" adresuar deri tek Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të një pjese të hapësirës në IN Teatri i dramës Shkup, me adresë rr. "Shekspirova" nr. 15 dhe duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë që janë përcaktuar në shpallje për ankand publik dhe ngarkohen në mënyrë elektronike në sistemin për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk.

Subjektet e interesuara fizike dhe juridike paraqiten në sistemin për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk.

2.2. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrohet më së voni në afat prej **10 ditëve nga dita e publikimit, gjegjësisht duke filluar prej më 07.02.2018 deri më 16.02.2018 deri në ora 12.**

2.3. Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara, me bashkëngjitje të dëshmive që kërkohen në shpallje, nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen.

3. KOHA E FILLIMIT TË ANKANDIT PUBLIK

3.1. Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet adresën në vijim: www.deloven-prostor.mk. Termini i fillimit të ankandit publik është theksuar në pasqyrën tabelore.

4. KUSHTET PËR DHËNIE ME QIRA

4.1. Hapësirat e dhëna në Pasqyrën tabelore, të theksuara në pikën 1.2. jepen nën kushtet në vijim:

- Hapësirat nga pasqyra tabelore jepet me qira në mënyrë pasi të shihet;
- Hapësirat janë për qëllim të kryerjes së veprimtarisë hotelerike (shërbim të ushqimit dhe pijeve);
- Pas përfundimit të Marrëveshjes për qira hapësira duhet të kthehet në pronësi të institucionit nacional në gjendje të rregullt;
- Nevoja për intervenime potenciale dhe investime në hapësirën që jepet me qira, bien në barrë të qiramarrësit pa ndonjë obligim që qiradhënësi të kompensojë ato shpenzime dhe të njëjtat nuk do të përfshihen në shumën e qirasë mujore as nuk do të jenë lëndë e kompensimit për qira dhe ndaj të njëjtat mund të bëhen vetëm pasi të marrin miratim paraprak me shkrim nga ana e institucionit nacional;
- Shpenzimet për energji elektrike, ngrohje, ujë, kushtet komunale (mbeturinat dhe komunale të tjera) për hapësirën e dhënë me qira, në tërësi i bartë qiramarrësi dhe të njëjtat do të paguhen nga matës i veçantë që qiramarrësi duhet ta vendosë me shpenzimet e veta;
- Qiramarrësi obligohet qiranë ta paguajë paraprakisht, ndërsa më së voni deri në ditën e pestë të muajit;
- Qiramarrësi obligohet të respektojë rendin e mbajtur në objektin e institucionit nacional gjegjësisht të mos pengojë në realizimin e veprimtarisë së institucionit;
- Qiramarrësi nuk mund ta japë hapësirën me qira;

5. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

5.1. Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë subjektet e interesuara fizike dhe juridike të vendit dhe të huaj të cilët i përmbushin kushtet e dhëna në shpallje.

6. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

6.1. Pjesëmarrësit në shpallje për ankandin publik janë të obliguar të parashtrojnë:

-**Fletëparaqitje** të plotësuar **për pjesëmarrje**, (në formë me shkrim) të kompletuar me bashkëngjitjet në vijim:

-**Deklaratë** se parashtruesi i fletëparaqitjes pranon kushtet nga shpallja për ankand publik;

-**Garanci bankare** për seriozitet të ofertës në shumë prej 2% të shumës së vlerësuar të pronës së patundshme në afat valid prej 60 ditë nga dita e ankandit publik vetëm në origjinal (të shënohet numri rendor i pasqyrës tabelore dhe adresa ku gjendet objekti afarist);

-**Autorizim të vërtetuar në noter** për të autorizuarin që përfaqëson subjektin juridik ose fizik ose dëshmi për cilësinë e personit zyrtar ose përgjegjës;

-**e-mail adresë** të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes të cilit do t'i dërgohen emër përdorues dhe shifër për qasje në internet faqen në të cilën do të realizohet ankandi publik elektronik (për parashtruesit e fletëparaqitjeve që do të dërgojnë e-mail adresë të gabuar, IN Teatri i dramës Shkup nunk ka obligim të pranojë dhe të realizojë korrigjim të të njëjtës);

6.2. **Fletëparaqitje për pjesëmarrje** në ankandin publik plotësohet dhe nënshkruhet personalisht nga parashtruesi i fletëparaqitjes.

6.3. **Deklarata** nënshkruhet personalisht nga parashtruesi i fletëparaqitjes. Përmes deklaratës parashtruesi deklaron se pranon kushtet e shpalljes për ankand publik, dhe se nëse zgjidhet si ofertues më i volitshëm, çmimin e ofruar do ta paguajë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhjen.

Përmes deklaratës parashtruesi njashtu deklaron edhe se nëse zgjidhet si ofertues më i volitshëm, në afat prej 5 ditëve të punës pas pagesës së realizuar të mjeteve në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit, do të lidhë Marrëveshje për qira.

6.4. Krahas fletëparaqitjes së plotësuar, deklaratës dhe garancisë bankare operatorët ekonomik të cilët do të marrin pjesë në procedurë duhet të përmbushin edhe kushtet për gjendjen personale. Organi i kontraktuar do të përjashtojë nga procesi për ndarje të marrëveshjes për qira të pronës së patundshme secilin operator ekonomik:

- Të cilit në 5 vitet e fundit i është shqiptuar aktvendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash;
- Të cilit i është shqiptuar dënim dytësor ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për thirrje publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizim publik dhe marrëveshjeve për partneritet publik-privat;
- Të cilit i është shqiptuar dënim dytësor ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarisë së veçantë;
- I cili është në procedurë falimentimi ose procedurë likuidimi;
- I cili ka tatime, kontribute dhe pagesa tjera publike të papaguara, përveç nëse operatorit ekonomik i është lejuar pagesë e vonuar të tatimeve, kontributeve ose pagesave tjera publike në pajtim me dispozitat e posaçme dhe të njëjtat i paguan me rregull;
- Të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë e përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë dhe
- I cili jep të dhëna të pavërteta ose nuk parashtron të dhëna që i kërkon organi i kontraktuar.

6.4.1 Për të dëshmuar gjendjen e vet personale, operatori ekonomik parashtron dokumentet në vijim:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në 5 vitet e fundit nuk i është shqiptuar aktvendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash;
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent;
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent;
- Vërtetim për tatime, kontribute dhe pagesa tjera publike të paguara nga organi kompetent nga vendi ku operatori ekonomik është i regjistruar;
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim dytësor ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për thirrje publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizim publik dhe marrëveshjeve për partneritet publik-privat;
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim dytësor ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarisë së veçantë;
- Vërtetim se me aktvendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë e përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë.

6.4.2 Deklaratën nga alineja 1 e nënpikës 6.4.1 e përpilon dhe nënshkruar vet operatori ekonomik dhe të njëjtën dukat ta vërtetojë nga organi kompetent.

6.4.3 Vërtetimet se nuk është hapur procedurë për falimentim dhe procedurë për likuidim, si dhe vërtetimet nga regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale nga alineja 5 dhe 6 të nënpikës 6.4.1, i japin organet kompetente në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik. Në Republikën e Maqedonisë organi kompetent për dhënien e këtyre vërtetimeve është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë.

6.4.4 Vërtetimin për tatime, kontribute dhe pagesa të tjera publike të paguara e jep organi kompetent në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik. Në Republikën e Maqedonisë organi kompetent për dhënien e këtij vërtetimi është Drejtoria për të hyra publike.

6.4.5 Vërtetimin nga alineja 7 e nënpikës 6.4.1 e jep organi kompetent në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik. Në Republikën e Maqedonisë organi kompetent për dhënien e këtij vërtetimi është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë.

6.4.6 Dokumentet nga nënpika 6.4.1 nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj duke konsideruar nga afati përfundimtar për parashtrimin e ofertave nga prapa.

6.4.7 Nëse vendi në të cilin është regjistruar operatori ekonomik nuk i jep dokumentet e theksuara në nënpikën 6.4.1 ose nëse ato nuk i përfshijnë të gjitha rastet e lartpërmendura, operatori ekonomik mund të parashtrojë deklaratë të vërtetuar nga organi kompetent.

6.5 Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale

- Për të dëshmuar aftësinë për kryerje të veprimtarisë profesionale, operatori ekonomik duhet të parashtrojë dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik për kryerje të veprimtarisë në lidhje me lëndën e marrëveshjes për qira ose dëshmi se i takon ndonjë shoqata profesionale përkatëse në pajtim me dispozitat e vendit ku është regjistruar

6.6 Dokumentacioni i kërkuar që ka të bëjë për operatorin ekonomik (subjekte juridike dhe fizike), parashtrohet në mënyrë elektronike të bashkëngjitur me fletëparaqitjen në ueb lokacionin: www.deloven-prostor.mk. Pas ngarkimit të dokumenteve, ofertuesit e interesuar në fushën "Deklarata" duhet të fusin të gjitha dokumentet e nevojshme nga shpallja përveç Garancisë bankare, ndërsa në fushën "Garancia bankare" futet e skanuar garancia bankare.

7. GARANCIA BANKARE

7.1. Garancia bankare për seriozitet të ofertës është përcaktuar në pasqyrën tabelore të kësaj shpallje për secilën pjesë të hapësirës veç e veç. Afati për validitet të garancisë bankare për seriozitet të ofertës është 60 ditë nga dita e ankandit publik.

7.2. Garancia bankare për seriozitet të ofertës i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes për ankand publik në tërësi në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së një qiraje mujore të arritur në ankandin publik.

7.3. Obligimi i ofertuesit më të volitshëm është që të paguajë mjetet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do t'i shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës. Marrëveshja për qira lidhet në afat prej 5 ditëve pas pagesës së mjeteve, ndërsa në afat prej 30 ditëve parashtrohet tek noteri për shkak të kryerjes së solemnizimit. Shpenzimet për solemnizim të marrëveshjes bien në barrë të ofertuesit.

8. MËNYRA DHE PROCEDURA E REALIZIMIT TË ANKANDIT

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton kompletimin e dokumentacionit në pajtim me kushtet e shpalljes, pas çka informon parashtruesit e fletëparaqitjeve përmes formës elektronike.

2. Parashtruesve të fletëparaqitjeve që janë të kompletuara, Komisioni në afat prej 3 ditëve nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes u dërgon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgohet lajmërim me arsyetim se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

3. Parashtruesit e fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar për pjesëmarrje në ankandin publik në pajtim me shpalljen, në ditën e realizimit të ankandit publik regjistrohen në internet faqen e theksuar në shpallje me emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, pas çka kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.

4. Ankandi publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i përmbushin kushtet e dhëna në shpallje.

5. Ankandi publik do të mbahet edhe nëse në shpallje është paraqitur edhe vetëm një pjesëmarrës i cili përmbushë kushtet e dhëna në shpallje.

6. Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandi publik do të llogaritet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, pas çka nëse në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për zgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minua të tjera, ndërsa do të përfundojë kur për periudhën prej dy minutave të reja nuk është dhënë ofertë e re.

7. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk është pranuar oferta, gjegjësisht nuk është dhënë ofertë më e lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar i hapësirës afariste ulet për 2% pas çka pjesëmarrësit në[ankandin publik serish do të kenë mundësi të pranojnë gjegjësisht rrisin çmimin e hapësirës afariste.

8. Nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të pesë minutave të dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht jepet çmim më i lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhën e dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë e re.

9. Nëse në kohëzgjatjen e pesë minutave serish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga çmimi përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar të objektit afarist gjatë ankandit mund të bëhet më së shumti deri në 30% të vlerës së caktuar të tregut të hapësirës afariste, pavarësisht se sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik.

10. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për realizimin e ankandit publik i cili u dërgohet të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.

11. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik deri te Komisioni, i cili vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

12. Kundër vendimit të sjellë nga ana e Komisionit, që vendosë pas ankesës së parashtruar, pala ka të drejtë të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

13. Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit më të lartë të përgjithshëm, që paraqet çmimin më të lartë për qira të hapësirës afariste.

14. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje është i obliguar që të paguajë mjetet nga pika 13 dhe duhet të sigurojë depozitë të mjeteve në të holla ose garanci bankare për siguri të obligimeve në shumë prej 3 (tri) qirave mujore, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do t'i shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

15. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parasht4ruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare ofertuesit më të volitshëm i kthehet në momentin e lidhjes së Marrëveshjes për qira.

16. Marrëveshja për qira të hapësirës afariste lidhet për kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 5 vjet. Pas lidhjes së marrëveshjes qiramarrësi në afat prej 30 ditëve të njëjtin e dorëzon tek noteri për kryerje të solemnizimit. Shpenzimet për solemizim të marrëveshjes bien në barrë të qiramarrësit.

MËNYRA E SHPALLJES

Dhënia me qira e pronës së patundshme – pjesë e hapësirës bëhet përmes ankandit publik elektronik dhe me publikimin në dy gazeta ditore që dalin në gjuhën maqedonase – Veçer dhe Nova Makedonija dhe një gazetë ditore që del në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase në komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qytetin e Shkupit në të cilin rajon gjendet hapësira afariste lëndë e shpalljes, ndërsa del së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes – Koha.

9. INFORMACIONET SHTESË

*SHËNIM: Marrëveshja mund të ndërpritet edhe para kalimit të afatit nga ana e IN TDSH nëse objekti prishet dhe fillohet me ndërtimin e objektit të ri, ndërsa në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar më herët mes Ministrisë së kulturës së RM dhe Qeverisë së RM.

Informacione shtesë në lidhje me patundshmërinë, që është lëndë e dhënies me qira, mund të merren çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 14.00 në Institucionin nacional Teatri i dramës Shkup në tel. (02) 30 63 388 и (02) 30 63 453.

IN TEATRI I DRAMËS SHKUP
Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik

VEPRIMTARIA BIBLIOTEKARE

KUSHTE JOFUNKSIONALE, MUNGESË FONDESH

Koha Evis HALILI

Shkup, 6 shkurt - Fond të varfër, kushte të këqija, anëtarësi që reduktohet..., janë disa prej problemeve që në pjesën më të madhe të bibliotekave në qytete të ndryshme. Sipas një raporti më të fundit të Ministrisë së Kulturës situata e tanishme argumentohet me faktin se veprimtaria bibliotekare ka qenë një prej sektorëve që është investuar më së pakti. Por edhe për këtë vit për bibliotekat Ministria e Kulturës parashikon që të vërë në dispozicion një fond prej 88 milionë denarësh, shumë kjo që nuk është më shumë se katër për qind më e madhe sesa një vit më parë. Në qoftëse në disa qendra të kulturës, kushtet e sallave të leximit janë më të mira, apo fondi bibliotekar më i pasur, si në qytetin e Dibrës, në Tetovë, situata është krejtësisht ndryshe në Gostivar. Biblioteka e Tetovës, e cila renditet si një prej bibliotekave më të mëdha në vend, sa i përket fondit të librave (mbi 150 mijë tituj) prej disa vitesh funksionon në hapësira dhe kushte aspak adekuate, brenda godinës së Qendrës së Kulturës. Kanë lexues, një shifër konstante brenda pesë viteve të fundit që arrin deri në katër mijë persona aktivë, fond titujsh që shtohet, por gjithçka e organizuar të funksionojë në kushte minimale, librat e rinj dhe i tërë arkivi ruhet jo sipas radhitjes adekuate dhe të kapshëm për lexuesin.

"Por gjithsesi funksionojmë kështu prej disa vitesh dhe i jemi përshtatur kushteve. Libra kemi, po ashtu edhe lexues, por hendikepi më i madh janë mungesa e sallave të leximit, internetit, hapësirave të duhura. Kjo gjendje është e njëjtë prej shumë vitesh dhe mund të ndryshojë vetëm me ndërtimin e objektit të ri", thotë drejtori Murtezani.

Por në biblioteka të tjera, si në atë të Qendrës së Kulturës në Gostivar problemet janë të tjera. Numri i lexuesve dhe anëtarësimet janë përgjysmuar, interesimi është gjithnjë e më i vogël, por edhe furnizimi me tituj dhe libra të rinj lë shumë për të dëshiruar. Na sigurohen vetëm 200 mijë denarë, që janë pak për t'u pajisur me literaturën e duhur. Nevojat tona janë specifike dhe nuk mund të na akordohen po aq sa edhe të themi Kriva Pallankës, apo ndonjë biblioteke të një qytetit- tjetër që ka pak banorë", thotë drejtori i qendrës Luan Zenku. Sipas tij, literatura që duhet të jetë të paktën në katër gjuhë (shqip, turqisht, maqedonisht, anglisht) nuk mund të sigurohet me buxhet minimal. Sipas Zenkut interesimi për librin mungon si nga ana e lexuesit, ashtu edhe nga ana e shkollave. Paketat dhe ofertat e ndryshme për anëtarësim nuk shfrytëzohen nga banorët, ndërsa mes vetë bibliotekave në qytetet shqiptare mungon koordinimi sa i takon literaturës në gjuhën shqipe.

Shumica e bibliotekave funksionojnë në hapësira të duhura dhe kushte aspak adekuate. Hendikepi më i madh është mungesa e sallave të leximit, internetit. Veprimtaria bibliotekare ka qenë një prej sektorëve që është investuar më së pakti. Paketat dhe ofertat e ndryshme për anëtarësim nuk shfrytëzohen nga banorët. Librat e rinj ruhen jo sipas radhitjes adekuate. Kërkesat për ekzemplarin e detyrueshëm janë neglizhuar

Sipas një analize të Ministrisë së Kulturës së situatës se ku gjenden bibliotekat dhe si funksionojnë ato është e keqe, sidomos sa i takon ruajtjes së fondeve dhe mungesave për sigurimin e ekzemplarëve të detyrueshëm. Po ashtu, ceket në raport, pjesa më e madhe e bibliotekave janë të vendosura në objekte jofunksionale, që nuk janë ndërtuar sipas standardeve për ndërtimin e bibliotekave. Sipas prioriteteve të këtij institucioni parashikohet çelja e disa bibliotekave të reja, ndërsa pranë qendrave të kulturës të ngrihen biblioteka publike, si në Gostivar, Strugë, Kërçovë e të tjera. Në Maqedoni numërohen gjithsej 51 biblioteka me një fond bibliotekar rreth dy milionë ekzemplarë. Po ashtu krahas bibliotekave publike funksionojnë edhe ato të profilizuara, një nacionale, 13 për shkollat e larta, 10 të specializuara dhe gjashtë biblioteka – institucione nacionale. Një pjesë e bibliotekave, 34 të tilla janë në kompetenca të Ministrisë së Kulturës, ndërsa një grup tjetër varen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. "Aktiviteti për mbrojtjen e fondeve, kërkesat për ekzemplarin e detyrueshëm janë neglizhuar dhe subjekti i autorizuar, Biblioteka universitare nuk ka arritur që ta kryejë këtë funksion... pjesa më e madhe e bibliotekave janë të vendosura në objekte jofunksionale, që nuk janë ndërtuar sipas standardeve për ndërtimin e bibliotekave, duke përfshirë këtu edhe objektin më të ri, Bibliotekën nacionale", thuhet në raport, përcjell KOHA.

Pritet që Ministria e Kulturës të çelë biblioteka të reja në qytete si Tetovë (bëhet fjalë për projektin Biblioteka Teatri që ka nisur prej disa vitesh), Ohër..., ndërsa pranë qendrave të kulturës të ngrihen biblioteka publike, si në Gostivar, Strugë, Kërçovë e të tjera.

Prania e Gëtes në kulturën shqiptare

Krijimtaria e shkrimtarit e filozofit të madh gjerman, Johann Wolfgang von Goethe, e cila shtrihet midis shekullit XVIII dhe XIX, kaherë kishte ndikim edhe në kulturën shqiptare. Pos që disa prej veprave të tij janë përkthyer në gjuhën shqipe, Goethe nëpërmjet krijimtarisë të tij ka arritur të ndikojë edhe në veprat e shkrimtarëve shqiptarë, shkruan sot "Koha Ditore".

Në këtë konstatim ka ardhur studiuesja e profesoresha e letërsisë gjermane Albulena Blakaj. Monografia "Goethe dhe receptimi i tij në kulturën shqiptare", që është promovuar të hënën në bibliotekën kombëtare të Kosovës, "Pjetër Bogdani", është e para e këtij lloji që shoshit ndërlidhjen midis Goethes dhe kulturës shqiptare. Kërkim mbi gjurmët e Goethes në letërsinë dhe kulturën shqiptare, kërkim mbi fenomenin Goethe, i bërë sipas metodës integrale që argumenton interesimin e përkthyesve, studiuesve, shkrimtarëve dhe lexuesve shqiptarë për veprën kolosale të autorit gjerman, receptimi, adhurimi dhe ndikimi i të cilit në kulturën shqipe vjen bashkë me konsolidimin estetik të saj, është përshkrimi që i është bërë librit të Blakajt. Për librin e botuar nga shtëpia botuese "OM", ka folur shkrimtari e studiuesi Gëzim Aliu. Sipas tij, Blakaj mendon se nëse Goethe ka ndikuar te të gjithë popujt evropianë, ka ndikuar edhe te autorët shqiptarë. Studiuesi e shkrimtari Ag Apolloni ka thënë se libri i Blakajt është një studim që ballafaqon një shkrimtar të madh me kulturën shqiptare, duke shtuar kontributin në shkencën e studimeve mbi Goethen dhe duke e lartësuar kulturën shqiptare, e cila ishte mjaft mikpritëse, madje shpesh adhurimtare ndaj shkrimtarit gjerman.

Ermonela Jahon mirëpritet në Pekin

Sopranoja Ermonela Jaho është ngjitur në skenën e Qendrës Kombëtare të Arteve në Pekin në rolin e Thaïs, personazhit kryesor të operës me të njëjtin titull. Ajo, ka interpretuar në krah të baritonit me famë botërore Placido Domingo, që në veprën e kompozitorit francez, Jules Massenet, u prezantua me rolin kryesor të murgut, Athanael. Ngjarjet zhvillohen në Egjiptin bizantin të shekullit të IV para erës sonë. Murgu Athanael që jeton në Aleksandri, përpiqet të konvertojë kurtizanen e quajtur Thais në krishterim, por zbulon mëkatin trupor dhe e gjen veten të nënshtruar ndaj hijeshisë së saj. Opera 'Thaïs' është vepra e parë e Qendrës Kombëtare të Arteve të Pekinit për kalendarin e vitit 2018, publiku është mrekulluar me performancën e kësaj shfaqje, ku edhe duartrokitjet e shumta nuk kane munguar.

Kadare, në garë për çmimin e letërsisë nga Banka Evropiane

Ismail Kadare dhe vepra e tij "Kamarja e Turpit" është përzgjedhur si një ndër gjashtë autorët më të mirë në garë për Çmimin e Letërsisë që do të jepet nga Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim.

Në listën e ngushtë prej gjashtë shkrimtarësh, Kadare garon krahas autorëve të tjerë të njohur, mes tyre edhe ndaj shkrimtarit Orhan Pamuk.

E shkruar rreth 40 vite më parë në gjuhën shqipe, si një parodi mbi diktaturën komuniste, në gjuhën angleze, kjo vepër u përkthye vetëm vitin e shkuar. Ceremonia e ndarjes se çmimit do të mbahet më 10 prill, ndërsa kjo është hera e parë që Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim akordon një çmim për letërsinë, i cili do të shoqërohet edhe me vlerën e 20.000 eurove.

MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
AKADEMIA USHTARAKE "GJENERAL MIHAILO APOSTOLLSKI"- Shkup
Në bazë të nenit 25 paragrafi 1 të Ligjit për Akademinë ushtarake (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 83/2009),
Akademia ushtarake në Shkup publikon:

K O N K U R S

për regjistrimin e dëgjuesve për aftësim dhe përkryerje profesionale në gjininë e aviacionit në Akademinë ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski "- Shkup të individëve të cilët kanë të kryer ciklin e parë studimor për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë

Akademia ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski "- Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm "Akademia" publikon konkurs për pranimin e 8 (tetë) dëgjuesve për aftësim dhe përkryerje profesionale në gjininë e aviacionit për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm Ministria dhe Armata).Aftësimi dhe përkryerja profesionale në gjininë e aviacionit është me kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë muaj.

TË DREJTË PËR KONKURRIM NË KONKURS

Në konkurs mund të paraqiten kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme në vijim:

KUSHTET E PËRGJITHSHME

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të kenë të kryer ciklin e parë studimor, gjegjësisht më së paku 180 kredi sipas EKTS(sipas programit studimor) ose të kenë kryer shkallën VII/1;
- mos të jenë më të moshuar se 28 (njëzetetetë) vjet në ditën e publikimit të konkursit;
- të kenë aftësi të mira psikofizike (e dëshmon komisioni ushtarak - mjekësor).

KUSHTET E POSAÇME

- ndaj tyre të mos jetë e shqiptuar masa e sigurisë, ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës,
- ti plotësojnë kriteret e sigurisë të parapara me Ligjin për klasifikim të informatave, të cilin e dëshmon organi kompetent në Ministrinë e Mbrojtjes.

Të drejtë konkurrimi kanë edhe kandidatët shtetas të RM-së të cilët ciklin e parë studimor e kanë kryer jashtë vendit.

Kandidatët shtetas të RM-së të cilët e kanë kryer ciklin e parë studimor jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin për nostrifikimin e diplomës, të marrë jashtë vendit, e dhënë nga Ministria kompetente.

KRITERET PËR ZGJEDHJE DHE REGJISTRIM

Gjatë zgjedhjes për regjistrim të kandidatëve për aftësim dhe përkryerje profesionale në gjininë e aviacionit të kandidatëve të cilët kanë kryer ciklin e parë studimor për oficerë në gjininë e aviacionit për nevojat e Ministrisë dhe Armatës, përveç kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, në rangimin fillestar, do të merret parasysh suksesi i përgjithshëm i kandidatëve i arritur gjatë ciklit të parë studimor, kontrolli i përgatitjes fizike.

Gjatë pranimit të kandidatëve për aftësim dhe përkryerje profesionale të cilët kanë kryer ciklin e parë studimor për nevojat e Armatës, do të respektohet principi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive.

Pas rangimit të parë, kandidatët do të dërgohen në seleksionim të mëtutjeshëm.

Seleksionimi i mëtutjeshëm përbëhet nga kontrolle seleksionuese si në vijim:

- kontroll i njohjes së gjuhës angleze (të fituara minimum 70 pikë sipas American language course placement test – ALCPT test);
- kontroll- seleksionim në tokë;
- gjendje shëndetësore të veçantë, të cilën e dëshmon komisioni mjekësor kompetent për personelin e aviacionit;
- kontroll- seleksionim në ajër;

Të gjitha kontrollet seleksionuese kanë karakter eliminues. Kandidatët të cilët nuk do të kalojnë ndonjë nga kontrollet seleksionuese, e humbin të drejtën për pjesëmarrje në kontrollet tjera dhe në këtë mënyre e humbin statusin e kandidatit.

PROCEDURA PËR ZBATIMIN E KONKURSIT

Konkursin e zbaton Komisioni për konkurrim të cilin e formon dekani i Akademisë ushtarake.

Aftësitë psikofizike të kandidatëve dëshmohen me kontrolle dhe vlerësime specialistike nga Komisioni ushtarak mjekësor në Qendrën ushtarake mjekësore në Shkup.

Pas marrjes së rezultateve nga Komisioni ushtarak mjekësor, kandidatët të cilët kanë kaluar i nënshtrohen kontrollit për aftësi fizike.

Kontrolli për aftësi fizike kryhet sipas Test programit për kontroll të aftësive fizike.

Kontrolli për aftësi psikofizike dhe kontrolli për aftësi fizike kanë karakter eliminues.

Vlerësimi i suksesit në renditjen fillestare

Vlerësim i kritereve të suksesit të përgjithshëm dhe suksesit të arritur gjatë kontrollit të përgatitjes fizike shprehet në pikë.

Numri maksimal i pikëve të cilat mund ti fitojë një kandidat sipas kritereve të suksesit të përgjithshëm dhe suksesit të arritur gjatë kontrollit të përgatitjes fizike është 100 pikë.

Suksesi i përgjithshëm i kandidatëve i arritur gjatë ciklit të parë studimorë llogaritet më së shumti 80 pikë.

Gjatë kontrollit të përgatitjes fizike kandidatët duhet të kenë dokument për identifikim (letërnjoftim ose pasaportë).

Rangimin e kandidatëve e bën Komisioni për konkurrim.

Në afat prej 24 orëve pas realizimit të kontrollit të përgatitjes fizike, Komisioni për konkurrim përgatit dhe publikon në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Akademisë http://www.ma.edu.mk/ një ranglistë preliminare të rezultateve të kandidatëve.

Në ranglistën preliminare tregohet numri i pikëve nga suksesi i përgjithshëm i kandidatëve i arritur gjatë ciklit të parë studimorë, numri i pikëve nga kontrolla e përgatitjes fizike dhe numri total i pikëve, për çdo kandidat.

Në afat prej 24 orëve nga publikimi i ranglistës preliminare, kandidatët kanë të drejtë ankese deri te Drejtoria e dekanatit të Akademisë nëpërmjet të komisionit për konkurrim.

Vendimet e mara nga ankesat e kandidatëve do të publikohen. në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Akademisë http://www.ma.edu.mk/ në afat prej 24 orëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e ankesave .

Vendimi i Drejtorisë së dekanatit për ankesat është përfundimtar.

Ranglista preliminare fillestare bëhet valide edhe pas kalimit të afatit për parashtrimin e ankesave.

Pas përfundimit të rangimit fillestar kandidatët vazhdojnë me kontrolle seleksionuese: për njohjen e gjuhës angleze, kontrollin - seleksionim në tokë, gjendjen shëndetësore të veçantë dhe kontrollin- seleksionim në ajër.

Pas përfundimit të secilit kontroll seleksionues komisioni i caktuar për kryerjen e kontrollit seleksionues, i dorëzon Komisionit për konkurrim listë të personave të cilët e kanë kaluar seleksionimin.

Në afat prej 24 orëve pas realizimit të secilit kontroll seleksionuese, Komisioni për konkurrim publikon në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Akademisë http://www.ma.edu.mk/ listë të kandidatëve të cilët e kanë kaluar kontrollin.

Në secilën listë nga kontrolli seleksionuese, kandidatët kanë të drejtë ankese deri te Drejtoria e dekanatit të akademisë nëpërmjet Komisionit për konkurrim, në afat prej 24 orëve nga publikimi i listës.

Vendimet për ankesat publikohen në tabelën e shpalljeve e akademisë në afat prej 24 orëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e ankesave.

Vendimi i Drejtorisë së Akademisë për ankesat është përfundimtar.

Listat e kontrolleve seleksionuese bëhen valide pas kalimit të afatit për parashtrimin e ankesave.

Pas publikimit të ranglistës përfundimtare Këshilli mësimor-shkencor i Akademisë përcjell propozimin për të njëjtën dhe ia dorëzon ministrit të Mbrojtjes, i cili bënë zgjedhjen e kandidatëve.

A F A T E T

Kandidatët e interesuar për regjistrim për aftësim dhe përkryerje profesionale në gjininë e aviacionit në Akademi, mund të dorëzojnë dokumentet e nevojshme për paraqitje nga dita e publikimit të konkursit deri më 09.03.2018.

Pas shqyrtimit të fletë paraqitjeve, kandidatët e paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të ftohen për shqyrtimin e aftësive psikofizike dhe përgatitjes fizike.

DOKUMENTET PËR PJESËMARRJE NË KONKURS

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitje (formular i plotësuar i cili merret në Akademi)
- Diplomë për arsim të lartë të kryer
- Certifikatë e shtetësisë
- Certifikatë e lindjes
- Certifikatë nga gjykata kompetente se ndaj tyre nuk është shqiptuar masë e ndalesës së ushtrimit të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.
- Biografi e shkurtë (CV).

Kandidatët shtetas të RM-së të cilët arsimit e lartë e kanë kryer jashtë vendit, duhet të dorëzojnë dokument të dhënë nga ministria kompetente për nostrifikimin e diplomës nga ministria përkatëse.

Dokumentet për paraqitje në konkurs kandidatët duhet ti dorëzojnë personalisht në Akademinë ushtarake në Shkup, rr. "Vasko Karangelevski" pn.Shkup

SHKOLLIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Kandidatët e pranuar në Konkursin për aftësim dhe përkryerje profesionale në gjininë e aviacionit në Akademi për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë fitojnë statusin e dëgjuesit.

Të drejtat e veçanta dhe detyrimet e dëgjuesve për oficerë në gjininë e aviacionit për nevojat e Armatës së Republikës së Maqedonisë do të rregullohen me marrëveshje.

Pas përfundimit të aftësimit dhe përkryerjes profesionale dëgjuesit fitojnë gradë adekuate në gjininë e aviacionit dhe pranohen në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në punë në Ministri dhe Armatë.

Me respekt,
AKADEMIA USHTARAKE

Në bazë të nenit 20-g paragrafi 1 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016) dhe neni 22 paragrafi1 pika1 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 167/2015 dhe 27/2016), Ministria e punëve të brendshme, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin e 5 personave në Ministrinë e punëve të brendhsme me kohë të pacaktuar edhe atë:

1. Mjeshtër i përgjithshëm në Sektorin për punë të brendshme në Shkup - 2 realizues
2. Punëtorë të përgjithshëm në Sektorin për punë të brendshme në Shkup - 2 realizues dhe
3. Mjeshtër i përgjithshëm në Sektorin për punë të brendshme në Kumanovë - 1 realizues

Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të jenë të moshës madhore;
- të ketë aftësi shëndetësore të përgjithshme për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos kenë ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Përkrah kushteve të përgjithshme, kandidatët të cilët do të paraqiten duhet ti plotësojnë **kushtet e posaçme** të vërtetuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Byron për siguri publike:

- të kenë të mbaruar arsim të mesëm pa përvojë pune

Kandidatët e interesuar duhet ti dorëzojnë dëshmitë në vijim për plotësimin e kushteve të nevojshme për vendin e punës, në origjinal ose koje e vërtetuar te noteri:

- diplomë për arsim të mesëm të mbaruar
- certifikatë të lindjes,
- biografi të shkurtë dhe letër motivuese dhe
- dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënimi për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës ditore dhe javore:

-orari i punës ditore vertëtohet me fillim të orarit të punës ndërmjet orës 7:30 dhe orës 08:30 dhe përfundimi i orarit të punës së njëjtë ndërmjet orës15:30 dhe orës 16:30, ndërsa me kohëzgjatje të orarit të punës ditore prej tetë orë. Të drejtën e pushimit të orarit të punës ditore shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 12:30, me kohëzgjatje të plotë prej 30 minuta.
-orari i punës javore është 40 orë pune (nga e hëna deri të premten).

Neto rroga bazë për vendet e punës është 16.560,00 denarë.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është 5 (pesë) ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhëshme e botimit të shpalljes (duke mos llogaritur vetë ditën e shpalljes)

Ministria e punëve të brendshme me obligim zyrtar e siguron dokumentin për dëshminë e shtetësisë.

Kandidatët nuk janë të obliguar të dorëzojnë dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore, gjegjësisht Ministria e punëve të brendshme gjat lidhjes së kontratës për punësim do të vendosë nëse kandidati do të udhëzohet në barë të Ministrisë, para Komisionit shëndetësorë të Ministrisë së punëve të brendshme për arsye të vërtetimit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore e nevojshme për vendin e punës.

Procedura për seleksionim dhe zgjedhje të personave të cilët do të themelojnë marrdhënie pune në Ministrinë e punëve të brendshme në bazë të shpalljes publike do ta zbatojë komisioni i posaçëm i formuar në Ministrinë në afat të përcaktuar me Ligjin për marrëdhënie pune.

Kandidatët e interesuar dokumentacionin e nëvojshëm në varshmëri nga ajo se për cilin vend aplikojnë duhet ta dorëzojnë në vendet në vijim:

- për vendin e punës nën pikën 1 dhe 2, kandidati është i obliguar ta dorëzojë në arkivën e Sektorit për punë të brendshme - Shkup apo me postë në adresën: "Angel Dimovski" nr.8, 1000 Shkup (me shenjë "për shpallje për punësim") dhe
- për vendin e punës nën pikën 3, kandidati është i obliguar ta dorëzojë në arkivën e Sektorit për punë të brendshme - Kumanovë apo me postë në adresën: "11 Oktomvri" nr.12, 1310 Kumanovë (me shenjë "për shpallje për punësim").

Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët e dorëzojnë çdo ditë pune në afatin e përcaktua, gjatë orarit të punës (ora 07:30-16:30).

Gjatë punësimit do të zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe barabartë të qytetarëve që i përkasin të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë, pa u shkelur kriteret për profesionalizëm dhe kompetencë.

Dokumentacioni jo në kohë dhe i pa kompletuar nuk do të shqyrtohet.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

PUBLIKOHET STRATEGJIA E BE-së

MALI I ZI DHE SERBIA LIDERE NË RAJON

Kryetari i Komisionit Europian, Jean Claude Juncker, ka porositur vendet e Ballkanit se asnjëri prej tyre nuk do të pranohet në Bashkimin Europian deri sa nuk zgjidhin të gjitha kontestet kufitare me fqinjët

Serbia dhe Mali i Zi janë të vetmet vende të Ballkanit Perëndimor, të cilat në Strategjinë e Komisionit Evropian do të marrin afat të qartë kalendarik për pranim të mundshëm në BE në vitin 2025, ndërsa datat e integrimit evropian të vendeve të tjera të rajonit nuk do të përmenden.

Kështu thuhet në versionin përfundimtar të Strategjisë për Perspektivën e Besueshme të Ballkanit Perëndimor, teksti i së cilës u miratua të hënën në takimin e shefave të kabinetit të Komisionit Evropian. Në dokumentin që ka siguruar "Radio Evropa e Lirë", Mali i Zi dhe Serbia identifikohen sërish si lidere ne rajon dhe pranimi i tyre në BE parashihet të bëhet për shtatë vjet.

Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nga ky dokument do të sigurojnë vetëm perspektivën për integrim evropian, pa afate kalendarike për pranimin e tyre të mundshëm.

"Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në bazë të kushteve të plotësuara. Me përpjekje dhe angazhim të vazhdueshëm, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet kandidate për anëtarësim. Kosova ka mundësi të bëjë përparim të qëndrueshëm me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të avancojë në rrugën e saj evropiane kur të lejojnë rrethanat objektive", thuhet në Strategji. Në këtë dokument, Bashkimi Evropian ka ashpërsuar gjuhën në kapitullin për sundimin e ligjit. Ai qartë paralajmëron se vendet e rajonit do të bëhen anëtare të BE-së, "por jo në gjendjen ku janë sot". Strategjia po ashtu vë në dukje se në rajonin e Ballkanit Perëndimor ekziston "ndërhyrje e gjerë politike në media dhe kontroll mbi to".

Strategjia për Ballkanin Perëndimor vë theksin mbi dy çështje të rëndësishme që ndikojnë në të gjithë rajonin dhe që duhet të zgjidhen përpara se ndonjë vend i rajonit t'i bashkohet BE-së: dialogu midis Kosovës dhe Serbisë dhe mosmarrëveshjet dypalëshe.

"Nuk mund të ketë qëndrueshmëri të përhershme në rajon pa normalizim efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, përmes dialogut që e ndihmon BE-ja. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht e detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve është urgjente dhe vendimtare, në mënyrë që Kosova dhe Serbia të përparojnë në rrugën evropiane", thuhet në tekstin e Strategjisë, e cila parashikon që një marrëveshje e tillë të arrihet deri në fund të vitit 2019. Kur bëhet fjalë për problemet e pazgjidhura kufitare midis këtyre vendeve, Komisioni Evropian kërkon që palët "t'i dërgojnë në arbitrazh përfundimtar", siç është Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Vendimet e arbitrazhit do të duhet pastaj t'i pranojnë dhe respektojnë të dyja palët, përpara se të futen në BE. Komisioni Evropian ka vërejtje konkrete edhe në kapitullin për ekonominë, ku po ashtu thuhet se ka ndërhyrje politike. Ndërkohë kryetari i Komisionit Europian, Jean Claude Juncker, ka porositur vendet e Ballkanit se asnjëri prej tyre nuk do të pranohet në Bashkimin Europian deri sa nuk zgjidhin të gjitha kontestet kufitare me fqinjët. "Këto probleme duhet të zgjidhen para se të përfshihen në BE ose nuk do të ketë anëtarësime të reja", deklaroi Juncker në Parlamentin Europian.

Paralajmërimi i tij erdhi pas një fjalimi në Parlamentin Evropian të kryeministrit kroat, Andrej Plenkoviq. Kroacia dhe Sllovenia – të dyja anëtare të BE-së – janë bllokuar në një mosmarrëveshje kufitare që daton që nga ndarja e ish-Jugosllavisë në të '90-at. Juncker paralajmëroi se Serbia dhe Mali i Zi ndoshta do të mund të bëhen anëtare të BE-së në vitin 2025, nëse i përmbushin të gjitha kushtet, raporton AP

LUFTA E SPANJËS KUNDËR JASHTËQITJEVE TË QENVE

Kush nuk ka shkelur ndonjëherë jashtëqitjen e ndonjë qeni dhe nuk e ka mallkuar pronarin e tij. Qyteti jugor i Spanjës, Malaga, ka gjetur tani një mënyrë të pazakontë për të disiplinuar pronarët e qenve

Malagasit ende nuk po kuptojnë asgjë. Por policia mjedisore është tashmë rrugës për tek pronarët e qenve. Një detyrë krejtësisht e re për policët: ata kontrollojnë nëse të gjithë qentë i janë nënshtruar testit të ADN-së. Qyteti jugor i Spanjës, Malaga, duket se ka gjetur një mënyrë të pazakontë për të disiplinuar pronarët e qenve. Që prej muajit janar aty është në fuqi një rregullore e re: të gjithë qentë duhet të regjistrohen në bazë të ADN-së. "Që nga 15 janari janë në fuqi gjobat. Tani vetëm po ju informojmë, por herën tjetër do t'ju gjobisim", u thotë polici disa kalimtarëve që kanë dalë shëtitje me qentë e tyre. Kush nuk ka shkelur ndonjëherë jashtëqitjen e ndonjë qeni dhe nuk e ka mallkuar pronarin e tij. Po si funksionon lufta kundër jashtëqitjeve të qenve? Për shembull, nëse një qen dhjet fshehurazi, atëherë shtrohet pyetja, kush e bëri? Në zonat e banuara dhe në parqe ka mjaft "mina" anonime që kanë lëshuar qentë. Prej tani, pronari i qenit do të dënohet me 500 euro nëse nuk e mbledh mutin që ka bërë qeni i tij në rrugë apo parqe. Dhe për habi shumica e malagasve nuk mendojnë se gjoba është e lartë. "Unë jam dakord me shumën. Dënimi duhet të ketë efekt frikësues. Dhe që pronarët e qenve ta mbledhin jashtëqitjen e qenve, dënimi duhet të jetë vërtet i lartë", thotë një grua. "Të vjen për të vjell kur sheh jashtëqitjet e qenve në rrugë, ose kur sheh fëmijët që luajnë në park dhe shkelin pisllëqet e qenve", shton një tjetër. Nga analiza e ADN-së në jashtëqitjen e qenve mund ta gjesh lehtë pronarin dhe ta ndëshkosh atë. Këshilli bashkiak i Malagës e mori këtë vendim një vit e gjysmë më parë. Dhe Luis Medina-Montoya, drejtor i Mjedisit në bashkinë e qytetit, thotë se të gjitha partitë e përfaqësuara në këshillin bashkiak janë dakord me vendimin. Ai është krenar që projekti i ADN-së tani po fillon të veprojë. Dritë e gjelbër për një projekt ambicioz që deri tani në Evropë është realizuar vetëm në qytete të vogla, por jo në qytete të mëdha. Po si regjistrohen qentë? Veterineri Emilio u merr gjak qenve, pastaj e dërgon gjakun për analizë dhe u vë qenve një shenjë në rripin e qafës, në mënyrë që policia ta shikojë që nga larg që qeni është i regjistruar. "Në këtë mënyrë mund të kontrollohen të gjithë qentë e qytetit", thotë Emilio. Por realiteti është ndryshe: kur kontrollorët shohin jashtëqitjet e qenve në rrugë, është e vështirë që ata ta gjejnë se kush i ka bërë ato. Deri tani në regjistrin e ADN-së në Malagë janë regjistruar vetëm 20.000 nga 100.000 qentë e qytetit. Dhe ka dyshime të mëdha se qentë i kanë regjistruar vetëm pronarët e mirë që e mbledhin me qese jashtëqitjen e qenve dhe jo neglizhentët. Shumica e jashtëqitjeve të mbledhura në laboratorin e ADN-së u përkasin qenve të paregjistruar. Por përfundimet e analizave regjistrohen, në mënyrë që nëse gjendet pronari - ai të vihet para përgjegjësisë. Po me qentë e turistëve si është puna. Ata nuk testohen dhe nuk dënohen. Megjithatë, Malaga e sheh veten si pararojë. "Ne na kanë ardhur kërkesa edhe nga Madridi dhe qytete të tjera të mëdha që kërkojnë të mësojnë nga përvoja jonë dhe që të marrin ndoshta vendime të ngjashme", thotë Luis Medina-Montoya. Pra se mos harroni ndonjëherë të merrni me vete qeset, ndryshe ju presin gjoba të majme.

Republikës së Maqedonisë
Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave

Në bazë të nenit 21-a paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës s Maqedonisë” nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 02/17 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/18), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr. 02/18
Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik

I. LËNDË E SHPALLJES PUBLIKE

Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **758 ha 76 ar 35 m^2** në rajonet në vijim të Republikës së Maqedonisë:

Pasqyre e përmbledhur sipas rajoneve

Numri rendor	Rajon	Ha	Ar	m^2
1	Vinicë	48	35	43
2	Gjevgjeli	50	10	73
3	Strugë	15	54	76
4	Kavadar	374	04	78
5	Kratovë	24	19	44
6	Koçan	101	73	87
7	Negotinë	144	77	32
GJITHSEJ		**758**	**76**	**35**

Rajoni Vinicë

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Istibanja	8	31	19	833,00
2	Peklani	4	17	55	250,00
3	Bllatec	3	76	43	452,00
4	Bllatec	5	00	18	600,00
5	Bllatec	18	25	39	1.095,00
6	Bllatec	6	08	22	231,00
7	Bllatec	1	69	52	102,00
8	Lipec	1	06	95	49,00
Gjithsej		**48**	**35**	**43**	

Rajoni Gjevgjeli

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Crniçan	7	18	82	431,00
2	Negorc	3	94	20	237,00
3	Negorc	5	69	91	513,00
4	Sermenin	5	21	94	320,00
5	Sermenin	14	92	38	895,00
6	Sermenin	3	50	92	211,00
7	Prdejci	3	98	51	359,00
8	Prdejci	2	75	28	248,00
9	Prdejci	2	88	77	260,00
Gjithsej		**50**	**10**	**73**	

Rajoni Strugë

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Misleshevë –jashtë r. n	10	00	00	1.200,00
2	Misleshevë –jashtë r. n	5	54	76	666,00
Gjithsej		**15**	**54**	**76**	

Rajoni Kavadar

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Stragovë	17	28	95	1.037,00
2	Stragovë	13	62	25	817,00
3	Stragovë	6	66	27	400,00
4	Stragovë	23	18	23	1.391,00
5	Stragovë	33	89	71	2.034,00
6	Stragovë	22	52	86	1.352,00
7	Stragovë	12	39	78	744,00
8	Stragovë	16	52	93	992,00
9	Stragovë	20	38	01	1.222,00
10	Stragovë	22	33	23	1.340,00
11	Boshava	31	70	99	1.903,00
12	Boshava	6	24	00	374,00
13	Bojançishte	4	81	14	289,00
14	Bojançishte	7	52	86	452,00
15	Bojançishte	4	24	87	255,00
16	Mrzen Oraovec	8	43	71	389,00
17	Mrzen Oraovec	3	33	34	200,00
18	Mrzen Oraovec	34	50	34	1.035,00
19	Garnikovë	39	49	46	2.370,00
20	Garnikovë	4	53	19	272,00
21	Garnikovë	7	06	93	424,00
22	Garnikovë	13	72	93	824,00
23	Garnikovë	16	56	72	994,00
24	Sopot	3	02	08	181,00
Gjithsej		**374**	**04**	**78**	

Rajoni Kratovë

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Konjuf	24	19	44	2.157,00
Gjithsej		**24**	**19**	**44**	

Rajoni Koçan

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Lepopellc	34	41	67	2.065,00
2	Lepopellc	6	68	97	401,00
3	Lepopellc	20	66	11	1.240,00
4	Lepopellc	5	94	90	535,00
5	Lepopellc	7	00	00	420,00
6	Koçan	8	21	10	986,00
7	Koçan	11	11	89	1.334,00
8	Orizari	4	60	29	276,00
9	Sokollarcë	3	09	94	280,00
Gjithsej		**101**	**73**	**87**	

Rajoni Negotinë

Tërësia gjeografike	Komuna katastrale	Sipërfaqja ha	ar	m^2	Çmimi fillestar për ankand publik të shprehur në euro për tërë tërësinë
1	Bistrenci	144	77	32	12.895,00
Gjithsej		**144**	**77**	**32**	

Të dhënat për tokën bujqësore lëndë e kësaj shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përmbajtura në listën pronësore) janë në pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilën sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësinë periferike të Ministrisë, ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.
Listat me indikacionet katastrale të tokës që e identifikojnë janë dhënë në pasqyrat e detajuara si shtojcë e shpalljes.
Qëllimi për të cilin jepet toka bujqësore në pronësi të shtetit me qira përmes shpaljes publike është për:
- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare (vreshta, pemishte, kmelj) dhe oranzheri për periudhë deri më 30 vjet,
- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare me lajthi për periudhë prej 70 vjetëve,
- ngritje të ullishtave për periudhë deri më 50 vjet,
-kultivim të kulturave të tjera bujqësore për periudhë deri më 15 vjet,
- livadheve për periudhë deri më 15 vjet,
- për kultivimin e drunjve që rriten shpejtë në tok[ën bujqësore e cila gjendet në lartësi mbidetare mbi 700 metra, për periudhë prej 30 vjet,
- baseneve të peshqve deri në 20 vjet dhe
- aktiviteteve sportive-rekreative dhe turizëm rural deri në 30 vjet.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.
Subjektet fizike duhet të jenë realizues të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.
Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.
Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore tu jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.
Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik, janë të obliguar që të dorëzojnë:
a) për subjektet juridike:
- fletëparaqitje (formulari është dhënë i bashkëngjitur në faqen e MBPEU ose mund të merret në njësinë rajonale të Ministrisë);
- dëshmi (akt) të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik (nëse subjekti aplikon me filial është e nevojshme që dokumenti i dhënë nga regjistri qendror të përmbajë të dhëna për veprimtarinë kryesore të subjektit juridik dhe të filialit);
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
- biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin e të punësuarve, aspektet e tregut, pritshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të jetë i nënshkruar në secilën faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose personit të autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizimit të vërtetuar në noter);
-deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përmbushur obligimet nga ajo marrëveshje;
- garanci bankare për pjesëmarrje në shpalljen publike në shumë të qirasë së ofruar nëntëmujore dhe
- dëshmi për pajisje materiale – teknike (leje qarkullimi, fatura, marrëveshje për shitblerje, të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt i ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet themelor për përpunimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).

b) për subjektet fizike:
- fletëparaqitje (formulari është dhënë i bashkëngjitur në faqen e MBPEU ose mund të merret në njësinë rajonale të Ministrisë);
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
- fotokopje të letërnjoftimit;
- vërtetim për regjistrim në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore ose vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga Regjistri qendror për regjistrim si tregtar i vetëm;

- program për shfrytëzimin e tokës i cili përmban të dhëna elementare për familjen, përgatitjen teknike-teknologjike, qëllimin për të cilën do të përdoret toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);
- deklaratë për besueshmërinë e të dhënave të dhëna në fletëparaqitje e vulosur në noter;
-deklaratë të vulosur në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës të personit juridik i cili ka përdorur tokë bujqësore me qira në pronësi të shtetit ndërsa nuk i ka plotësuar obligimet e asaj marrëveshje;
- garanci bankare për pjesëmarrje në shpalljen publike në shumë të qirasë së ofruar nëntëmujore dhe
- dëshmi për pajisje materiale – teknike (leje qarkullimi, fatura, marrëveshje për shitblerje, të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt i ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet themelor për përpunimin e tokës bujqësore (marrëveshje prë lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).

Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të jetë e plotësuar tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme <u>në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.</u>

Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se:
- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;
- janë dorëzuar pas afatit të caktuar për tu dorëzuar;
- janë të dorëzuara në zarf të shënuar me të cilin do të mundej të identifikohet ofertuesi;
- janë të parashtruara nga personi që nuk ka të drejtë të parashtrojë oferta dhe
- nuk janë hartuar sipas kushteve të caktuara në thirrjen publike **komisioni i hedhë si të pakompletuara.**

Ofertat për tokën bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën me detyrë administrative Komisioni do të vërtetojë se nuk janë kryer obligimet nga marrëveshjet e lidhura më herët, Komisioni do ti hedhë si **të palëshuara.**
Ofertat për tokë bujqësore në pronësi të shtetit për të cilat Komisioni do të vërtetojë se një ofertues ka dorëzuar më shumë se një ofertë, Komisioni do ti hedhë si **të palëshuara.**
Oferta e cila do të dorëzohet me qira më të ulët të ofruar se qiraja minimale e përcaktuar në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë si **të palëshuar.**
Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit në lidhje me thirrjen publike nuk do të shqyrtohen ndërsa ofertuesit do të informohen për pakompletësinë në mënyrë elektronike në **e-mail adresën** e dorëzuar.
Kushtet e parapara në biznes planin (për personat juridik), respektivisht aspektet e tregut të parapara në program (te personat fizik) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime kontraktuale të cilat obligohet ti përmbush në vëllimin, afatet dhe mënyrën se si do të jenë të përshkruara në shpalljen publike.

III. KRITERET PËR ZGJEDHJE TË OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM
Komisioni kryen zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm në bazë të nenit 4 të Rregullores për kriteret më të përafërta për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund të jepet me qira dhe përcaktim të madhësisë së sipërfaqes së tokës bujqësore që mund të jepet me qira (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/08, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15, 129/15 dhe 27/16).
Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën mund të parashtrohet fletëparaqitje dhe e cila mund ti jepet me qira një pjesëmarrësi, përcaktohet në bazë të pajisjes minimale materiale-teknike të ofertuesit dhe numrin e të punësuarve të planifikuar gjegjësisht të punëtorëve sipas biznes planit edhe atë:
- për sipërfaqe deri në 50 ha – së paku 1 traktor të kategorisë së lehtë (deri në 80kv) dhe së paku një të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-3a për sipërfaqe deri më 100ha – së paku 2 traktorë të kategorisë së lehtë (deri në 80kv) ose së paku 1 të kategorisë së mesme (prej 80 deri në 120kv) dhe së paku 2 të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-për sipërfaqe deri më 150ha – së paku 4 traktorë të kategorisë së lehtë (deri 80kv) ose së paku 2 të kategorisë së mese ose së paku 1 të kategorisë së rëndë (mbi 120kv) dhe së paku 4 të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;
-për sipërfaqe mbi 150 hektarë, numri/kapaciteti i mekanizmit të rritet proporcionalisht me madhësinë e sipërfaqes e cila do të punohet dhe në çdo 50 hektarë të planifikohet nga një punëtor në marrëdhënie të rregullt pune.

IV. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË
Në shpalljen publike secili ofertues mund të parashtrojë vetëm një formular (ofertë) në origjinal, ndërsa mund të aplikojë për një, dy, tri ose më shumë tërësi gjeografike dhe rajone.

V. GARANCIA BANKARE PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË
Garanci bankare për pjesëmarrje në procedurë do të duhet të dorëzojnë të gjithë ofertuesit në shpallje edhe atë së bashku me fletëparaqitjen.
Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë duhet të jetë **e pakushtëzuar, e pakthyeshme dhe e pagueshme** në thirrjen e parë me afat prej 120 ditëve duke llogaritur nga dita e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpallje publike.
Garancia bankare duhet të jepet nga banka me seli në Republikën e Maqedonisë.
Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë ofertuesit të zgjedhur do t'i kthehet pasi të nënshkruajë marrëveshjen dhe do të dorëzojë garanci bankare për për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes.
Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë paguhet nëse:
- ofertuesi i zgjedhur refuzon të nënshkruajë marrëveshjen në pajtim me kushtet e shpalljes publike ose nënshkrimin e marrëveshjes e kushtëzon me ndryshime ose plotësime që nuk parashihen në shpallje,
- pjesëmarrësi gjatë procedurës tërheqë ofertën ose
- ofertuesi i zgjedhur nuk dorëzon garanci bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes.

Garancia bankare për pjesëmarrje në procedurë në rast të aktivizimit paguhet në:
- llogarinë trezore të Republikës së Maqedonisë;
-banka e pranuesit: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;
-llogaria: 100000000063095;
-llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 630010001963019;
-shifra e të hyrave: 725933 (Të hyrat nga garancitë e aktivizuara bankare).

VI. MËNYRA DHE PROCEDURA E REALIZIMIT TË ANKANDIT PUBLIK
Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm në procedurën sipas shpalljes publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik, realizohet në bazë të qirasë më të lartë të ofruar vjetore për hektar për tërësinë gjeografike të arritur përmes ankandit publik elektronik.
Procedura për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqet mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik mund të realizohet edhe nëse në të ka marrë pjesë edhe një ofertues dhe ofron shumën mbi çmimin fillestar.
Shuma fillestare e ankandit publik elektronik është në shumë të çmimit fillestar për një tërësi gjeografike të caktuar në vet shpalljen publike.
Komisioni për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit përmes ankandit publik elektronik në afat prej tre ditëve pas kalimit ë afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve, përmes formës elektronike informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në shpalljen publike për kompletimin dhe përkatësinë e fletëparaqitjes në pajtim me kushtet nga shpallja publike, gjatë së cilave ofertuesve që kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar dhe përkatëse u dorëzon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa ofertuesve të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të pakompletuar ose jopërkatëse u dërgon lajmërim se të njëjtat nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
Ofertuesit të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të kompletuar dhe përkatëse, në ditën e ankandit publik, regjistrohen në internet faqen e shënuar në shpallje me emrin përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, pas së cilës kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.
Ofertuesit së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë edhe **e-mail adresën** e tyre në të cilën do të informohen nga ana e Komisionit për datën dhe orën e fillimit të ankandit publik elektronik.
Regjistrimin në ankandin publik elektronik ofertuesit e bëjnë në
http://62.220.210.66:8080/auction.
Ankandi publik elektronik fillon me publikimin e çmimit fillestar për hektar të tokës bujqësore lëndë për qira, ndërsa realizohet pëmes ankandit nga ana e pjesëmarrësve në ankandin publik.
Për procedurën e realizuar me sukses të ankandit publik është e nevojshme të ketë së paku një licitacion në nivel jo më të ulët se 5% e çmimit të përcaktuar fillestar të qirasë vjetore mbi çmimin fillestar për hektar.
Ankandi publik nuk guxon të zgjasë më shkurt se 15 minuta. Ankandi publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit ë kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për zgjatje të ankandit publik, nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë e re, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën e ardhshme prej dy minutave nuk jepet ofertë e re.
Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re jo më të ulët se 5% të ofertës së fundit të dorëzuar.
Komisioni për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit përmes ankandit publik elektronik pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik dhe në mënyrë elektronik e dorëzon deri tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik.
Ofertuesi i zgjedhur më i volitshëm është personi pjesëmarrës në ankandin publik elektronik i cili ka ofruar çmimin e fundit dhe që është edhe çmimi më i lartë i arritur për hektar të ofruar në ankandin publik elektronik.
Procedura për ankandin publik përfundon pas kalimit të afatit për parashtrim të ankesës nëse nuk është parashtruar asnjë ankesë gjegjësisht deri në sjelljen e vendimit në lidhje me ankesën nëse nuk është parashtruar ankesë kundër vendimit, ndërsa nëse është parashtruar ankesë kundër vendimit, pas plotfuqishmërisë së vendimit.
Pas plotfuqishmërisë së vendimit në afat prej 30 ditëve ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave me ofertuesin e zgjedhur më të volitshëm do të lidhë marrëveshje për qira të tokës bujqësore, i cili në afat prej 15 ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes është i obliguar të dorëzojë Garanci bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të obligimeve nga marrëveshja që duhet të jetë e pakushtëzuar, e pakthyeshme dhe e pagueshme në ftesë të parë në shumë prej qirasë nëntëmujore dhe është 5% të investimeve të planifikuara në ofertën e ofertuesit të zgjedhur, por jo më pak se shuma e qirasë nëntëmujore. Garancia bankare për realizim kualitativ dhe në kohë të marrëveshjes duhet të jetë valide për tërë periudhën të kohëzgjatjes së marrëveshjes, ndërsa do të rinovohet në çdo tre vjet.
Ofertuesi më i volitshëm me të cilin lidhet marrëveshja për qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit është i obliguar qiranë ta paguajë deri më 31 korrik të vitit aktual për vitin e kaluar, duke llogaritur nga dita e futjes përmes procesverbalit në posedim të tokës bujqësore lëndë e marrëveshjes.
Marrëveshja për qira e lidhur me ofertuesin e zgjedhur të volitshëm futet në fuqi me ditën e futjes së pronësisë së qiramarrësit ndaj tokës bujqësore lëndë e marrëveshjes nga ana e qiradhënësit edhe atë vetëm për sipërfaqet për të cilët është futur në pronësi faktike.

VII. ÇMIMI FILLESTAR
Çmimi fillestar për hektar në procedurë të kësaj shpallje publike përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës. Çmimi fillestar për tokën bujqësore prej:
- klasës katastrale I dhe II është 120 euro,
- klasës katastrale III dhe IV është 90 euro,
- klasës katastrale V dhe VI është 60 euro dhe

klasës katastrale VII dhe VIII është 30 euro, në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë të paguar në ditën e pagesës.
Nëse toka bujqësore gjendet mbi 1000 lartësi mbidetare çmimi fillestar i qirasë për tokën bujqësore prej:
- klasës katastrale I dhe II është 60 euro,
- klasës katastrale III dhe IV është 45 euro,
- klasës katastrale V dhe VI është 30 euro dhe

klasës katastrale VII dhe VIII është 15 euro, në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë të paguar në ditën e pagesës.
Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi gjeografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë gjeografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

VIII. DORËZIMI I OFERTËS
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) mund të merret në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Njësitë periferike të Ministrisë dhe në ueb faqen e Ministrisë, dhe i njëjti duhet të plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të parashtrohet me dokumentacionin e nevojshëm në zarf të mbyllur, në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.
Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur në të cilin në këndin e epërm të majtë duhet të qëndrojë shenja *"mos hap"* **-** *"Ofertë e shpalljes publike nr. 02/18 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqet mbi 3 hektarë dhe përmes ankandit publik elektronik për rajonin (shkruhet rajoni/tërësia gjeografike)* dhe në mes "**Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup**" në afat prej 60 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë tjetër me të cilën do të mund të identifikohet ofertuesi, gjegjësisht dërguesi.
Ofertat e dorëzuara sipas kësaj shpallje publike nr. 02/18 do të hapen publikisht në ditën e parë duke llogaritur nga dita e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.
Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të mbledhjeve në Ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2, Shkup me fillim në ora 10.

IX. INFORMATAT PLOTËSUESE
Për informatat plotësuese ofertuesit mund të drejtohen deri në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në numrin e telefonit: **02 313 44 77** ose të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk

MINISTËR,
Lupço Nikollovski

Në bazë të Programit për aktivitete në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit, për vitin 2018 (Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit nr. 1/18 të datës 01 shkurt 2018), Kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve dhe projekteve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit

për vitin 2018

I

Për realizimin e nevojave publike në fushën e sportit, Qyteti i Shkupit shpall Thirrje publike për financimin programeve dhe projekteve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018.

Aktivitetet sportive, programet dhe manifestimet dhe mjetet financiare për realizimin e tyre, Qyteti i Shkupit i përcakton me program vjetor gjë me të cilën pasqyrohet interesi dhe nevojat në këtë sferë.

Programet dhe projektet duhet të sigurojnë zhvillim, stimulim dhe prezantim të vlerave dhe arritjeve sportive në fushën e sportit në nivel të qytetit të Shkupit.

Mjetet për financimin e programeve dhe projekteve do të sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

Në përputhje me dispozitat dhe kriteret ligjore për përcaktimin e programit për sport dhe për sigurimin e mjeteve për realizimin e tyre, si dhe mbi bazë të vlerësimeve për programet e realizuara në vitin 2017, Qyteti i Shkupit me Programin për aktivitetet nga fusha e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2018, me katër (4) pikat e mëposhtme të Programit, do t'i përkrahë:

1. MANIFESTIME SPORTIVE TRADICIONALE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë evenimentet dhe manifestimet sportive tradicionale të karakterit lokal, regjional, nacional dhe ndërkombëtar, me qëllim ruajtjen e kontinuitetit të këtyre manifestimeve për të cilat ka interes nga ana e qytetarëve dhe të cilat janë në interes të zhvillimit të sportit në qytetin e Shkupit, me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, të shpërndara organizatorit (Federata kombëtare sportive anëtare e Federatës kombëtare sportive dhe subjekte të tjera sportive).

Vetë emri manifestime sportive tradicionale tregon se Qyteti i Shkupit do të financojë manifestime me të cilat kanë traditë së paku pesë vjet dhe që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në zhvillimin e sportit në qytetin e Shkupit.

2. MANIFESTIME ME INTERES TË VEÇANTË PËR QYTETIN E SHKUPIT

Në fushën e manifestimeve me interes të veçantë, Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet e të gjitha subjekteve të interesuara sportive të cilat do të deponojnë programe dhe projekte për organizimin e manifestimeve dhe evenimenteve sportive me interes të veçantë për Qytetin e Shkupit.

Qyteti i Shkupit nëpërmjet përkrahjes së evenimenteve të tilla sportive dëshiron të tregojë se është i aftë të organizojë edhe manifestime ndërkombëtare të rangut më të lartë. Qyteti i Shkupit gjithmonë do të përkrahë manifestime sportive të cilat në të ardhmen do të kontribuojnë për popullarizimin e sportit dhe përfaqësimin e denjë të mundësive dhe potencialeve të Qytetit të Shkupit për organizimin e këtij lloji të manifestimeve.

3. PËRKRAHJA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË TJERA SPORTIVE ME INTERES PËR QYTETIN E SHKUPIT

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet për realizimin e programeve të veçanta për krijimin e kushteve për realizimin e aktiviteteve sportive të sportistëve – amatorë, të nxënësve dhe të rinjve, me theks të veçantë në realizimin e aktiviteteve sportive dhe garave të nxënësve në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Mundësimi i komunikimit më intensiv të sportistëve dhe sportisteve dhe shoqatave të tyre me sportistët dhe sportistet nga qytetet e binjakëzuara, kryeqytetet dhe qendrat e mëdha urbane në rajon dhe në botë, me qëllim avancimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë.

Qyteti i Shkupit do të përkrahë edhe programe, projekte dhe aktivitete për sport rekreativ masiv të qytetarëve të Shkupit, aktivitetet sportive-rekreative të personave me nevoja të posaçme në territorin e qytetit të Shkupit, si dhe programe, projekte dhe aktivitete për sporte urbane ekstreme në Shkup.

4. PROGRAME DHE PROJEKTE PLOTËSUESE NË SPORTE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet, aktivitetet dhe manifestimet që nuk janë të përfshira me pozicionet e mëparshme të tre pikave të lartpërmendura, dhe të cilat me aktualitetin, atraktivitetin, rëndësinë dhe cilësinë e tyre, kontribuojnë për realizimin e qëllimeve programore në fushën e sportit të Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

II

Programet dhe projektet e propozuara, projektet, aktivitetet dhe manifestimet, përveç arsyetimit duhet të përmbajnë edhe propozim-konstruksionin buxhetor, në të cilin do të theksohen mjetet që kërkohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, si dhe mjetet e siguruara nga Agjencia për të rinj dhe sport e Republikës së Maqedonisë, të ardhura të veta dhe mjete nga burime të tjera.

III

Përveç fushave të theksuara, fletëparaqitjet e deponuara duhet të plotësojnë qëllimet dhe kriteret të cilat janë dhënë të bashkëngjitura në Thirrjen publike, e cila është shpallur në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

IV

Në procedurën për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit, për vitin 2018, do të pranohen ato programe dhe projekte, aktivitete programore dhe manifestime, që në bazë të kritereve do të sigurojnë më së paku 55 pikë.

V

Paraqitja në Thirrjen publike kryhet me deponimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikacioni). Aplikuesit, përveç fletëparaqitjes, në mënyrë të detyrueshme duhet të dorëzojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- aktvendim për regjistrim në regjistër dhe gjendjen vijuese për regjistrimin e veprimtarisë jo më të vjetër se gjashtë muaj, të lëshuar nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ;
- vërtetim për xhiro llogari të hapur dhe aktive dhe
- në varësi të statusit të aplikuesit, të deponohet Aktvendim për kryerjen e veprimtarisë sport, të lëshuar nga Agjencia për të rinj dhe sport e Republikës së Maqedonisë.

VI

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim programet dhe projektet, aktivitetet programore dhe manifestimet, me konstruksionin financiar, duhet të deponohen në fletëparaqitje të veçantë që mund të merret nga Arkivi i Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike zgjat gjithsej **15 ditë**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Thirrja publike shpallet më **07.02.2018** dhe do të zgjasë deri më **21.02.2018**.

Fletëparaqitjet duhet të deponohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" numër 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më datën 21.02.2018 deri në orën 15:00 në ditën e fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me emërtim: për "**Thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018".**

Fletëparaqitjet deponohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shenja të subjektit i cili deponon fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta të cilat nuk janë dorëzuar në mënyrën që kërkohet në tekstin e mësipërm, pikërisht ato me të dhëna të paplota dhe dokumentacion të pakompletuar, si dhe ato që nuk do të dorëzohen në afatin e parashikuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merren në tel:
02/ 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT

Konkurs shpërblyes për dizajn të logotipit të Asociacionit të Mediave të Evropës Juglindore (AMEJL)

Për konkursin

Gjashtë shtëpi kryesore mediatike të Evropës Juglindore, Oslobođenje (Sarajevë), AMG (Beograd), Koha (Prishtinë), Sloboden Peçat (Shkup), Koha (Shkup) dhe Vijesti (Podgoricë) në një takim para pak kohës në Podgoricë kanë themeluar asociacionin rajonal të mediave. Aktivitetet dhe qëllimet kryesore të asociacionit janë bashkëpunimi dhe mbështetja e ndërsjellë, trajnim i përbashkët të të punësuarve, këmbim të përmbajtjeve, qasja e koordinuar ndaj organeve dhe organizatave shtetërore dhe ndërkombëtare me qëllim të avancimit të kualitetit të gazetarisë dhe përmirësimit të kushteve dhe pozitës së mediave në treg.

Emri i plotë i Asociacionit në gjuhën malaziase/boshnjake/serbe është Medijska asocijacija Jugoistočne Evrope **(MAJE),** në gjuhën shqipe - Asociacioni i Mediave të Evropës Juglindore **(AMEJL)**, në gjuhën maqedonase - Asocijacija na mediumite na jugoistocna Evropa **(AMJE)**, në gjuhën angleze - Media Association of South-East Europe **(MASE)**. Asociacioni do të regjistrohet si shoqatë joqeveritare me seli në Podgoricë.

Organizator i konkursit është Misioni i OSBE-së në Mal të Zi në bashkëpunim me Asociacionin e Mediave të Evropës Juglindore (AMEJL).

Detyra e konkursit është krijimi i zgjidhjes grafike origjinale për logotip, i aplikueshëm për format të madh dhe të vogël, të mediave të shtypit dhe atyre elektronike pa kufizime në motive, por me përdorimin e akronimit të emrit të plotë të asociacionit në gjuhët lartpërmendura (MAJE, AMEJL, AMJE, MASE).

Qëllimi i konkursit është angazhimi i nxënësve dhe studentëve të shkollave dhe fakulteteve të dizajnit, si dhe të dizajnerëve të rinj të interesuar për të krijuar zgjidhje për logotipin të cilën do ta përdorë Asociacioni i Mediave të Evropës Juglindore.

Mundësi për pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë nxënësit e moshës së rritur të vitit të fundit të shkollës së mesme dhe studentët e fakultetit, si dhe të rinjtë e specializuar për dizajn grafik, të cilët më së voni deri më datë 01.03.2018. parashtrojnë:

- Biografi të shkurtë;
- Punim në formë elektronike;
- Deklaratë në lidhje me autenticitetin e zgjidhjes grafike për logotip.

Kohëzgjatja e konkursit është paraparë prej 07.02.2018 deri më 01.03.2018.

Komisioni profesional për vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve do të jetë i përbërë nga përfaqësues të Misionit të OSBE-së në Mal të Zi dhe Asociacionit të Mediave të Evropës Juglindore.

Kriteri për zgjidhje të punimit më të suksesshëm është origjinaliteti dhe inovacioni. Inkurajojmë pjesëmarrësit në konkurs që vet të prezantojnë zgjidhjet dhe idetë e tyre që do të simbolizojnë mediat, qëllimet dhe parimet e asociacionit.

Kur bëhet fjalë për kreativitet dhe detaje, pjesëmarrësit kanë të drejtë absolute, por mund të ju ndihmojmë dhe t'u themi se kemi dëshirë të ketë ngjyra që shprehin lumturi dhe gjallëri, dizajn modern, i cili në mënyrë të përsosur do të përshtatej në ueb portalin e asociacionit dhe faqet zyrtare të rrjeteve sociale, si dhe në të gjitha materialet e shtypura dhe promovuese.

- Logotipi duhet të jetë vepër origjinale e autorit dhe nuk duhet të përmbajë pjesë të asnjë vepre të ndonjë autori tjetër;
- Logotipi duhet të përmbajë akronimet e emrit të plotë të asociacionit (MAJE, AMEJL, AMJE, MASE);
- Logotipi duhet të ketë mundësinë e kalitjes në format të madh (afishe, pano...) deri në ato të voglat (flaer, material të shtypur...);
- Duhet të jetë po aq ekspresiv, si në ngjyra ashtu edhe në grayscale;
- Punimi konkurrues duhet të dorëzohet në JPEG, PDF ose TIFF format me rezolucion të madh (300 dpi);
- Të dhënat e autorit duhet të përmbajnë: emrin dhe mbiemrin, e-mail adresë, numër të telefonit dhe biografi të shkurtë;
- Me parashtrimin e punimit pjesëmarrësit pranojnë të gjitha kushtet e konkursit.

Dokumentet dhe punimet të dorëzohen në e-mail adresën: info@masee.org

Autori i zgjidhjes fituese do të paguhet me honorar në shumë prej 500 euro pas vendimit përfundimtar të jurisë profesionale dhe harmonizimit të specifikimeve teknike

---

Republika e Maqedonisë

AGJENCIA PËR KADASTËR TË PATUNDSHMËRIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për kadastër të patundshmërive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2013, 41/2014, 115/2014, 116/2015, 153/2015, 192/2015, 61/2016 dhe 172/2016) dhe Vendimit për publikim të Shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive numër 02-4079/1 të datës 05.02.2018, Këshilli drejtues i Agjencisë për kadastër të patundshmërive, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Nr. 01/2018

Për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive

I. Këshilli drejtues i Agjencisë për kadastër të patundshmërive publikon Shpallje publike për zgjedhje të:

1. **Drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive**.

II. Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike ka personi fizik i cili krahas kushteve të përgjithshme përmbushë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për kadastër të patundshmërive edhe atë:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
2. Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
3. Ka arritur 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar;
4. Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
5. të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë:
   - TOEFL-IBT – së paku 74 pikë,
   - IELTS – së paku 6 pikë,
   - ILEC Cambridge English: legal, së paku niveli B2,
   - FCE Cambridge-English: first – të dhënë,
   - BULATS – së paku 60 pikë;
   - APTIS – së paku niveli B2 dhe
6. të ketë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

III. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët patjetër duhet të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Biografi të shkurtë;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- diplomë për arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar;
- Dëshmi se ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL-IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: legal, së paku niveli B2, FCE Cambridge-English: first – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë; APTIS – së paku niveli B2 dhe
- Dëshmi për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

IV. Dokumentet nga pika III duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat të dorëzohen në arkivin e Agjencisë për kadastër të patundshmërive ose përmes postës në adresën: Agjencia për kadastër të patundshmërive rr. "Trifun Haxhi Janev" nr. 4, 1000 Shkup me shenjë: "Për shpallje publike për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive".

Orari i punës është 40 (dyzet) orë në javë, gjegjësisht 8 (tetë) orë në ditë gjatë javës së punës, prej ora 7.30/8.30 deri në ora 15.30/16.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte – orar të plotë të punës.

V. Koeficienti i pagesës për drejtor të Agjencisë për kadastër të patundshmërive është 3.3 në pajtim me Vendimin për përcaktimin e koeficienteve për përllogaritje të pagesës të funksionarëve të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RSM" nr. 36/90 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005, 71/2005, 2/2006, 8/2006, 46/2006, 18/2007, 94/2007, 103/2007, 126/2007, 138/2007, 39/2008, 137/2008, 154/2008, 63/2009, 76/2009, 144/2009, 39/2010, 63/2010, 158/2010, 5/2011, 75/2011, 133/2011, 70/2012, 82/2012, 161/2012, 172/2013, 16/2014, 21/2014, 99/2014, 116/2014, 152/2015, 161/2015, 218/2015, 19/2016, 71/2016 dhe 89/2016).

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Dejan Ampev

NJË JAVË PARA SE TË FILLOJË SEZONI PRANVEROR NË LPFM-SË

INSPEKTOHEN STADIUMI NË ÇAIR DHE AUTOKOMANDË

Në fakt ky komision do të inspektojë kushtet e fushave sportive në Çair dhe Autokomandë dhe do të japë vendimin final se këto dy stadiume i plotësojnë apo jo kushtet që në pranverë të zhvillohen ndeshjet e elitës së futbollit vendor

Shkup, 6 shkurt - Një javë para se të nis sezoni pranveror në elitën e futbollit vendor skuadra e F.C. Shkupi dhe ajo e KF "Skopje" janë në pritje të raportit përfundimtar të Komisionit të infrastrukturës pranë Federatës Futbollistike të Maqedonisë. Në fakt ky komision do të inspektojë kushtet e fushave sportive në Çair dhe Autokomandë dhe do të japë vendimin final se këto dy stadiume i plotësojnë apo jo kushtet që në pranverë të zhvillohen ndeshjet e elitës së futbollit vendor. Nga FFM për "Alsat-M", thanë se komisioni në fjalë është në terren. "Komisioni i infrastrukturës sot dhe nesër do inspektojë stadiumet në Çair dhe Autokomandë. Në saje të raportit të tyre Komisioni i garave do merr vendimin përfundim se në Çair dhe Autokomandë do të luhet apo jo futboll elitar", thonë nga FFM-ja. Jo zyrtarisht thuhet se stadiumi në Çair dhe ai në Autokomandë, deri në nisjen e sezonit pranveror më 14 shkurt do të duhet të eliminojnë mangësi në infrastrukturë. Komisioni i garave pranë FFM-së, më së voni deri të premten do të duhet të përcaktojë fushat në të cilat do të luhen ndeshjet e para të sezonit pranveror. Kujtojmë, për shkak të dëmtimit të fushës në vjeshtë skuadra e F.C. Shkupi u detyrua që ndeshjen e kthimit të Kupës së Maqedonisë me Vardarin ta luante në lagjen Gjorçe Petrov. Ndërkohë, me 14 shkurt kur edhe fillon sezoni pranveror, F.C. Shkupi është paraparë që në Çair të pret skuadrën e Akademija Pandev, ndërsa "Skopje" do të jetë mysafir i Sileksit në Kratovë. Të gjitha ndeshjet fillojnë në ora 14.00.

Debuton Aliji, por e nis me humbje

Naser Aliji debuton me ekipin e ri. Entela priste Specian dhe 24-vjeçari i kombëtares ka zhvilluar minutat e para në Serinë B. Ai ka hyrë si zëvëndësues në 60', por pa arritur të shmangë humbjen e Entelës. Vendosi një gol i Maggiores, katër minuta para aktivizimit të Alijit. Entela rrezikon pasi mban vendin e 19-të me 29 pikë. Për momentin, ekipi i kumanovarit është në zonën e "play-out". Javën tjetër Entela udhëton në trasfertën e Ternanës për të luftuar për rezultat pozitiv, ndërsa mbrojtësi për të marrë edhe më shumë minuta.

Më pëlqejnë sfidat e vështira

Ergys Kaçe, në përfundim të ndeshjes së kësaj fundjave me Panetolikos, ka hedhur dritë edhe mbi vendimin që ai mori përtë kaluar si huazim tek Panatinaikosi. "E vërteta është se nuk jam aktivizuar shumë gjatë kësaj periudhe, për rreth 2 muaj e gjysmë. Ndeshjen e fundit e kisha luajtur me Kombëtaren. Mendoj se tani do përmirësohem akoma më shumë edhe nga ana fizike. Si unë, ashtu dhe PAOK-u dëshironim që të vija tek Panathinaikosi. E di që ky klub është në gjendje të vështirë dhe mua më pëlqejnë skuadrat që janë në situata të vështira, dhe kështu që vendosa të vij tek Panathinaikosi. Është një skuadër e madhe" – deklaroi Kaçe.

Uldedaj mposht çekun Synek, fiton titullin e parë të karrierës

Boksieri Jurgen Uldedaj ka korrur suksesin e tetë si profesionist, duke mundur me vendim unanim të gjyqtarëve çekun Jakub Synek, sfidë që u zhvillua në Halle të Gjermanisë, duel që i dha boksierit lezhian edhe titullin e parë në karrierë, atë të "German International Cruiserweight". Për 20-vjeçarin një përballje e vështirë, e para me 10 raunde, por Uldedaj nuk zhgënjeu, duke e dominuar sfidën dhe merituar fitoren. Rivali i tij çek është një boksier me prëvojë, 33 vjeç, që s'kishte asnjë humbje në karrierën e tij dhe ndaj Uldedaj pësoi disfatën e parë. Pas duelit, Jurgen Uldedaj tha: "Dua të falënderoj klubin SES Boxing dhe trajnerin Dirk Dzemski për punën që kanë bërë me mua dhe mundësitë që më kanë dhënë, duke u munduar t'ua shpërblej me fitore dhe të shpalos vlerat e mia. Kishte shumë shqiptarë që më kanë mbështetur dhe i falënderoj. Ky është titulli i parë në karrierën time, duke shpresuar që kjo sfidë t'i hapë rrugën edhe trofeve të tjera, një sukses që më jep mbështetje për të ardhmen", deklaroi pas fitimit të titullin boksieri shqiptar Jurgen Uldedaj, që duelon në peshën "cruiserweight".

Cuculi ka qenë afër kalimit te Benevento

Shkup, 6 shkurt - Ardian Cuculi ishte shumë pranë kalimit tek Benevento në këtë merkato janari, por gjithçka është ndaluar vetëm në momentet e fundit bën të ditur panorama-sport, transmeton gazeta KOHA. Ka qenë Federata Italiane ajo që ka bllokuar transferimin, pasi ekipi ku aktivizohen edhe Memushaj e Gjimshiti, e ka plotësuar numrin e ekstrakomunitarëve në ekip. Ishmbrojtësi i Partizanit do të bënte kështu hapin e madh në karrierë, por fakti që nuk ka një pasaportë nga një vend anëtar i Bashkimit Europian e ka ndaluar.

Republika e Maqedonisë
Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës s Maqedonisë" nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë më herët nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 01/18 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/18), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/18
Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektar

I. LËNDË E SHPALLJES PUBLIKE
Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **843 ha 73 ar 53 m^2** edhe atë për rajonet në vijim në Republikën e Maqedonisë:

Nr. rend	Rajoni	Ha	Ar	m^2
1	Negotinë	5	80	77
2	Berovë	163	32	84
3	Probishtip	98	04	59
4	Kisella Vodë	56	09	18
5	Kërçovë	21	87	25
6	Prilep	498	58	90
GJITHSEJ		**843**	**73**	**53**

Të dhënat për tokën bujqësore nga kjo shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përmbajtura në listën pronësore) janë në pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilën sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësinë periferike të Ministrisë ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.
Toka bujqësore në pronësi të shtetit e cila jepet me qira me këtë shpallje publike është me qëllim të:
-ngritje të mbjellave shumëvjeçare (vreshta, pemishte, hmel) dhe oranzheri për periudhë deri në 30 vjet,
- ngritje të mbjellave shumëvjeçare me lajthi për periudhë deri në 70 vjet,
-ngritje të ullishtave për periudhë deri në 50 vjet,
- kultivimit të kulturave të tjera bujqësore për periudhë deri më 15 vjet,
-livadhe për periudhë deri në 15 vjet,
-për kultivimin e drujve që rriten shpejtë në tokën bujqësore që gjendet në lartësi mbidetare mbi 700 metra, për periudhë deri në 30 vjet,
-basene të peshqve deri në 20 vjet dhe
-aktivitete sportive-rekreative dhe turizëm rural deri në 30 vjet.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE
Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.
Subjektet fizike duhet të jenë realizues të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.
Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.
Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore tu jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.
Personat e lidhur në kuptim si persona të lidhur juridikisht, persona fizik të lidhur, person i lidhur fizik me person juridik dhe indirekt persona të lidhur në person juridik kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike dhe mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për pjesëmarrje.
Të drejtë pjesëmarrjeje në shpalljen publike kanë personat të cilat nuk kanë të lidhur asnjë marrëveshje ekzistuese për qira marrje me Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.
Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.

III. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE
Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënien me e tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira të hapësirave deri në 3 hektarë në shoqërim të fletëparaqitjes duhet të dorëzojnë:
a) për subjektet juridike:
- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);
- dëshmi (akt) të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik;
-dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
-dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për punimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter);
- vërtetim nga Njësia periferike e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;
-deklaratë të dhënë me gjithë përgjegjësinë materiale dhe penale se oferta bëhet e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe që është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për tokë bujqësore, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave juridik, persona të lidhur fizik, person fizik i lidhur me person juridik ose indirekt persona të lidhur në subjekt juridik;
- deklaratë të vërtetuar në noter për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në fletëparaqitjen për pjesëmarrje;
- biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin e të punësuarve, aspektet e tregut, pritshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose nga personi i autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizimit të vërtetuar në noter);
-deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përmbushur obligimet nga ajo marrëveshje.
b) për personat fizik:
- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);
-dëshmi se janë paguar obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontributeve në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim të detyrueshëm social;
- dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për punimin e tokës bujqësore (marrëveshje për lizing ose marrëveshje për shërbim të vërtetuar në noter).
- fotokopje të letërnjoftimit;
- vërtetim për regjistrim në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore, vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga regjistri qendror për regjistrim si tregtar i vetëm;
- program për shfrytëzimin e tokës e cila përmban të dhëna bazë për familjen, pajisjen tekniko-teknologjike, qëllimi për të cilin shfrytëzohet toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);
- deklaratë për besueshmëri të të dhënave të paraqitura me fletëparaqitjen e vërtetuar në noter;
- vërtetim nga Njësia rajonale e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;
-deklaratë të dhënë për përgjegjësi materiale dhe penale se oferta paraqitet si e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe e cila është në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave të lidhur juridik, personave të lidhur fizik, person fizik me person juridik ose indirekt persona të lidhur në person juridik dhe
-deklaratë të vërtetuar në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës në personin juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe e cila nuk i ka plotësuar detyrimit nga ajo marrëveshje.
Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të plotësohet tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme, në të kundërtën oferta **nuk do të merret parasysh**.

IV. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTUESUT MË TË VOLITSHËM
Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm në procedurë të shpalljes publike për dhënien e tokës bujqësore në pronësi të shtetit deri në 3 hektarë, bëhet në përputhshmëri me Rregulloren për kriteret më të afërta për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit e cila mund të jepet me qira dhe përcaktim të madhësisë së hapësirës së tokës bujqësore e cila mund të jepet me qira ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/08, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15 dhe 129/15), edhe atë në bazë të kritereve vijuese:
- largësia nga vendbanimi, respektivisht qëndrimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike– 65 pikë.
- qiramarrja e ofruar vjetore për hektar– 25 pikë.
- statusi juridik i ofertuesit– 10 pikë.
Kriteri largësi nga vendi i jetesës, respektivisht vendbanimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike do të thotë se largësia nga vendi i jetesës, respektivisht selia e ofertuesit në raport me parcelën kadastrale që shpallet ndodhet në komunë të njëjtë kadastrale dhe notohet me numër maksimal të pikëve. Nëse ofertues është njësi e e ndonjë personi vendor juridik merret parasysh qëndrimi i personit juridik i cili e ka themeluar filialin.
Kriteri qiramarrja e ofruar vjetore për hektar vlerësohet në bazë të formulës– qiramarrja e ofruar vjetore për hektar e ndarë me qiramarrjen më të madhe vjetore për hektar, të shumëzuar me numër maksimal të pikëve që mund të fitohen në bazë të këtij kriteri ku:
S=(P/Pmaks) x 25
S – numri i pikëve
P – qiraja e ofruar
Pmaks – qiraja më e lartë e ofruar
Kriteri statusi juridik i ofertuesit fitohet me numër maksimal të pikëve për ofertues që është kryerës i regjistruar i veprimtarisë bujqësore ose i siguruar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor si bujk individual, tregtar individual ose subjekte juridike që përmbushin kushtet nga neni 24 i Ligjit për tokë bujqësore.
Sipërfaqja maksimale për të cilën mund të aplikojë një ofertues nuk mund të jetë më e madhe se 3 hektarë, as më e vogël madhësia e një parcele katastrale gjegjësisht blloku.

V. ÇMIMI FILLESTAR
Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës.
Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike për sipërfaqe deri në 3 hektar është 25 euro në kundërvlerë denar për tokën bujqësore të klasës katastrale prej I deri në IV dhe 15 euro në kundërvlerë denarë për tokën bujqësore të klasës katastrale prej V deri në VIII, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.
nëse toka bujqësore gjendet në rajonin malor, çmimi fillestar i tokës së klasës katastrale prej I deri në IV do të jetë 15 euro, ndërsa për tokën prej klasës V deri në VIII do të jetë 5 euro në kundërvlerë denarë, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.
Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi gjeografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë gjeografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

VI. FORMULARI PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE (OFERTA)
Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) mund të merret në Ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, njësitë rajonale të Ministrisë dhe nga ueb faqja e Ministrisë dhe i njëjti duhet të plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të dorëzohet me dokumentacionin e nevojshëm në zarf të mbyllur, në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohet.
Ofertat të cilat nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm, të dorëzuar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, ofertat të cilat dorëzohen pas skadimit të afatit për parashtrim, zarf të shënuar me të cilën do të mund të identifikohet ofertuesi, ofertat më të ulta nga shuma më të ulta të qirasë vjetore, parashtrohen nga persona që nuk kanë të drejtë të parashtrojnë oferta, si dhe ofertat e përpiluara jo në jo sipas kushteve të caktuara në shpalljen publike, hidhen si të pakompletuara.
Ofertuesi i cili nuk është i kënaqur nga zgjedhja realizuar në lidhje me shpalljen publike mund që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, të ngritë procedurë para gjykata e rregullt e autorizuar.
Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se:
- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;
- janë parashtruar pas kalimit të afatit për parashtrim;
- të parashtruara me zarf të shënuar me çka do të mund të identifikohet ofertuesi;
- janë parashtruar nga persona që nuk kanë të drejtë të parashtrojnë oferta dhe
- nuk janë përpiluar sipas kushteve të përcaktuara në shpalljen publike **komisioni do t'i hedhë si të pakompletuara**.
Oferta e cila do të parashtrohet me qira të ofruar më të ulët se qiraja minimale e përcaktuar me Ligj për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë **si të palejuar**.
Ofertat e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit në lidhke me thirrjen publike **nuk do të shqyrtohen**.
Kushtet e parapara në biznes plan (për subjektet juridike), gjegjësisht aspektet e tregut (tek subjektet fizike) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime të kontraktuara që do të jenët ë obliguar t'i përmbushë në kapacitetin, afatet dhe mënyrën që do të përshkruhen në shpalljen publike.
Secili ofertues mund të parashtrojë vetëm një ofertë origjinale për pjesëmarrje në shpalljen publike me dokumentacionin e nevojshëm nga pjesa II e kësaj shpallje publike.
Marrëveshja për qira të lidhur me ofertuesin e zgjedhur më të volitshëm futet në fuqi me ditën e futjes në pronësi të qiramarrësit mbi tokën bujqësore lëndë e marrëveshjes nga ana e qiradhënësit edhe atë vetëm për sipërfaqet për të cilat është dhënë në pronësi faktike.

VII. DORËZIMI I OFERTËS
Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm parashtrohen në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e epërme të majtë duhet të shënojë "*mos hap" "Ofertë në sipas Shpalljes publike 01/18 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqe deri në 3 hektarë sipas rajonit (shënohet rajoni)* dhe në **mes *"Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup"*** në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetat durore.
Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që do të mund të identifikojë ofertuesin, gjegjësisht dërguesin.
Ofertat e parashruara në lidhje me këtë shpallje publike nr. 01/18 do të hapen publikisht në ditën e tretë të punës duke konsideruar nga dita e fundit për parashtrim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.
Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të takimeve në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti" nr. 2 Shkup me fillim në ora 10.

VIII. INFORMATA PLOTËSUESE
Për informata plotësuese ofertuesit mund të kontaktojnë në Ministrinë e Bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në njësitë rajonale, të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk ose në Sektorin për regjistrim dhe menaxhim me tokë bujqësore në telefonin: **02 313 44 77**.

MINISTËR,
Lupço Nikollovski

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, ndërsa në lidhje me Vendimin për punësim të punëtorëve përmes shpalljes publike nr. 04-23/3 të datës 02.02.2018, SHA "Aeroportet e Maqedonisë" Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

I. Për nevojën për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar në SHA "Aeroportet e Maqedonisë" Shkup, për realizim të punëve për vendet e punës në vijim:

1. 01 (një) realizues për vendin e punës **Shef i kabinetit,**
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme: PSP të mbaruar, 2 vjet përvojë pune, njohje të gjuhës angleze, punë me kompjuter.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 39.297 denarë.

2. 01 (një) realizues për vendin e punës **Referent i pavarur për marketing,**
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme: PSP të mbaruar, 2 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 39.297 denarë.

3. 01 (një) realizues për vendin e punës **Referent i pavarur për kontroll të dokumentacionit për furnizim dhe shitje,**
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme: PSP të mbaruar, 2 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 39.297 denarë.

4. 01 (një) realizues për vendin e punës **Vozitës,**
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme: PMP të mbaruar, 1 vjet përvojë pune, leje të vozitjes të kategorisë B.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 32.204 denarë.

5. 01 (një) realizues për vendin e punës **Korrier],**
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme: PMP të mbaruar, leje të vozitjes të kategorisë B, pa përvojë pune.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës është 32.204 denarë.

II. Realizimi i detyrave të punës është me orar të plotë të punës - 40 orë në javë, 8 orë në ditë – orar administrativ fleksibil i punës.

III. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë (kopje), dëshmi për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter), dëshmi për përvojë të punës (listë nga SPIM), kontakt telefon.

IV. Afati për paraqitje është 05 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes.

V. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

VI. Fletëparaqitja së bashku me dokumentet të parashtrohet në arkiv ose përmes postës në adresën në vijim: SHA "Aeroportet e Maqedonisë" Shkup, rr. "Velko Vllahoviq" nr. 11 Shkup, Fahu P 413. Tel. 3217 666, Personi për kontakt: Mirjana Q. Dimoska.

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), SHF "Goce Dellçev" – Gostivar, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Mësimi në gjuhën maqedonase:

Një mësimdhënës të gjuhës angleze - në kohë të pacaktuar (zëvendësim për pushim të lindjes)
Personel ndihmës-teknik
Një higjien mbajtës në kohë të pacaktuar

Kushtet: Kandidatët për mësimdhënës të gjuhës angleze krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet ti përmbushin edhe kushtet për mësimdhënës në pajtim me nenin 80 pika 1 të Ligjit për arsim fillor. Orari ditor i punës për mësimdhënësit ndërrimi i parë fillon në ora 7,20, ndërsa përfundon në ora 12,40, ndërrimi i dytë fillon në ora 13,00 ndërsa përfundon në ora 18,25. Vlera e pagesës për mësimdhënës është 20.644 den. Dokumentet e nevojshme nga shpallja: Fletëparaqitje për shpallje, diplomë për arsim të mbaruar sipëror dhe certifikatë të shtetësisë (kopje të këtyre dokumenteve të vërtetuar në noter).
Kandidatët për higjienë mbajtës ti plotësojnë kushtet në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune, dhe të dorëzojnë fletëparaqitje për shpallje, dëftesat për arsim fillor dhe certifikatë për shtetësi (kopje të këtyre dokumenteve të vërtetuar në noter). Orari i punës për higjienë mbajtës fillon në ora 7.00 deri në ora 15.00. Vlera e pagesës për higjienë mbajtës është 12.000 den.
Dokumentet të dorëzohen në SHF "Goce Dellçev" – Gostivar, rr. "Braka Bllazheski" nr. 6, kontakt tel. 042 215 225.
Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa vendimi për zgjedhje do të sillet në afat prej pesë ditëve pas kalimit të afatit për dorëzimin e dokumenteve.

SHF "Goce Dellçev" – Gostivar
Drejtor
Sasho Shareski

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopishtes

Tel. ++389 2 27 85 100
Faks. ++389 2 27 85 109
Rr. 2, nr. 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk
gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk

Nr i procedurës: **12382**
Nr. **28-55/17** e datës **02.02.2018**

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me **Projektin arkitektonik urbanistik për parcelat ndërtimore 1.1 dhe 1.2 të PK 1387/1, PK 1384, PK 1383/2 KK Sopishte.**
Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për **Projektin arkitektonik urbanistik për parcelat ndërtimore 1.1 dhe 1.2 të PK 1387/1, PK 1384, PK 1383/2 KK Sopishte.**
Përfshirja planore e dokumentit **Projekt arkitektonik urbanistik për parcelat ndërtimore 1.1 dhe 1.2 të PK 1387/1, PK 1384, PK 1383/2 KK Sopishte** është me sipërfaqe prej **2362** m2.

5. Prezantimi publik dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopishte më datë **09.02.2018** në ora **10.00.**
6. Anketa publike do të zgjasë deri më **16.02.2018**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).
7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrojnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
8. Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopishtes
Stefçe Trpkovski

Shkolla e mesme komunale
Gjimanzi "Mirçe Acev" – Prilep
Rr. "Prilepski Braniteli" nr. 96a
Tel/faks: 048/425-841
www.gimprilep.edu.mk

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës nga shkollat e mesme ndërsa në pajtim me nenin 24 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit për arsim të mesëm, Kryetari i komisionit për grumbullimin e ofertave publikon

SHPALLJE
Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve përfundimtare

Shkolla e mesme komunale Gjimnazi "Mirçe Acev" – Prilep në pajtim me Programin për realizimin e ekskursionit përfundimtar (shumëditor) për nxënësit e vitit të tretë, në vitin shkollor 2017/2018 dhe mendimit të marrë nga Këshilli i prindërve dhe Byroja për zhvillim në arsim, organizon:

Ekskursion shumëditor përfundimtar jashtë Republikës së Maqedonisë me relacion:
Prilep – Serbi – Kroaci – Shpella e Postojnës – Venedik – Veronë – Pizë – Firence – Romë – Napoli – Bari ose Brindizi – Igumenicë ose Durrës - Prilep.
Vendet e të cilat duhet të vizitohen me biletat e përfshira në çmim:

- Vizitë të Shpellës së Postojnës – Slloveni
- Shëtitje nëpër qytetin e Venedikut me guidë lokal: Kisha San Marko, Pallati Duzhdeva, ura e fshamjes, ura Rialto dhe Kanali Grande
- Shëtitje nëpër qytetin e Veronës: sheshet, Arenën dhe Shtëpinë e Xhulietës
- Shëtitje nëpër qytetin e Pizës: sheshi Duomo me Kullën e pjerrtë
- Shëtitje nëpër qytetin e Firences me guidë lokal: katedralja Santa Maria del Fjore, pallati Vekio – Kuvendi i qytetit, sheshi Sinjoria, statujën e Davidit të Mikelanxhelos, urën e vjetër Ponte Vekio
- Vizitë të Vatikanit me guidë lokal: Muzetë e Vatikanit, kishën e Shën Pjetrit, Kapela Sistina
- Shëtitje nëpër qytetin e Romës me guidë lokal: Forumi romak, Koloseumi, Forumi i mbretit Trajan, Kapitoli, sheshet Venecie dhe Espanie, Fontana di Trevi, sheshi spanjoll, vizitë të kishës së Shën Klimentit
- Vizitë të qytetit të Napolit: Pallati mbretëror, kisha San Francesko di Paola, kështjella Kastel Nuovo

Në kërkesën e ofertave mund të paraqiten subjekte juridike të cilat i plotësojnë kriteret në vijim:
- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për realizim të aktivitetit turistik përkatës
- të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 (tre) ekskursione për nxënës gjatë 3 (tre) viteve të fundit
- të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve

Në kushtet e dhëna në ofertë nuk duhet të ketë zgjidhje alternative gjegjësisht të njëjtat janë përcaktuar saktë pa mundësi për t'u ndryshuar.
Në ofertë duhet të jenë të përfshira shpenzimet e rrugës, ushqimi me meny (mëngjes dhe darkë) akomodim në hotele me së paku tre yje, sigurim themelor ose standard rrugor pa franshizë, të sigurohen guidë dhe mjekë (së paku dy mjekë) për udhëtimin. Agjencia është e obliguar që të parashtrojë në ofertë çmimet sipas pozitave, gjegjësisht çmime të veçanta për çdo bujtje (me darkë dhe drekë), çmim të veçantë për biletat, çmim të veçantë për guidët lokal. Çmimet e posaçme së bashku me shpenzimet për rrugë dhe sigurimin rrugor të ofrojnë shumën e çmimit të ekskursionit për nxënës.

Pagesa të bëhet në gjashtë këste të barabarta mujore (janar-qershor 2018), ndërsa ekskursioni të realizohet në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) ditë në muajin prill të vitit 2018, me tre bujtje, edhe atë një bujtje në Lido di Jesolo) dhe dy bujtje në Romë.

Agjencia në ofertë të ofrojë edhe kushte të volitshme për nxënësit që vijnë nga familjet e prekura sociale edhe atë 5% të numrit të përgjithshëm të nxënësve që do të shkojnë në ekskursionin përfundimtar.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur është i obliguar që të dorëzojë garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 15% nga vlera e përgjithshme marrëveshjes.

Kriteri për zgjedhje është **çmimi më i ulët gjatë kushteve të njëjta nga ofertuesit.**

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë.

Informacionet e nevojshme shtesë në lidhje me ekskursionin, agjencia mund t'i marrë në kontakt të drejtpërdrejtë me shkollën ose përmes formës elektronike në e-mail adresën: gimmapp@yahoo.com. Personi për kontakt: u. d Drejtori Dimçe Nastoski dhe udhëheqësi i ekskursionit Ankica Stevanoska Jançeska.

Ofertat të dorëzohen në adresën: Shkolla e mesme komunale – Gjimanazi "Mirçe Acev", rr. "Prilepski Braniteli" nr. 96a, Prilep, në zarf të mbyllur me shenjë "Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursione përfundimtare".

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Komisioni për grumbullimin e ofertave
Gordana Risteska Tuneska

Në bazë të nenit 22, paragrafi (1), pika (1) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015), në pajtim me lajmërimin për mjete të siguruara financiare për punësim në kohë të pacaktuar në shkollat e mesme të qytetit të Shkupit në bazë të financimit të vjetër me numër të vep. 18-13137/2 të datës 25.12.2017, të marrë nga ana e Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë dhe lajmërimit për pëlqim të vlefshëm për realizim të vitit fiskal 2018 me numër 18-13137/4 të datës 15.01.2018 të Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë dhe lajmërimit për pëlqim për punësim në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit në kohë të pacaktuar në bazë të financimit të vjetër për vitin shkollor 2017/2018 me numër 12-1041/1 të datës 29.01.2018, Drejtori i Shkollës së mesme të Qytetit të Shkupit Gjimnazi "Rade Jovçevski – Korçagin" – Shkup, m-r Jordan Llukarevski publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të personelit teknik në kohë të pacaktuar në bazë të financimit të vjetër

PUBLIKOHET, shpallje publike për punësim të PERSONELIT TEKNIK në kohë të pacaktuar në bazë të financimit të vjetër për vendet e punës në vijim:

- Higjienë mbajtës me 40 (dyzet) orë pune në javë, 2 (dy) realizues me arsim fillor/mesëm të mbaruara, të caktuar në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës së punës, me neto pagesë mujore prej 12.000,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit të stazhit të punës me dy ndërrime të orarit të punës – ndërrimi i parë prej ora 06:00 deri në ora 13:15 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12:30 deri në ora 20:00, si dhe kujdestaria në një ditë pune të shtunën me orar pune dy ndërrimesh - ndërrimi i parë prej orës 06:00 deri në ora 13:00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13:00 deri në ora 20:00.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e caktuara në dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për arsim të mesëm edhe atë:

- Të kenë arsim të mbaruar përkatës për vendin e nevojshëm të punës;
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Diplomë ose Certifikatë për arsimin e mbaruar përkatës;
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat varësisht nga kandidatët e paraqitur, në pajtim me nenin 23, paragrafi (2) i Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015).

Të gjitha dokumentet e nevojshme në formë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter, të parashtrohen deri në Shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit Gjimnazi "Rade Jovçevski – Korçagin" – Shkup, bulevardi "Treta Makedonska Brigada" numër 9, 1000 Shkup përmes postës ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës. Dokumentet e pakompletuara, të parregulluara dhe të dorëzuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

Kontakt personi në lidhje me shpalljen është Mirjana Grozdanovska – sekretare e shkollës me kontakt telefon 02/3115-116 dhe kontakt e-mail adresë gimnazijarjkskopje@yahoo.com.

DREJTOR,
m-r Jordan Llukarevski

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Në bazë të Ligjit për marrëdhënie pune drejtori i Shkollës së mesme elektroteknike të Qytetit të Shkupit **"MIHAJLLO PUPIN"** - Shkup
publikon

SHPALLJE

1. **Higjienë mbajtës** - 3 realizues, arsim fillor me orar të plotë të punës, në kohë të pacaktuar.

KUSHTET Orari i punës ditore të higjienë mbajtësit është me ndërrime. Ndërrimi i parë fillon në ora 6.00, ndërsa ndërrimi i dytë fillon në ora 12.300.

DOKUMENTET E NEVOJSHME:

- Lutje, dëftesat për arsimin e kryer fillor dhe shtetësinë

Të gjitha dokumentet në kopje, ndërsa origjinalet në shikim dorëzohen në arkivin e shkollës. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin publik, ndërsa afati të cilën duhet pruar vendimi për zgjedhjen e kandidatëve është pesë ditë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumentacionit.

E PRISJA TRIPLETËN, POR GABIM TË MENDOJMË PËR ÇAMPIONSIN



Ishte padyshim Higuain protagonisti kryesor i goleadës me të cilën Juventus shkatërroi të dielën skuadrën e Sassuolo: "E prisja këtë triplet, jam shumë i lumtur që ia dola dhe shpresoj që të mos jetë e fundit", deklaroi bomberi bardhezi për kanalin televiziv të klubit. Pipita fikson objektivat: "Mbeten ende edhe shumë sfida, por kjo është rruga e duhur. Shumë e rëndësishme ndeshja me Fiorentina. Do të ishte një gabim i rëndë të mendonim që tani për Champions". Shkurti është një muaj thelbësor për sezonin bardhezi, por argjentinasi synon të mos shohë përtej sfidës së radhës. "Është shumë e rëndësishme sfida kundër Fiorentinës, në program për të premten. Nuk mund t'i lejojmë vetes absolutisht që të mendojmë për 'Champions League'. Do të ishte një gabim i rëndë. Përqendrim, egërsi dhe përgjegjësi, janë çelësi për suksesin në rrugëtimin tonë", deklaroi Higuain. Në kampionat do të ketë një duel të ndezur kundër ishskuadrës së tij, Napolit. "Ka akoma shumë ndeshje deri në përballjen direkte me Napolin, prandaj duhet të mbajmë fokusin të lartë për çdo ndeshje.

> "Mbeten ende edhe shumë sfida, por kjo është rruga e duhur. Shumë e rëndësishme ndeshja me Fiorentina. Do të ishte një gabim i rëndë të mendonim që tani për Çampions', pohon Higuain

Do të nisim përgatitjen për ndeshjen ndaj Tottenhem, duke nisur nga dita e shtunë. Në kompeticione të tilla bën shumë pak ndryshim se ku e luan ndeshjen e parë, në shtëpi apo në transfertë. E rëndësishme të martën do të jetë të mos pësojmë gol dhe të tentojmë të shënojmë, për të diskutuar gjithçka në Londër", përfundoi Higuain.

Kur ma fyejnë familjen, helmi ngrihet brenda meje

Leonardo Bonuçi, në një intervistë për "Vanity Fair", foli pro dhe kundër rrjeteve sociale, teksa vlerësoi disa performanca të tifozëve. Mbrojtësi i Milanit pranoi se shumë herë, ata e shqetësojnë me disa komente, edhe pse ai, gjithashtu, mbron faktin që rrjetet sociale të ndihmojnë me komentet pozitive që merr. "Kam lexuar pothuajse gjithçka. Kur ma fyejnë familjen, veçanërisht pasi i kanë tejkaluar disa gjëra, helmi ngrihet brenda meje. Të jenë të njëjtët njerëz, që ju kërkojnë një "selfie", nëse ata ju njohin?! Ne duhet t'i kalojmë disa komente dhe të përqendrohemi në pjesën tjetër. Rrjetet sociale janë të rrezikshme, por, gjithashtu, mund të jenë të rëndësishme për të përcjellë mesazhe pozitive", – pranoi lojtari italian.

Çampionsi, momenti i Realit dhe Ronaldos për të shkëlqyer

Dejvid Bekam pranoi se Real Madridi do të përballet me një detyrë të vështirë kundër PSZH-së, por beson se dopieta e fundit në Ligën e Kampioneve do ta ndihmojë ekipin spanjoll për të shkëlqyer. Real Madridi u bë ekipi i parë që mbrojti titullin e Ligës së Kampionëve, sezonin e kaluar, ndërsa, gjithashtu, fitoi La Ligan. Këtë sezon, lojtarët e Zinedin Zidan kanë dhuruar një paraqitje për t'u harruar në kampionat. Kampionët spanjollë janë të katërtit në La Liga dhe me një distancë tronditëse prej 19 pikësh larg rivalëve të hidhur të Barcelonës. Aktualisht, "Los Blancos" po përgatiten të përballen me liderët e Ligue 1, PSZH-në, më 14 shkurt, në Çampions. Duke pranuar sfidën e PSG-së, Beckham tha nëpërmjet "Marca": "Do të jetë e vështirë me PSZH-në, që po kalon një formë të lartë në këtë moment. Ky është momenti për "Los Blancos", pasi e duan këtë garë. Shikoni lojtarët që ata kanë, si Cristiano Ronaldo. Ky është momenti që lojtarët kryesorë të dalin në pah dhe loja do të jetë e pabesueshme për t'u parë". Bekam fitoi tituj si me Real Madridin, edhe më PSG-në, gjatë një karriere të shkëlqyer, por 42-vjeçari nuk pranoi të merrte anë. "Është shumë e vështirë që të zgjedh, sepse kam luajtur me të dyja klubet dhe kanë shumë pasion, – shtoi anglezi. – Unë kisha katër vite të mëdha në Madrid, nuk isha kaq gjatë te PSZH-ja, por sigurisht fituam ligën dhe ishte e mrekullueshme. E dua klubin, njerëzit dhe tifozët, sepse janë të pabesueshëm. Të njëjtën gjë them edhe për Real Madridin".

Nga rekordi në rekord, Valverde "kërcënon" Guardiolën

Ernesto Valverde po "spërkat" disa rekorde këtë sezon. Barça synon shumë lart, do ta përfundojë sezonin me numra që hyjnë në histori. Sfida tjetër, për të barazuar dhe tejkaluar numrin e ndeshjeve të pakonkuruara të azulgranave. Deri tani, Guardiola është trajner me më shumë ndeshje, pa e njohur humbjen, me 31 të tilla, ndërsa "Txingurri" është vetëm dy ndeshje larg kësaj statistike. Në sezonin 2010-2011, Barça nuk e njihte humbjen që nga java e 3-të në të 33-tën. Në këto 31 ndeshje, katalanasit regjistruan vetëm 4 barazime: ndaj Majorka, Sporting, Sevilja dhe Real Madrid. Ishte Real Sociedad, ai që i dha fund pathyeshmërisë së ekipit të Guardiolës. Tani të dhënat janë disi të ndryshme. Azulgranat nuk humbën në shtatë sfidat e fundit të vitit të kaluar dhe as në 22 ndeshjet e këtij viti. Në total, 29 ndeshje. Vetëm Getafe, të dielën, në orën 16:15, dhe Eibar, të shtunën e javës së ardhshme, e ndajnë klubin katalanas nga barabazimi i këtij rekordi. Kjo është sfida e re e trajnerit Valverde, i cili të dielën e kaluar, në "RCDE Stadium" mposhti startimin më të mirë të Barcelonës në La Liga, me 22 ndeshje pa humbje, duke hequr kështu nderin e Pep Guardiolës, i cili kishte 21 ndeshje startuese në kampionatin spanjoll pa u mundur. Prandaj, goli i Pique e lejoi Barçën të arrinte më shumë se një pikë.

DASHI 21. mars - 20. prill

Në këtë ditë të martë jeta juaj e dashurisë do të fitojë vrull dhe do të ketë më shumë interesim nga ana juaj për të ruajtur harmoninë në çift. Beqarët do të kenë yjet në favorin e tyre dhe do të bëjnë përparim me njohjet e reja. Sot do të jetë e lehtë për të bërë progres, për të fituar dhe për të shënuar një ndryshim të madh në punë! Mundësi të reja vijnë së shpejti.

DEMI 21. prill - 21. maj

Do ta vini re që nga mëngjesi se kjo do të jetë një ditë jo e mirë, por nuk keni dëshirë as të mbylleni në shtëpi. Një fije nervoziteti do të përfshijë ata që janë në një lidhje. Beqarët do të kalojnë gjithë ditën mes angazhimeve, dhe do të jetë mirë të shmangin disponimet e këqija. Një Hënë e nervozuar rrezikon të të kthejë në rrugë të gabuara në punë, ku mbretërojnë komplikimet dhe intrigat.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dashuria është protagonist i madh i ditës, i nxitur edhe nga Venusi gjëra të mira priten për të lindurit e kësaj shenje. Do përjetoni me partnerin/en momente të veçanta të intimitetit. Zemrat e vetmuara bëjnë mirë të marrin mirë veten nga zhgënjimet, pasi mundësitë e arta nuk do të mungojnë për ta! Qetësia dhe durimi sot ju ftojnë për të zgjidhur disa çështje të punës.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Qëllimi i yjeve me partnerin/en, do të jetë një martesë e surprizave të mëdha dhe momenteve të dashurisë. Ju do të ndjeni harmoni në çift! Ardhja e flirteve të reja dhe aventura të mrekullueshme edhe për beqarët: ju do të dini se si t'i tërheqni të gjithë në anën tuaj! Priten ndryshime të favorshme në sferën profesionale.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

itë e turbullt për shumë Luanë. Për disa prej jush do të ketë rrëshqitje të mëdha emocionale që do të çojnë në mbylljen e disa historive. Epo, nesër është një ditë tjetër! Nëse jeni të kujdesshëm për të mos marrë vendime të nxituara, ju mund të gjeni veten në tokë në një moment! Nëse jeni duke kaluar nëpër një fazë konfuze dhe të pafavorshme në punë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Hëna në Akrep ju fal buzëqeshje sot. Ju do të keni mundësi për të zgjidhur një çështje familjare që ju ka dhënë kohë të vështirë. Në frontin emocional, beqarët po përpiqen të mbajnë një stabilitet të caktuar dhe kjo ju siguron qetësi. Komunikimi, sot, është aleati yt i madh. Ju do të dini se si të zgjidhni mundësitë më të mira që do t'ju paraqiten.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dita ideale për të marrë pjesë në jetën tuaj të dashurisë. Ata që janë në çift duhet të marrin parasysh gabimet e kaluara dhe të shmangin bërjen e të tjerave. Beqarët mund të planifikojnë një udhëtim jashtë qytetit, vetëm për të qenë me miqtë. Mërkuri ju ndihmon për të përfunduar një negociatë të favorshme, por gjithashtu për të vepruar mirë si një grup në punë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Sot ju do të jeni të paparashikueshëm dhe befasoni partnerin/en tuaj me surpriza dhe dhurata. Çdo keqkuptim do të zhduket menjëherë dhe do të keni zgjidhjen e problemeve në dorë. Beqarët do të bëjnë mirë për të menaxhuar njohjet me më shumë qetësi, përndryshe nuk do të përfitoni ndonjë gjë. Mundësitë e mira për të fituar një bashkëpunim që ju intereson.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ditë e qetë dhe ndonjëherë pak e bezdisshme: kjo është mënyra e prezantimit të kësaj këtë të martë për ju të lindurit e Shigjetarit. Mos vazhdoni t'i bëni gjërat me forcë si të doni ju! Beqarët do të gjejnë ekuilibrin dhe qetësinë e brendshme dhe do të jenë mirë. Do të ketë pak sfida me të cilat ballafaqoheni sot në punë, prandaj është më mirë të përkushtoheni për konsolidimin e pozitës suaj.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Yjet ju kanë servirur një ditë të mbushur me buzëqeshje dhe madje edhe të mbushur me pasion. Ju do të bëni gjithçka që ndjeni për partnerin/en për të cilin më në fund do të gjeni kohën e duhur për t'ja kushtuar. Beqarët do të duhet të kujdesen për disa çështje që në ditët e fundit kanë mbetur jashtë për shkak të angazhimeve të tjera.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

eta personale sillet rreth gjysmës tuaj dhe ju jeni të vetëdijshëm për të. Jini të durueshëm nëse partneri/ja aktualisht ka shumë për të bërë, angazhimet nuk i japin kohë dhe afat. Ata që janë vetëm në këtë periudhë po kalojnë një moment të rëndësishëm që e bën kokën tuaj të rrotullohet pak. Përveç Jupiterit, sot edhe Hëna përpiqet të vendosë shkopinj në mes të rrotave tuaja në punë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Këtë ditë pritet që ju të plotësoni të gjitha pritjet tuaja, duke filluar që nga ndjenjat. Në dashuri do të tejkaloni veten dhe do t'i pohoni partnerin/es tuaj çdo gjë që ndjeni. Beqarët do të duhet të kujdesen për disa miqësi, nëse ata nuk duan të rrezikojnë t'i humbasin ato. Në punën që mund të keni njohuri të shkëlqyera: ambicia jote do të jetë me të vërtetë e madhe dhe rezultatet nuk do të mungojnë.

Mensur Mamuti	RAJON NË ITALI / FUTBOLLISTI KOSOVAR - ZVIÇËRAN NË FOTO	**K**	ISH FUTBOLLISTI IRLANDEZ, ROJ	MJESHTËR I AUTOMOBILAVE
HAJGARE				
AKADEMIKU YNË, ALI				
QYTET NË FRANCË				
ISMET BOGUJEVCI			ZERO / 4 ROMAK	
GUXIMTAR / MENDJELEHTË				
N				
RADIUMI / SHUFËR E HOLLË METALI			KALIUMI / QELQ	
KOHA	LLOJ SHPENDI AUSTRALIAN	QYTEI I PREJARDHJES SË FUTBOLLISTIT NË FOTO	ITALIA	**KOHA**	TANTALI / KANTONI I LINDJES SË FUTBOLLISTIT NË FOTO			XHAXHA / GRYKA E VULLKANIT (SH.)		
PËRKULI				I ZESHKËT, ZIOSH / VEZIR I SULEJMANIT, ALI DEDE (VARRIN E KA NË TEQEN E TETOVËS)						
MAGJISTËR			SYLARUSHI / SHKAK, ARSYE (SH.)							
FITUES (ANG.)						NDAJFOLJE, QE / INSTITUCIONI PËR DËRGIMIN E LETRAVE			KELVINI / VEPËR PENALE (SH. PASHQ.)	
KOHA	BUZA E NJË GREMINE / LIQEN NË SUEDI						TINA TARNER / PEJA			ÇEP, KËND
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO										
MIRATIM PËR TË KRYER DIÇKA					QË BËHET NË SERI / INTERNET PROVIDER					
BANOR I ANAMIT							NËNA / REOMIRI			
NETWORK INVESTIGATIVE TECHNIQUE				NDAJFOLJE, ANDEJ, TEJ						

Sudoku

shumë i lehtë

7		4		8		3		
					1	8		7
		8		7				
	8	9	3					
		7		6		2		
					7	1	3	
5	6			2		7		9
			1					
	9			3				5

mesatar

			6				7	
						2		4
1		7	3	2				
	7				8		3	
	3						2	
4			5					8
	6			1	4	9		
8								
	1				6	7		

ZGJIDHJET: K, SHAKA, ALIU, NANT, IBO, TRIM, NAIVE, RA, K, TA, XHA, EPI, ZESHKAN, MR, SYLARMI, UINER, JA, K, ZGRIP, TK, GRASHOPERS, LEJE, SERIK, ANAMIT, ËMA, NIT, PËRTEJ.

Shumë i lehtë: 724985361, 936241857, 158673942, 689312574, 317564298, 245897136, 563428719, 472159683, 891736425. **Mesatar:** 982645371, 356187294, 147329865, 571268439, 638491527, 429573618, 763814952, 895732146, 214956783.

Syzet e para në botë që filmojnë 360 gradë

Ndërsa realiteti virtual po bëhet gjithnjë e më popullor, po shfaqen edhe lloje të ndryshme kamerash 360-gradëshe për konsumatorët. Më të veçantat janë një palë syze me kamera të instaluara në skeletin e tyre, që mundësojnë për herë të parë një filmim të tillë tredimensional. Këto syze mund të ishin fare mirë pasardhës i Google Glass dhe GoPro. "Janë syze me stil tërheqës dhe përmbajnë katër kamera, dy përpara dhe dy prapa", thotë Adil Suranchin i kompanisë prodhuese, "Orbi". Rezultati është video tredimensionale me rezolucion 4K. "Këto janë syzet e para në botë që filmojnë në 360 gradë", thotë Suranchin. Syzet mundësojnë që pamjet të filmohen nga këndvështrimi i saktë i personit, ndërsa duart i ka të lira. "I vendos syzet, shtyp një buton, dhe mund t'i thuash lamtumirë të gjitha pajisjeve mbështetëse që duhen për kamerat e sotshme. Secila prej kamerave ka fushëpamje prej 180 gradësh, pra mund të filmoni gjithçka rrotull", thotë Suranchin. Kompania ka menduar edhe për aspektet e privatësisë, për të cilat shumë njerëz shqetësohen. "Kemi drita sinjalizuese LED, të cilat ndizen kur po regjistrohen pamje, kështu që të gjithë njerëzit rrotull të dinë që po filmohen", thotë Suranchin. Videoja mund të shpërndahet menjëherë, dhe mund të ruhet në një kartë memorieje. Syzet i rezistojnë ujit, kanë xhama të polarizuar, mund të porositen për 399$, dhe kompania fillon shpërndarjen në muajin gusht.

Mungesa e omega 3 shkakton këto sëmundje

Mungesa e acideve yndyrore omega-3 në organizëm mund të shkaktojë probleme të shumta. Sipas një studimi në Universitetin Harvard, mungesa e omega-3 është njëri ndër dhjetë shkaktarët kryesor të vdekjeve në vit. Mungesa e vajit të peshkut mund të shkaktojë shumë sëmundje. Në këtë mënyrë, vaji i peshkut rekomandohet për uljen e rrezikut nga sëmundja e zemrës dhe sulmi në tru, reduktimin e simptomave të depresionit, lehtësimin e tensionit të lartë, lehtësimin e çrregullimit të mungesës së koncentrimit dhe hiperaktivitetit (ADHD). Ai po ashtu rekomandohet edhe kundër dhimbjeve në kyçe, artritit, sëmundjeve kronike të lëkurës sikurse është enzema, humbja e peshës dhe rritja e energjisë.

Gruaja që "rilindi"

Një grua hoqi një tumor që peshonte më shumë se 31 kilogramë, në një operacion që mund të thuhet se pa dyshim i shpëtoi asaj jetë. 57-vjeçarja Sonia Lopez, nga Kosta Rika, e shtyu këtë procedurë për më shumë se 8 vjet, për "arsye personale", por në fund u detyrua që t'i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale, pasi kjo masë i kishte zënë rreth 80 për qind të pjesës së saj abdominale dhe po i shtypte zorrët, mëlçinë dhe diafragmën. Sipas asaj që shkruan e përditshmja britanike "DailyMail", gruaja ishte paralajmëruar që prej 10 vitesh se zmadhimi i këtij tumori mund t'i shkaktonte atak në zemër, për shkak të presionit që po i ushtronte në organe. Pasi nuk mund të merrte më frymë, asaj iu desh që të kryente operacionin në spitalin e Meksikës, të hënën e shkuar. Në këtë ndërhyrje morën pjesë 5 kirurgë, të cilët besojnë se Lopez ka thyer rekordin botëror. Gruaja aktualisht po rikuperohet nga operacioni, ndërsa mjekët presin përgjigjet për të zbuluan nëse kjo masë ishte ose jo kanceroqjene. Vetë 57-vjeçarja për mediat vendase tha se ndihej e çliruar. "Ndihesha shumë e lodhur. Në krahasim sesi isha përpara, është si nata me ditën. Ndihem si të kem rilindur".

Udhëtonte me 1.6 ton borë mbi veturë

Policia zvicerane njoftoi sot se kishte ndaluar për arsye sigurie një veturë me targa suedeze, pasi mbi karrocerinë e saj gjendeshin 1.6 ton borë. Policia e kantonit të Solerit deklaroi se kishte ndaluar sot pas mesditës veturën që po i drejtohej Zyrihut. "Pas kontrollit, pamë që mbi karrocerinë e veturës ndodhej një shtresë bore prej 40 centimetrash dhe, sipas përllogaritjeve, pesha e saj ishte të paktën 1 600 kilogramë", tha policia në një komunikatë. "Të ecësh me këtë peshë mbi karroceri përbën një rrezik të madh, pasi bora mund të binte mbi asfaltin e autostradës", shtoi ajo. Pas mbajtjes së një proceverbali, drejtuesi i veturës u detyrua të hiqte borën dhe pastaj u la i lirë për të vazhduar rrugën.

KALENDARI HISTORIK 7 JSHKURT

1238 - Mongolët i futën zjarrin qytetit rus Vlladimir.

1301 - Eduard i Kernarionit (më vonë Eduardi II) bëhet Princi i parë i Uellsit.

1522 - Traktati i Brukselit: Habsburgët ndahen në Degë spanjolle dhe austriake.

1613 - Mihail Romanov bëhet Cari i Rusisë.

1792 - Austria dhe Prusia nënshkruajnë marrëveshje kundër Francës.

1900 - Themelohet Partia e Punës në Angli.

1947 - Arabët dhe Hebrenjtë refuzojnë propozimin britanik për ndarje të Palestinës.

1962 - Kryetari Kenedi fillon bllokadat ndaj Kubës.

1964 - Cassius Clay (Muhamed Ali) pranon Islamin.

1971 - Burrat zviceran pranojnë të drejtën e votës për gratë.

1997 - SHBA dhe Rusia shpallin mbajtjen e Samitit të Helsinkit.

2000 - Themelohet Universiteti Bahria në Pakistan.

A E DINI SE...

Parisi kryeqyteti i bukës dhe djathit. Është e pamundur që të gjesh një shtëpi franceze ku këto të mungojnë. Edhe pse nuk ka rregulla të shkruara, buka që shitet në dyqanet e Prasit duhet të ketë të gjithë përbërësit, konsistencën, çmimin apo edhe gjatësinë e duhur. Qyteti ka më shumë 1.200 njësi ku tregtohet buka, "boulangerie", të cilat koordinohen nëpër lagje qe edhe në ditët e pushimeve, ky produkt asnjëherë të mos mungojë në familje. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për djathin, i cili përgjithësisht konsumohet pas mesditës.

BARSOLETA

A KA LUGAT AGA HOXHË?

Në një mevlud, ku ishin kallaballak njerëz, pasi që u kryen ceremonitë fetare, filloi muhabeti. Aty kishte qenë edhe një djalë i ri, i cili ditë më parë hoxhës ia kishte vjedhur pulat natën. Djali, pas ca muhabetesh, e pyet Hoxhën:

-Hoxhë, a di me na tregu nëse ka lugatë apo jo?

Hoxha, pasi kishte marrë vesh se kush ia ka vjedhë pulat, i thotë:

-Po bre djalë, bile ma lugat se ti unë hala nuk kam pa!

THËNIA E DITËS

Një lider i madh asnjëherë nuk e sheh veten mbi të tjerët, përveç se në mbajtjen e përgjegjësive.

(Jules Ormont)